

Mbrojtja e brezit - 2

Islami nuk është fe e terrorit

Ndjenjat shpirtërore të haxhit

Në zemrën e vogël, dashuri e madhe për Profetin

Nëna e Hz. Aliut, Fatime binti Esed

Urtësitë e kurbanit

Letër mëshire



ISLAMI

është fe e mëshirës

Viti: I Numri: 2
Janar-Shkurt-Mars 2006
Dhilhixh-xhe-Muharrem-Sefer 1426-1427

Në emer të
SH. E. A. VËSHTRIMI:
Sead MORINA

Kryeredaktor:
Sead MORINA

Redaktor përgjegjës:
Sead MORINA

Lektorë dhe korrektorë:
Dr. Mithat Hoxha
Zeqirja IBRAHIMI

Drejtori i reklamave:
Sead MORINA

Këshilli redaktues:
Sead Morina
Abdusamed Zeqiri
Ramadan Uka
Shuajb Bashan
Arif Qerazi
Idris Keskin
Arjan Ymeraj

Adresa:
Dardania Rr. banesore 4/7-d-6
kati përdhës banesa Nr. 1 Prishtinë

Tel: +381 385 423 85

Shtyp: Shtëpia Botuese ERKAM
Tel: +90 212 671 07 00

Dizenjo - Grafik:
Rasim SHAKIROV

Ngjyra: IBS Grafik
Tel: +90 216 342 85 99

Adresa e përfaqësimit në Shqipëri:
Shoqata Vëllazërore Humanitare
Kulturore Stamboll
Bulevardi Zogu I pall. 97
ap. 21 shk. 2 Tiranë / Albania
Tel: +355 424 81 12

Çmimi: 150 Lek

Për artikuj:
e-mail: veshtrimi@hotmail.com
etika05@yahoo.com

Abonim

Abonimi vjetor për Shqipërinë, Kosovën, Maqedonin e Malin e Zi është 6 ₺.
Për evropën, 15 ₺.
Kurse për shtetet e tjera, çmimi vjetor është 20 \$.

Të interesuarit, pasi të njoftojnë qendrën e revistës, pagesën mund ta bëjnë tek "Asya Finas".

Numri i llogarisë në
₺ është: 58-709204-3
Kurse në \$: 58-709204-2.

Lexues të shtrenjtë,

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Lexuesë të nderuar

Falemderojmë All-llahun fuqiplotë mëshiruesin e gjithëfuqishëm të të gjithave krijesave që ekzistojnë në gjithësi. Me një mund dhe sakrificë të pakursyer arritëm që të përgaditemi edhe për numrin e dytë të revistës "ETIKA". Falë mëshiruseti të gjithësisë dhe ndihmës së tijë kjo revistë sot gjendet pran duarëve tuaja.

Një prej rregullave të moralit Islam është edhe mëshira, All-llahu dhe i Dërguari i Tijë, Muhammedi as urdhërojnë në mëshirë. Mëshira, është një prej pjesëve kryesore të moralit Islam. Pezgamberi i fundit Muhammedi as me një hadith thotë: *Bëni mëshirë në ata që janë në tokë që të bëjnë mëshirë ata që janë në qiellë për ju.*

Pra shihet fare mië se qfarë rëndësie i jep Islami mëshirës ndaj familjes, farefisit, rrethit ku jeton dhe mbarë njerëzisë.

Islami si fe synon revolucionin e mbrendshëm të njeriut për të bërë një njeri të shkëlqyeshëm duke mos i lënduar familjen, farefisin, rrethin ku jeton dhe mbarë njerëzinë.

A thua kjo a bëhet me forcë?

Natyrishtë që jo, historia neve na tregonë fare mirë se ideologjitë e ndryshme kanë bërë përpjekje për vendosjen e rregullave të moralit me forcë, mirpo kjo nuk ka rrezulltuar e frytëshme dhe se ato shoqëri kanë humbur indentitetin..

Islami gjatë periudhës së sajë historike të ndritshme një nga armët që ka përdorur për rregullimin e shoqërisë ka qenë mëshira. Mëshira si termë është përdoret shuimë mirpo mëshira që synon Allahu dhe i dërguari i Tijë Muhamedi as është mëshira për gjithë njerëzinë, krijesat që ekzistojnë mbi spërfaqen e tokës dhe gjithë atë që ka krijuar Allahu.

Njeriu në vetë brendësin e tijë është i mëshirshëm, mëshirën e dëshiron për vete dhe atë ta praktikojë, mirpo nëse njeriu largohet nga mësimet Islame ajo ndjenje fillon të zbehet dhe

kjo vazhdon derisa ajo ndjenjë të vdesë, por nëse ai pësëri kthehet mësimëve islame ajo pësëri rikthehet tek njeriu dhe atë e bën të lumtur. All-llahu në Kuranin Fisnik thotë:

"A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e Allahut dhe me atë të vërtetë që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë, e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën, e shumë prej tyre janë jashtë (El-Hadid: 16)

Ky Ajet nga Kurani fisnik tregon fare mirë për mëshirën dhe mbjelljen sajë në moralin e njeriut. Edhe vetë Pejgamberi i mëshirës në një hadithë sherifë thotë:

"... njerëzit të cilët janë më larg Allahut të Lartësuar, janë ata që kanë zemër të vrazhdtë."

Inshalla Allahu neve dhe gjithë njerëzin na bënë të mëshirshëm dhe prej atyre që rrespektojmë rregullat e moralit islam

Të dashur lexues

Në këtë numër përveq temave Islami Fe e Mëshirës do të i keni mundësi të lexoni edhe tema të ndryshme që ka të bëjë në përmisimin e brendshëm të njeriut një ashtu edhe lajme nga bota teknologjike që njeriut sot ja ka bërë jetën më të lehtësuar dhe lajme nga vendi, rajoni dhe Bota Islame.

Revista juaj ETIKA falë All-llahut, bashkpunëtorëve tonë një ashtu edhe përkrahja e juaj lexues të nderuar nga numri në numër vetëm është duke u bërë më kualitative.



Letër mëshire



Kape për dorën e fuqisë
Mëshiruesin, o njeri!..
Vëre zemrën në pëllëmbë të
Profetit të Mëshirës, o njeri me
zemrën të etur për mëshirë!
Vërja veshin thirrjes së Librit
të shenjtë për mëshirë!..
Kapu dhe mbahu fort pas
miqve të Allahut, shembëlltyra
mëshire, që ecin në gjurmët e
Profetit të Mëshirës!..
Dhe nisja jetës përsëpari...
Me emrin e Allahut Mëshirues
e Mirëbërës!
Dhe mbi tokë të formohet

përsëpari një klimë mëshire!..

Ahmet TASHGETIREN 3

A mos vallë nga mëshira lind maraz? /
Prof. Dr. H. Kamil YËLLMAZ..... 7

Dr. H. C. Faik LULI & Islam DRIZDARI

Abetarja e Hafiz Ali Ulqinakut



lerat pedagogjiko-didaktike
të kësaj abetareje mund të
përgjithësohen në tre drejtime
kryesore:

Së pari. Për mësimin e
shkrim-leximit me njohjen e
shkronjave e të tingujve.

Së dyti. Për dhënien e
njohurive të ndryshme nga
mjedisi shkollor, familjar,
natyror e shoqëror.

Së treti. Për edukimin moral, fetar, qytetar e estetik të
fëmijëve, aq të nevojshëm që në moshë të re si bazë për një
edukim të shëndoshë në të ardhmen 32

Mëso, zbato, kumto dhe bëhu i devotshëm /
Dr. Kerim BULLADI..... 17

Edhe unë jam këtu / Zejnep OZDIL..... 20

Mos u druaj nga vetëshprehja! /
Dr. Alixhan Tatllë..... 22

Pika urtësie..... 25

GRATË SAHABE/ Havle Binti Tha'lebe (r.anha) /
Mustafa ERISH..... 38

NGA LULISHTJA R ZEMRËS

Mbrojtja e brezit -2



Lumturia në familje si fryt i mirëkuptimit
dhe pjekurisë reciproke mes bashkëshortëve,
duhet ruajtur me ndjeshmëri. Të dy palët,
pa rënë kurrë në vulgaritet, duhet të jetojnë
në sinqeritet. Brenda familjes, duhet treguar
kujdesi më i lartë për kufijtë e ndjeshëm
mes seriozitetit dhe mendjemadhësisë, modestisë dhe banalitetit,
sinqeritetit dhe vulgaritetit.


Osman Nuri TOPBASH 26

Tradita e ixhazetit tek muslimanët /
Mesut IDRIZI..... 41

Ramazani i nderuar..... 44

Mbledhja VI e organizatës së këshillit Islamik të Euroazisë..... 47

Muhidin AHMETI



Vlera e të humburës ndërmjet së kaluarës, mësimin dhe porosisë

Një mendimtar islam, duke iu drejtuar
të birit, thotë: “Bota në të cilën ke lindur,
biri im, është e vdekur. Herët a vonë era
edhe këtu do të sjellë farën e shkatërrimit
tonë, e cila më pas do të mugullojë në
çdo mal e çdo shtëpi... Në këtë botë të
re ku jetojmë, ekziston një mënyrë e re e të vdekurit. Në botën e
vjetër e vritnim njëri tjetrin dhe me të mbaronte çdo gjë. Por, tani
e kam mësuar që indiferenca e plotë mund të jetë njësoj vdekje e
pamëshirshme si edhe të humbësh kokën në dyluftim.”

..... 11

Medet Balla

Të dish të përdorësh kohën



Pasuria më me vlerë që humbasim
pa e vënë re, është koha. Ajo rrjedh
si uji. Zoti ynë, për të vlerësuar
pikërisht këtë të vërtetë, betohet në kohën duke theksuar se jemi
në humbje në këtë drejtim. Ndërsa Pejgamberi ynë thotë: “Ka dy
mirësi që njerëzit nuk ua dinë vlerën ashtu siç duhet. Këta janë
shëndeti dhe koha e lirë” 44

Letër mëshire

Birit të njeriut të larguar prej Mëshiruesit dhe Mirëbërësit



Kape për dorën e fuqisë Mëshiruesin, o njeri!..

Vëre zemrën në pëllëmbë të Profetit të Mëshirës, o njeri me zemrën të etur për mëshirë!

Vërja veshin thirrjes së Librit të shenjtë për mëshirë!..

Kapu dhe mbahu fort pas miqve të Allahut, shembëlltyra mëshire, që ecin në gjurmët e Profetit të Mëshirës!..

Dhe nisja jetës përsëpari!..

Me emrin e Allahut Mëshirues e Mirëbërës!

Dhe mbi tokë të formohet përsëpari një klimë mëshire!..

Tshkruash letër birit të njeriut, domethënë, vetes, secilit prej nesh, duarve, gjuhëve, syve, mendjeve, zemrave tona...

Miliarda letra!

U bë më gjakderdhës, ngatërrestarë...

Zhvilluam mjete lufte për të avulluar brenda sekondash miliarda njerëz si ne, për t'i bërë rrafsh me tokën! U bë më ujë të njëri-tjetrit!

Në çdo vend ka luftë. Mendjen që na është dhënë për ta menduar të bukurën, e përdorim për t'i bërë mjetet e luftës më vrasëse, për t'i bërë më shfarosëse në masë. 772 miliard dollarë! Këto janë para që i kemi veçuar për një vit, për t'u armatosur me qëllim për ta shfarosur njëri-tjetrin në emër të pasioneve faraonike! Vrit! Vrit! Ky u bë slogani universal i përdorur nga lloji njerëzor!

Filluam ta përdorim mendjen për t'i shfarosur të mbjellat si dhe brezin. Bartëm intrigë në qiej, bartëm intrigë në tokë dhe e konsumojmë qiellin, e konsumojmë tokën sikur s'kemi për t'u ngopur asnjëherë!

Kemi të uritur në çdo kontinent... 800 milion, nga të cilët, 300 milion fëmijë! Në ditë vdesin 24 mijë njerëz nga uria! Si, a mund të lavdërohemi si njerëz që jemi? Bebet u bënë ushqim për mizat e uritura, kurse ne mundemi të gdhihemi të ngopur, madje, filozofia e të ngopurit, e "hani, zotërinj, hani", e shndërruar në sëmundje, po mundet të arrijë në përmasa shkatërrimtare për ne. Disa prej nesh rropaten për të shpëtuar prej urisë, kurse disa të tjerë, prej sëmundjeve të shkaktuara nga

tejnngopja!

Shih, o njeri, shih nga Afrika! Afrika je ti, kudo që të ndodhesh, sido që të jetosh!..

U bëjmë padrejtësi grave e vajzave tona... Fëmijët shtypen nën këmbët tona... Nuk mbeti ndryshim në dinjitet mes njerëzve dhe insekteve pasi që i fuqishmi konsiderohet njeri, kurse i dobëti para tij, insekt!..

A jemi ne njerëzit që Krijuesi na bëri "njerëz", "bujarë", "qenien më të bukur", "të denjë për të bartur një amanet të lartë"?

Po qenia e kundërt, ajo që Krijuesi e pati cilësuar si "të rënë në një shtresë më të ulët se kafshët", kush ishte, vallë? Si mund të binte njeriu në shtresat poshtë kafshëve? Si mund të dilte një insekt para njeriut në vlerë? Ç'duhej të bënte njeriu që të binte në këtë gjendje?

Kush është ky dymbëdhjetëvjeçar që përpëlitet në komën e drogës? Kush është ky që prodhon miliarda dollarë nga droga?

Kush është ky që kërkon t'ia nxjerrin fëmijën duke ia copëtuar në mitër, a mos vallë nëna që pret të bartë një pikë nga mëshira e Mëshiruesit?

Kush është ky që u vë thikën fëmijëve në mitrën amësore, a mos vallë mjeku nga duart e të cilit pritët shërim?

Vendos një bombë që duar e këmbë të fluturojnë në ajër... Një bombë të verbër... Që asgjëson kë t'i dalë para... Hidh një bombë, mijra sy të shuhen, mijra zemra të heshtin! Një bombë të verbër! Këdo që i del



Jetoje jetën duke përmendur Mëshiruesin dhe Mirëbërësin, mos e harro Mëshiruesin dhe Mirëbërësin... Duke pirë ujë, duke ngrënë gjellë, duke hedhur hapin, duke u shtrirë e duke u ngritur, duke filluar një punë, çdo punë! Laje zemrën në ujëvarën “Bismil’lahi’r-rahmani’r-rahim... / Me emrin e Allahut Mëshirues e Mirëbërës!”

para! Të bëhet luftë, terror!..

Një qenie që s’ngopet me gjak!
Njeri është ky?

T’i shkruash një letër...

Njeriut...

Një letër mëshire...

Duke filluar me “Bismil’lahi’r-rahmani’r-rahim... / Me emrin e Allahut Mëshirues e Mirëbërës!”

A s’të ra në zemër gjurmë nga Mëshiruesi, o njeri, a s’t’u reflektua dritë nga Mirëbërësi?

Ai ta mësoi ty leximin bashkë me emrat Rahman dhe Rahim që dhurojnë shirëra mëshire të pafund!

Lexoje Librin e shenjtë të Krijuesit duke kujtuar Mëshiruesin dhe Mirëbërësin!

Jetoje jetën duke përmendur Mëshiruesin dhe Mirëbërësin, mos e harro Mëshiruesin dhe Mirëbërësin... Duke pirë ujë, duke ngrënë gjellë, duke hedhur hapin, duke u shtrirë e duke u ngritur, duke filluar një punë, çdo punë! Laje zemrën në ujëvarën “Bismil’lahi’r-rahmani’r-rahim... / Me emrin e Allahut Mëshirues e Mirëbërës!”

Mëshiruesi të krijoj ty!.. (1)

Qenia jote, vepra e krijimtarisë së Mëshiruesit...

Si shkëputesh nga Mëshiruesi?

“Allahu shkroi mëshirën për vete...” (2) E bëri mëshirën moral të vetin. Të gjitha qeniet me mëshirën e vet i krijoi dhe rrjedhat

e të gjitha ngjarjeve u bënë rreshta mëshire të Tij. Raporti i krijimit dhe hyjnitetit mes Allahut dhe krijesave u bë identiteti i mëshirës së ardhur nga Allahu personalisht dhe eternalisht. (3)

Dhe tha: “Mëshira ime ka rrethuar gjithçka!” (4)

Vepër mëshire je ti! Në çdo gjë që i hedh vështrim, mund të shohësh mëshirën, sepse mëshira e Krijuesit iu tejçua çdo gjëje... Ajo çka reshoi nga qielli, u bë mëshirë, lulet në tokë të buzëqeshën me mëshirë ty...

Ai që të ka krijuar ty, tha: “Unë ia kam bërë vetes të ndaluar padrejtësinë. Atë e bëra të ndaluar edhe mes jush!” (5)

Si largohesh nga mëshira që do të të kushtonte shkëputjen nga dashuria e Krijuesit, si e bën padrejtësinë moral, o njeri?

Përfaqësuesi i fundit, profeti, udhërrëfyeni i fundit i dërguar nga Ai për ty, “u dërgua si mëshirë për botët!” (6)

Profeti (s.a.) të dha edukatë mëshire ty. Si mund të largohesh nga klima mëshirore e tij pa e shkëputur zemrën prej tij? Ku je?

Nga Mëshiruesi u shkëpute, nga profeti i Tij i mëshirës u shkëpute; kush të kapi ty prej duarsh, kush të përshkoi ty nëpër qerthujt e padrejtësisë dhe dhunës, kujt ia lejove të ta fitojë zemrën?

Profeti - mëshira dhe paqja e Allahut qofshin mbi të - tha:

“Atë që nuk tregon dhembshuri për njeriun, Allahu nuk e mëshiron!”

“S’ka mëshirë për atë që s’ka mëshirë!”

“Kini mëshirë për ata që janë në tokë, që ata që janë në qiell, të kenë mëshirë për ju!”

“Kush nuk ka mëshirë për të vegjlit, s’është nga tanët!”

Po ti, nga cilët je, o njeri?

A mos ke për detyrë që, duke lënë çdo punë, të përpiqesh për t’ia prerë rrugën mëshirës së Zotit tënd?

Pa mendo: vepër e kujt është mungesa e mëshirës që po e djeg dhe përvëlon faqen e tokës, që kërkon t’i shkelë edhe qiejt, madje?

“Dhe nisi në tokë e në det kalbja dhe prishja për shkak të bëmave të njerëzve me vetë duart e tyre!” - Thotë Krijuesi... (7)

Eshtë faraoni si shembull të keqeje, është Karuni, është populli i Lutit, populli i Nuhut, është Adi, është Themudi... Kjo fjalë hyjnore të na i kthejë sytë në shekullin e 21-të dhe të na tregojë neve...

Ja, pra, po e shohim kalbjen, prishjen. E keqja i ka arritur njeriut gjer në grykë...

Njeriu i paditur i periudhës pagane paraislamike i vrau vajzat e vogla nga frika e urisë apo nga një

ndjenjë turpi e çuditshme. Njeriu i viteve 2000, njeriu shumë i kënduar, shumë i ditur, i vret fëmijët që në mitrën e nënës!.. Dhe, pastaj, niset të prodhojë fëmijë me kllonim. Numri i përgjithshëm i të vrarëve gjatë të gjitha luftërave në shekullin VII nuk është as sa një e dhjetëmijta e numrit të të vrarëve në Nagasaki. Shtyp një buton, të avullohen njëqind mijë njerëz në 15 sekonda!..

Njeriu zhvilloi të gjitha mjetet e egërsisë. Njeriu arriti një aftësi që të mund të hidhte nënshkrimin nën vdekjen më të paimagjinueshme! Pas largimit nga Mëshiruesi, pasi u bë i huaj për klimën mëshiruese të Allahut!..

* * *

Kape për dorën e fuqisë Mëshiruesin, o njeri!..

Vëre zemrën në pëllëmbë të Profetit të Mëshirës, o njeri me zemrën të etur për mëshirë!

Vërja veshin thirrjes së Librit të shenjtë për mëshirë!..

Kapu dhe mbahu fort pas miqve të Allahut, shembëlltyra mëshire, që ecin në gjurmët e Profetit të Mëshirës!..

Dhe nisja jetës përsëpari...

Me emrin e Allahut Mëshirues e Mirëbërës!

Dhe mbi tokë të formohet përsëpari një klimë mëshire!..

Përkthyes: Mithat Hoxha

Poshtëshënimet:

1. Kur'ani, Rahman: 3.
2. Kur'ani, En'am: 12, 54.
3. Elmab, Hak Dini Kur'an Dili, vëll. 3, f. 1886.
4. Kur'ani, A'raf: 156.
5. Muslim, Birr, 55.
6. Kur'ani, Enbija, 107.
7. Kur'ani, Rum: 41.



A të që nuk tregon dhembshuri për njeriun, Allahu nuk e mëshiron!”

“S’ka mëshirë për atë që s’ka mëshirë!”

“Kini mëshirë për ata që janë në tokë, që ata që janë në qiell, të kenë mëshirë për ju!”

“Kush nuk ka mëshirë për të vegjlit, s’është nga tanët!”

A mos vallë nga mëshira lind maraz?

Zoti mos e dhëntë!..

Gjithsesi, nga mëshira s' lind maraz! Në popujt tanë, si produkt i përvojës shekullore, kanë dalë mjaft thënie, fjalë të urta e proverba me vlerë përgjithësuese, mes të cilave ka edhe syresh që e kapërcejnë qëllimin e mirë, që i vënë në diskutim pranimin e përgjithshëm dhe vlerat themelore njerëzore. Nga këto, mund të përmendim shprehjet “Nga mëshira lind maraz” dhe “Shkopi ka dalë nga xhenneti”. E para ku, si antagonist i konceptit *mëshirë* që përfaqëson kuptimisht esencën e *të mirës*, përdoret fjala me kuptim të gjerë, *maraz* (smirë, inat, hidhërim, brengë), e cila, si koncept, përfaqëson, këtu, esencën e *të keqes*, është e afërt në kuptim me shprehjen më të thjeshtë, *bëj mirë që të gjesh keq!* Kurse e dyta, ku përdoret fjala *shkop* që do të thotë *rrahje*, duke e quajtur rrahjen *element të parajsës*, e konsideron atë burim të mire, përfundimesh pozitive dhe lumturie!

Vlerat dhe morali i këtyre dy shprehjeve bien në kundërshtim të plotë me vlerat dhe moralin islam!

Specifikat që duhet të zënë vend mes vlerave tona themelore, janë reflektuar gjatë procesit historik në jetën tonë si përvojë fetare e kulturore në kornizën e Kur'anit dhe Sunnetit, traditës profetike. Me atributet hyjnore *Rahman* (mëshirues) dhe *Rahim* (mirëbërës) që përmenden dy herë në suren e parë të Librit dhe përsëriten në krye të të gjitha sureve të tjera, Islami tregon se në qendër të gjithësisë dhe jetës është vendosur mëshira.

Fjalët arabishte *rahman* dhe *rahim* rrjedhin nga rrënja *rahm*. Fjala *rahm* do të thotë edhe *dhembshuri*, edhe *mitër* ose *placentë* (shtrat i fetusit). Ashtu siç mitra amësore e mbron fetusin, fëmijën që po



zhvillohet, i krijon mundësi zhvillimi, e ushqen me gjakun dhe jetën e vet, ashtu dhe ndjenja e mëshirës i mbron jetën dhe vetitë njerëzore, i ushqen dhe i zhvillon ato. Ashtu siç një femër që nuk ka mitër, nuk mund të bëhet nënë, ashtu dhe njeriu që s'ka mëshirë, nuk mund të bëhet njeri. Dashuria dhe mëshira e Allahut të Lartë për njerëzit është shumë përtej kësaj. Kështu, një herë, kur i Dërguari i

Allahut pati parë një nënë që ndodhej mes një grupi robërish, ta shtrengonte fort në gjoks fëmijën e humbur e të gjetur përsëri, pati thënë: “A mund të mendoni që kjo grua do të mund ta hidhte në zjarr fëmijën e saj? Ja, pra, Allahu është më i mëshirshëm ndaj robve të vet se ç'është e dhembshur kjo grua për fëmijën e saj!” (1)

Kur'ani na thotë se “Allahu i Lartë e bëri mëshirën të detyruar për veten e vet” (2), se “ajo çka duhet të bëjmë me të vërtetë për shpëtimin tonë, është të besojmë dhe ta këshillojmë njëri-tjetrin për durim dhe mëshirë” (3), se “besimtarët duhet të jenë tejet të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit” (4), se “njerëzit që ka për të sjellë Allahu në vend të atyre që largohen nga rruga e Tij, do të jenë të thjeshtë dhe të mëshirshëm ndaj besimtarëve” (5), se “njeriu, sa ç'ka nevojë në këtë botë për një ndërmjetësues dhe për një mik të ngrohtë, ka edhe në jetën e pasme, ahiret” (6) dhe na urdhëron që “kurrë të mos bartim urrejtje në zemër ndaj besimtarëve”! (7) Dhe,

Njëra prej gjërave më me rëndësi që e afrojnë njeriun te Allahu, është dhembshuria dhe mëshira ndaj krijesave të Tij. Meqë Zoti shfaqet në çdo grimcë ose molekulë, pra, meqë edhe një molekulë ka fituar dinjitetin e reflektimit të shfaqjeve hyjnore në të, ndaj krijesave të Allahut duhet sjellë me dhembshuri. Si krijesë, mes njeriut dhe kafshës, të madhit dhe të voglit, të pasurit dhe të varfërit, nuk ka ndonjë ndryshim.

si një hap përtej kësaj, Allahu e konsideron ndër injorantët njeriun që nuk vepron me mëshirë, që nuk ndjek rrugën e faljes, që nuk kërkon mirësinë dhe bukurinë! (8)

Dashuria, dhembshuria dhe mëshira janë tregues të respektit për njeriun, madje, para së gjithash, të respektit të njeriut për veten e vet. Në këtë botë dhe në botën tjetër, njeriu korr atë që mbjell! Kështu, i Dërguari i Allahut porositi: *“Nuk ka mëshirë për atë që nuk tregon mëshirë për të tjerët!”* (9)


Feja jonë e lartë e cila e ngrë personalitetin njerëzor mbi boshtin dashuri-dhembshuri-mëshirë, na thotë me gjuhën e Profetit se edhe shoqëria islame ka për t’u lartësuar mbi të njëjtat vlera: *“Besimtarët janë si një trup i vetëm në dashurinë dhe dhembshurinë për njëri-tjetrin, në mbrojtjen e njëri-tjetrit!”* (10) Shoqëria islame është si një trup, institucionet islame janë si organe të këtij trupi, kurse muslimanët, si qeliza të organeve. Si mund ta dëmtojnë gjymtyrët dhe organet e një trupi apo qelizat e të njëjtit organ, njëra-tjetrën? Dhe si nuk preken dhe vuajnë gjymtyrët, organet apo qelizat e tjera nga shqetësimi apo vuajtja e njëres prej tyre?

Mungesa apo privimi nga dashuria, mëshira dhe dhembshuria janë si një sëmundje që e bën njeriun të vuajë, të përpëlitet në zjarrmí. Prandaj, marazi dhe sëmundja nuk lindin nga mëshira, por nga mungesa e mëshirës!

Për të fituar të drejtën për të hyrë në xhennet, është e domosdoshme të tregohemi të dhembshur e të mëshirshëm ndaj farefisit, miqve dhe gjithë muslimanëve, madje ndaj gjithë njerëzve të botës! (11) Ndërkaq, mëshira, nga njëra anë, dhe afërsia me dashurinë, nga ana tjetër, janë gjëra të ndryshme. Ndërsa njeriu është i ngarkuar me përgjegjësinë për të qenë i dhembshur dhe i mëshirshëm ndaj çdo njeriu, nuk është i ngarkuar me

përgjegjësinë për t’u treguar i afërt dhe i dashur me çdo njeri! Neve na vjen keq si njerëz për mohuesit dhe mosbesimtarët, por nuk jemi të detyruar t’i duam ata!

Dhembshuria dhe mëshira janë veçori karakteristike themelore të zemrës dhe shpirtit njerëzor. Zemra është si dinamо e dritës së besimit. Sapо të hyjë besimi në zemër, ajo nis vetvetiu të prodhojë elektricitetin që do ta ndriçojë dhe do t’u japë zjarr ndjenjave. Dhembshuria dhe



mëshira janë akte të zemrës, akte ndjesore, jo produkte të mendjes dhe mençurisë. Kështu, ka shumë njerëz të mençur e të zgjuar, por ama të privuar e të mangët nga dhembshuria dhe mëshira! Edhe sadistët dhe kriminelët janë njerëz, por nuk kanë zemër, domethënë ndjenja, ose në zemrat e tyre s’ka shenjë

dhembshurie dhe mëshire!

Mungesa e ndjenjave të dhembshurisë dhe mëshirës si dhe e pasurive moralo-shpirtërore e bëjnë njeriun të egër. Disa herë, njerëz me shpirt të egër munden të fshihen lehtësisht pas shpinës së pranueshmërisë shoqërore dhe të prodhojnë pretekste për egërsinë e tyre duke thënë se “nga mëshira lind maraz”! Ose kërkojnë mbështetje për agresivitetin e tyre duke thënë se “dajaku ka dalë nga xhenneti”! Kurse dihet nga të gjithë se njeriu duhet trajtuar si njeri!

Njëra prej gjërave më me rëndësi që e afrojnë njeriun te Allahu, është dhembshuria dhe mëshira ndaj krijesave të Tij. Meqë Zoti shfaqet në çdo grimcë ose molekulë, pra, meqë edhe një molekulë ka fituar dinjitetin e reflektimit të shfaqjeve hyjnore në të, ndaj krijesave të Allahut duhet sjellë me dhembshuri. Si krijesë, mes njeriut dhe kafshës, të madhit dhe të voglit, të pasurit dhe të varfërit, nuk ka ndonjë ndryshim. Nga ky këndvështrim, është detyrë e njeriut të sillet me dhembshuri dhe mëshirë ndaj të gjitha krijesave! Ne nuk kemi të drejtë t’ia prekim zemrën askujt, nuk kemi të drejtë ta turpërojmë askënd me fjalë të trasha dhe kurrsesi s’është e drejta jonë të edukojmë me anë të shkopit! Një fe e cila e urdhëron personin që ka me vete shigjetë, ta mbulojë me dorë majën e saj për të mos i shkaktuar dëm ndokujt në vende me grumbullime kolektive, si xhamia, tregu, etj., sigurisht që do t’i japë më shumë përparësi mbrojtjes së njerëzve nga plaga që shkakton shigjeta e gjuhës. Një fjalë e urtë e shqiptarëve thotë: “Gjuha kocka s’ka, por kocka thyen!”

Fusha ku dhembshuria dhe mëshira ndaj njeriut zbatohet në mënyrën më efektive, janë fëmijët. Dhembshuria dhe mëshira e ndjerë ndaj fëmijëve janë fushat më të fuqishme të shfaqjeve të mëshirës

Miqtë e Allahut, të çliruar nga frika dhe dëshpërimi, janë njerëz që e duan Allahun dhe duhen nga Allahu, që i trajtojnë njerëzit me dhembshuri, mëshirë, falje, butësi, durim dhe mirësi, që nuk ngacmohen dhe preken nga askush dhe nuk ngacmojnë dhe prekin askënd. Allahu ia fal gabimet atij që i gëzon të tjerët. Ato çka Allahu nuk i fal, janë politeizmi dhe shkelja e të drejtave të personit, është shembja e një zemre.

në zemrën e njeriut. Fjalët që i ka thënë i Dërguari i Allahut një beduini i cili ia ka pohuar se kurrë s' i kishte marrë në prehër e puthur fëmijët e vet, parashatrojnë konkluzionin e vlerave mbi këtë çështje: "*Ç'mund të bëj unë nëse Allahu ka hequr nga zemrat tuaja ndjenjën e mëshirës?*" (13)

Miqtë e Allahut, të çliruar nga frika dhe dëshpërimi, janë njerëz që e duan Allahun dhe duhen nga Allahu, që i trajtojnë njerëzit me dhembshuri, mëshirë, falje, butësi, durim dhe mirësi, që nuk ngacmohen dhe preken nga askush dhe nuk ngacmojnë dhe prekin askënd. Allahu ia fal gabimet atij që i gëzon të tjerët. Ato çka Allahu nuk i fal, janë politeizmi dhe shkelja e të drejtave të personit, është shembja e një zemre.

Poeti dhe mistiku i shquar Xhelaleddin Rumi, i mbiquajtur Mevlana, thotë:

Në djegien e zemrave të të pasionuarve pas Zotit, ka prush;

Dhe tek ata që ia kanë dhënë zemrat të Dashurit, shenja dhimbjeje.

A s' e ke dëgjuar rënkimin që del nga zemrat e atyre që digjen?

"Ah"-u i tyre ngjitet në katin e mëshirës së Allahut lart! (14)

Po qe se Zoti i fal dikujt mëshirë, i vë në sytë lot, në zemër, hidhërim dhe përgjërime, në gjuhë, dëshirë dhe lutje. Edhe ai njeri, klith dhe i thërret Zotit me lotët e syve!

Për t' i gjetur lotët, duhet shkuar pranë atyre që qajnë. Duhet treguar dhembshuri e mëshirë për hallet e


jetimëve, të varfërve dhe viktimave. Lotin mund ta gjejmë duke u shkuar pranë këtyre lloj njerëzve për të marrë pjesë në hallet e tyre dhe për t' i trajtuar ata me mirësi, sepse fitimi i mëshirës së Allahut është i mundur me anë të mëshirës ndaj njerëzve të vetmuar, të pashpresë, ndaj të mjerëve që s' kanë shërim! Kështu, lotin e derdhur për njeriun e vdekur me zemër të thyer, i Dërguari i Allahut e sheh "*si shenjë mëshire të vënë nga Allahu në zemrat e mëshirshme*"! (15)

Nga mëshira e lartësuar në këtë mënyrë, nuk lind *maraz* me kuptimin e sëmundjes; gjithsesi, lind *satisfaksion* me kuptimin e pëlqimit, kënaqësisë dhe shpërblimit!

Përkthyes: Mithat Hoxha

Poshtëshënimet:

1. Shih. Tecrid-i Sarih Tercümesi, XII, 125 e në vazhd.
2. Kur'ani, el-En'am, 6:12.
3. Kur'ani, el-Beled, 90:107.
4. Kur'ani, el-Feth, 48:29.
5. Kur'ani, el-Maide, 5:54.
6. Kur'ani, esh-Shuara, 26:100-101.
7. Kur'ani, el-Hixhr, 59:10.
8. Kur'ani, el-A'raf, 7/199.
9. Buhari, *Edeb*, 18; Muslim, *Fedail*, 65.
10. Buhari, *Edeb*, 27; Muslim, *Birr*, 66.
11. Shih. Muslim, *Xhennet*, 63.
12. Shih. Buhari, *Salat*, 66; Muslim, *Birr*, 120-124.
13. Buhari, *Edeb*, 18; Muslim, *Fedail*, 164.
14. Mevlana, *Rubailer*, bot. Shefik Khan, Nr. 544.
15. Shih. Tecrid Tercümesi, XII, 128.



PËR ALLAHUN, KRIJUESIN E GJITHÇKAJE

Erdha në këtë jetë me dritë
por errësira e botës më mbuloi
Jetova për ca kohë e zymtë,
por përsëri drita tek unë ndriçoi.

Allahu i Madhërueshëm desh e më udhëzoi
në rrugën e drejtë me Kur'an, Ai më drejtoi.
Nga shpirti im nxori një mirësi
që unë dua ta kem në përjetësi.



Tani që unë e kuptoj se Ti je një,
dua të të adhuroj përgjithnjë,
se Ti je Ai që gjithçka që ekziston krijoi
Ti je i vetmi që e mbajti atë çka premtoi.

Të falem me shpirt o Rahman
që zemrën time ta udhëzosh në Islam.
Të falem Ty që shumë mundësi na dhe
në rrugën Tënde të jemi edhe ne.



Se shpirti im ngrihet peshë
kur emri Yt përmendet me zë,
prandaj dua që gjithnjë me mua të jesh
që të mos kem frikë nga asgjë.

Na fal Ti me gabimet tona,
në errësirë mos lejo të shkojnë zemrat tona.
Gjithnjë të lutemi të na udhëzosh
në rrugën e drejtë të na drejtosh.

Senada REXHA

Islami nuk është fe e terrorit



Si rezultat i zhvillimit të mjeteve të ndërlidhjes dhe komunikacionit, bota është kthyer në një fshat të madh. Në një fshat të tillë, ndikimi mbi njerëzit tashmë është bërë tejet e lehtë, gjë që po e nxjerr gjithmonë e më shumë forcën e mjeteve të komunikimit masiv në plan të parë. Ndërkaq, sa keq që mjetet e komunikimit masiv ose, siç i thuhet shkurt, medja, vitet e fundit, në shumë vende të botës, po bën përpjekje të mëdha për ta treguar Islamit si fe të terrorit. Përballë këtyre përpjekjeve që burojnë pjesërisht nga mosnjohja e Islamit, domethënë, nga injoranca, por edhe nga mungesa e përpjekjeve për ta njohur atë, pjesërisht nga paafësia e muslimanëve për ta përfaqësuar dhe prezantuar Islamit ashtu siç duhet dhe, pjesërisht, edhe nga keqdashja, është detyra e muslimanëve që t'i tregojnë të vërtetat siç janë.

Islami me kuptimin kryesor dhe veçoritë themelore të tij
Fjala islam vjen nga rrënja *silim*

që do të thotë *pajtim, paqe, nënshtrim dhe shpëtim*. Të gjitha fetë qiellore para Islamit kanë ardhur për një fis, komb apo popull të caktuar dhe secila prej tyre ose kishte përmbajtjen e një feje kombëtare, ose u suall më vonë në formën e një feje kombëtare. Ishte e para herë në historinë e njerëzimit që Islami vinte si fe për të gjithë njerëzimin, po kështu, edhe profeti Muhammed (s.a.s.), si profet për të gjithë njerëzimin. Duke iu drejtuar atij, Zoti thotë në Kur'an: "Ne të dërguam ty tek i gjithë njerëzimi si lajmëruesi i mëshirës sonë dhe si paralajmëruesi i ndëshkimit tonë!" (Sebe, 34/28) Me këtë, Muhammedi është profeti i parë i nderuar me një detyrë drejtuar gjithë njerëzimit. Madje, profeti Muhammed është profeti i mëshirës i dërguar jo vetëm për njerëzit, por për të gjitha botët, sepse në Kur'an thuhet: "Ne të dërguam ty si mëshirë për të gjitha botët (të gjallë e të pagjallë, njerëz e xhindë, shpirtërorë e fizikë)!" (Enbija, 21/107)

Islami është fe e tevhidit, besimit

monoteist mbi Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë. Pra, në fushën e besimit, Islami mbështetet në besimin vetëm te Allahu si zot, gjykatës dhe sundues. Kurse për sa i përket botëkuptimit, vështrimit mbi jetën dhe sistemit shoqëror, tevhidi kërkon bashkimin dhe unitetin e njerëzve, vëllazërinë mes tyre, barazi në të drejtat themelore, mospranimin kategorik të dallimeve gjuhësore, racore e familjare.

Islami i cili i e ka mbyllur epokën e feve kombëtare në historinë e njerëzimit, i fton njerëzit të bashkëjetojnë në liri në kuadrin e të njëjtave ligje. Islami ka ndaluar dhe ka hequr në masë të madhe çdo lloj egoizmi, egërsie, dhune e padrejtësie si veçori të periudhës paraislamike e, në përgjithësi, të regjimeve shoqërore të egra të bazuara në injorancën, paditurinë dhe primitivitetin. Sipas Islamit, njeriu nuk është ujk, por vëlla për njeriun, jeta nuk është luftë, por një proces ndihme e dyanshme. Në vend të parimit "puno ti që të ha unë", Islami vendosi parimin e "solidaritetit", vendin e padrejtësisë dhe dhunës ia la drejtësisë, vendin e egërsisë ia la mëshirës dhe dhembshurisë. Islami solli parimet, sipas të cilave njerëzit janë të lirë e të barabartë në krijim dhe çdo njeri ka të drejtë me aq sa punon dhe përpiqet. Duke shkukur nga mendjet parimet mizore, sipas të cilave e drejta është te forca dhe i forti ka të drejtë, Islami vendosi në vend të tyre parimet, sipas të cilave forca është te e drejta dhe është i fortë ai që ka të drejtë. Me Islamit, popujt i janë dorëzuar jo maturisë së paqenë të ligjeve egoiste



Profeti Muhammed është profeti i mëshirës i dërguar jo vetëm për njerëzit, por për të gjitha botët, sepse në Kur'an thuhet: “Ne të dërguam ty si mëshirë për të gjitha botët (të gjallë e të pagjallë, njerëz e xhindë, shpirtërorë e fizikë)!”

dhe subjektive të nxjerra nga një pakicë fitimtare apo nga sundues despotë, por parimeve të së vërtetës dhe drejtësisë të vëna nga Krijuesi.

Islami i ka shpallur të gjithë njerëzit të nderuar pa bërë ndonjë dallim politik-shoqëror, material-shpirtëror dhe racor-hierarkik mes tyre, si dhe i ka dhënë njeriut një vend mbi qeniet e tjera:

“Ne e bëmë njeriun të nderuar!”
(Isra, 17/70)

Sipas Islamit, është e ndaluar (haram) prekja e pasurisë, jetës dhe nderit të personit edhe sikur ai të jetë mohues. Shëndeti i mendjes dhe i trupit, liria e ngritjes së familjes janë marrë nën mbrojtje për çdo njeri. Po kështu, nuk mund të preken as të drejtat dhe liritë e tjera themelore. Edhe në situatë lufte, gratë, fëmijët dhe pleqtë që nuk marrin pjesë në luftë, nuk preken. Sipas drejtësisë së pastër të sjellë nga Kur'ani, vrasja e një njeriu të pafajshëm konsiderohet një krim i madh sa ç' do të ishte vrasja e gjithë njerëzimit. Sipas Islamit, e drejta e një personi kushdo nuk mund të shkelet edhe sikur kjo të jetë në dobinë e përgjithshme. E drejta e një njeriu të vetëm është po aq e nderuar dhe e shenjtë sa edhe e drejta e gjithë njerëzve. (Maide, 5/32)

Shembuj historikë
të tolerancës dhe mirëkuptimit

Eshtë si rrjedhojë e kësaj përparësie dhe paprekshmërie që i njohu Islami njeriut, që në historinë e tyre, muslimanët, kudo që shkuan, çuan drejtësinë, çuan lirinë, çuan njerëzinë. Gjatë kësaj periudhe historike, kalifët u patën dhënë komandantëve ushtarakë që i dërgonin në front, po atë porosi që i pati dhënë Hz. Ebu Bekri Hz. Usames kur po e dërgonte për në Siri. Porosia për Usamen e dhënë prej Hz. Ebu Bekrit që vepronte në gjurmët e Profetit, përmbahet në burimet bibliografike e historike:

“O Usame! Mos bëni tradhti, mos bëni padrejtësi, mos grabisni, mos gjymtoni kufomat, mos vrisni fëmijët, pleqtë dhe gratë, mos prisni e mos digjni kopshtet me hurma, mos prisni as pemët e tjera me fruta, mos vrisni kafshë të imta e të trasha pa pasur nevojë për ushqim. Gjatë rrugës mund të hasni njerëz të tërhequr në adhurim nëpër tempuj e faltore, mos i prekni dhe mos iu përzieni në adhurim...” (Ibnu'l-Ethir, 2:335)

Këtu duhen kujtuar edhe disa rreshta nga teksti i marrëveshjes së bërë nga Profeti (s.a.s.) me krishterët e Nexhranit, si një model profetik për muslimanët gjer në kiamet:

“Mbrojtja nën kujdesin e Allahut dhe përgjegjësinë e Muhammedit, të Dërguarit të Allahut, të pasurisë, jetës, praktikës fetare dhe e çdo gjëje të shumtë apo të pakët që ndodhet në pronësinë e të pranishmëve apo të të tjerëve që nuk janë të

pranishëm, është një e drejtë e nexhranasve dhe banorëve të lidhur pas tyre. Asnjë peshkop nuk do të nxirret jashtë zonës së detyrës së tij fetare, asnjë prift nuk do të nxirret jashtë kishës ku kryen detyrat e tij kishtarë, asnjë murg nuk do të merret e largohet nga manastiri ku jeton... Ata as do të bëjnë padrejtësi, as nuk do të pësojnë padrejtësi. Askush prej tyre nuk do të bëhet përgjegjës për fajin apo padrejtësinë e kryer nga dikush tjetër.” (M. Hamidullah, 1:622)

Një krishter që ndodhej pranë sahabes Garafe ibn Harith, thotë fjalë fyese dhe mohuese për Profetin. Duke mos e duruar këtë, Garafe hidhet mbi personin dhe gjatë përleshjes mes tyre, krishterit i thyhet hunda. Krishteri shkon menjëherë te Amr Ibnul As-i dhe ankohet për Garafen. Amr Ibnul As-i e merr në pyetje Garafen dhe e qorton:

“Ne u patëm dhënë garanci atyre, pse bëre kështu?”

Garafe ia shpjegon:

“Gjithsesi, atyre nuk iu dha garanci për ta fyer të Dërguarin e Allahut! Me sa di unë, atyre u është dhënë garanci vetëm:

1) Se nuk do t'u përzihemi në kishë; ata do të falen atje si të duan.

2) Se nuk do t'u ngarkojmë përgjegjësi që s'mund t'i përballojnë.

3) Se po t'i sulmojë armiku, do të luftojmë pranë tyre.

4) Se për çështjet mes tyre do të vendosin si të duan vetë.

5) Se për ata që dëshirojnë të ndjekin ligjet tona, do të vendosim siç kanë urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, por, në qoftë se s'duan, nuk do t'i shtrëngojmë."

Atëherë, Amr Ibnul As-i iu përgjigj:

"E drejtë, ke të drejtë!" (Ibn Asdi'l-Berr, 3:193-194)

Në kohën e Hz. Omerit, në vitin 14 h / 635 e.r., pushtohet qyteti Humus. Por një vit më vonë, kur vjen lajmi mbi sulmin e Heraklitit me një ushtri prej 200.000 vetësh, muslimanët mbeten të detyruar ta zbrazin qytetin. Dhe, duke u larguar nga qyteti, ua kthejnë banorëve xhizjen (tatimin e mbrojtjes) që ua kishin mbledhur dhe u thonë kështu:

"Duke ua marrë këtë tatim, ju patëm garantuar sigurinë, kurse tani s'mund t'ju mbrojmë, prandaj mbrohuni vetë!"

Populli i Humusit, me krishterë e çifutë, që e dinte ç'ishte sundimi bizantin, nuk gëzohen nga kjo gjendje, por dëshpërohen shumë. Popullsia krishtere thotë kështu: "Sundimi dhe drejtësia juaj na u dukën më të mirë se padrejtësitë dhe dhuna nën të cilat tishim jetuara para jush. Do të bashkëpunojmë me guvernatorin tuaj dhe do ta mbrojmë qytetin kundër ushtrisë së Heraklitit!"

Kurse çifutët thanë:

"Betohemi në Teuratin se guvernatori i Heraklitit nuk ka për të hyrë në qytetin e Humusit pa kaluar mbi trupat tanë!"

Si përfundim, popullsia vendase i mbyllin portat e qytetit dhe bëhen gati për mbrojtje. Ushtritë e Heraklitit nuk e pushtuan dot qytetin dhe u larguan. Atëherë, popullsia e qytetit i ftoi përsëri muslimanët ta merrnin pushtetin.

Belazuri që e tregon këtë ngjarje, vazhdon kështu: "Edhe qytetet e tjerë krishterë dhe çifutë që e parapëlqenin administrimin e muslimanëve, u suallën vepruan në të njëjtën mënyrë. Ata thanë: "Po që se bizantinët dhe ndjekësit e tyre dalin fitues mbi muslimanët, do të kthehemi në gjendjen e mëparshme. Në të kundërt, edhe sikur vetëm një musliman të mbetet, do të bëjmë sipas marrëveshjes!" (Belazuri, 1987, 187)

Muslimanët, jo vetëm i patën lejuar anëtarët e feve të tjera që kishin nën administrim, të praktikonin besimin e tyre, por s'patën parë ndonjë të keqe që xhamia, kisha dhe sinagoga të



ndodheshin pranë e pranë, për më tepër, patën lejuar që ndërsa në të njëjtën faltore, të faleshin në të njëjtën kohë, muslimanët në një të ndarë dhe krishterët, në një të ndarë tjetër. Ky mirëkuptim i nisur një ditë të diel kur profeti e pati lejuar delegacionin e krishterëve të qytetit Nexhran të kryenin ritet në xhaminë profetike, pati vazhduar edhe me kalifët e parë. Po kështu, të njëjtat praktika qenë zbatuar edhe në Kordovë, nën administrimin e omejadëve të Andaluzisë. (Özdemir, 1994, 1:68)

Përfaqësimi dhe kumtimi i Islamit

Islami e njuh si një të drejtë të padiskutueshme lirinë e besimit për njeriun, të cilin ai e pranon si qenien më të nderuar me vetëdije e vullnet. Për rrjedhojë, Islami mban për parim heqjen e pengesave mes Allahut dhe mendjes, vetëdijes dhe vullnetit të njeriut. Dhe duke e prezantuar veten me këtë qëllim, thekson se përfaqësimi dhe kumtimi duhen bërë edhe duke e jetuar vetë Islamin, edhe duke e treguar në mënyrën më të mirë.

Për shembull, në shumë ajete të Kur'anit bëhet e ditur se Profetit tonë si dhe profetëve të tjerë nuk u bie detyrë tjetër veç kumtimit të hapur (Nahl, 16/35, 82; Al-i Imran, 3/20; Maide, 5/92, 99; Ra'd, 13/40; Ibrahim, 14/52; etj.). Veç kësaj, Profetit i tërhiqet vëmendja se nuk është detyrues: "Kujtojuva njerëzve! Fundja, ti je vetëm një paralajmërues dhe jo një detyrues mbi ta!" (Tegabun, 88/22)

Para Islamit, disa nga ensarët, me mendimin se feja e ndjekësve të librit ishte më e mirë se e tyrja, veçanërisht kur s'u rronin fëmijët, ua kushtonin ata fesë së ndjekësve të librit. Për këtë shkak, kur erdhi Islami, disa nga fëmijët e ensarëve ndodheshin në fenë e ndjekësve të librit dhe, kur familjet deshën t'i detyrojnë ata të ktheheshin në muslimanë, zbriti ajeti që thoshte: "Në fe nuk ka detyrim. Më në fund, e drejta me të shtrembrën janë dalluar nga njëra-tjetra..." (Bakara, 2/256) (Dhuhejli, 1991, 3/20)

Për shkak të këtyre parimeve kur'anore, gjatë gjithë historisë, muslimanët nuk e kanë detyruar popullsinë vendase të vendeve të pushtuara ta pranonin Islamin. Madje, disa autorë anglezë, pasi tërheqin vëmendjen mbi këtë aspekt të Islamit bëjnë këtë pohim kuptimplotë:

“Po qe se në Azi, në vend të arabëve dhe turqve, do të dominonin krishterët e Perëndimit, sot s’do të kishte mbetur asnjë shenjë nga kisha greke (bizantine). Dhe mirëkuptimin dhe tolerancën që kanë treguar atje këta të pafe (muslimanët) ndaj krishterëve, krishterët kurrë nuk do ta tregonin ndaj muslimanëve!” (Toynbee, 1987, 285)

Muslimanët nuk i prekën aspak vlerat lokale të vendeve ku shkuan, përkundrazi, i ruajtën ato si një muze etnografik. Bie fjala, pasi osmanët u tërhoqën nga Europa Lindore, Afrika Veriore dhe Lindja e Mesme, dolën në shesh shumë kombësi me fe, gjuhë dhe veshje të ndryshme.

Konsiderata mbi njeriun

Një shkak i dytë që i ka penguar muslimanët të përdorin detyrimin në kumtimin e fesë, kanë qenë konsideratat mbi njeriun po në Kur’an.

Sipas këtyre konsideratave, njeriu, në krahasim me llojet e tjera të gjallesave, si bimët, kafshët dhe engjëjt, ka një krijim të ndryshëm. Ai është krijuar i prirur edhe për të mirën, edhe për të keqen; duke i dhënë mendje (arsye), vullnet dhe aftësi njohëse, është dashur që njeriu, me vullnetin e vet të lirë, të priret nga e mira, të zgjedhë të mirën, të bukurën e të dobishmen. Prandaj njeriu ka përgjegjësi për zgjedhjen që bën. Fakti që njeriu është qenie që mban përgjegjësi për ato që bën, është rrjedhojë e kësaj veçorie të tij.

Për muslimanin, jeta e kësaj bote është një provë. Në këtë provë të vënë para tij me qëllim për ta fituar jetën e pasme, ahiretin, përdorimi nga njeriu i vullnetit të vetë është bazë. Siç nuk është përgjegjës për mëkatin që detyrohet ta kryejë me anë të shtrëngimit, është shumë e diskutueshme nëse njeriu ka ndonjë përfitim shpirtëror nga e mira që gjithashtu detyrohet ta kryejë me shtrëngim! Për rrjedhojë, në kumtimin e Islamit kurrë nuk është

përdorur shtrëngimi dhe as që mund të përdoret.

Synim legjitim, mjet legjitim dhe fjalë e butë

Islami thekson edhe se drejt një synimi legjitim duhet shkuar gjithmonë me mjete dhe rrugë legjitime. Siç është synimi legjitim, ashtu dhe mjetet dhe rrugët që do të çonin për tek ai, duhet të jenë legjitime. Prandaj, Islami nuk i pranon në asnjë mënyrë si mjet shtrëngimin, torturën, anarkinë dhe terrorin. Përtej kësaj, urdhëron që, duke kumtuar, të përdoren fjalë të buta edhe ndaj tiranëve si faraoni.

Kur’ani e shpreh kështu këtë urdhër të dhënë Hz. Musait dhe Harunit: “... Shkoni te faraoni se ai u tërbua shumë. Dhe folini me urtë e butë. Mund të ndodhë që ta mbledhë mendjen ose, të paktën, druhet!” (Ta-Ha, 20/43-44)

Në këtë çështje, në njërin prej ajeteve që përcaktojnë marrëdhëniet me ndjekësit e Librit, thuhet: “Përveç atyre nga ndjekësit e Librit që bëjnë padrejtësi, përpiquini me ta në mënyrën më të mirë dhe thojuni: “Ne i besuam edhe asaj që na u zbrit neve, edhe asaj që iu zbrit juve. Edhe Zoti ynë, edhe Zoti juaj janë një. Ne i jemi nënshtruar atij!” (Ankebut, 29/46)





Triumfi i Mekës si njëra nga fushatat më me rëndësi, është një lëvizje paqeje dhe triumfi që s'i gjendet shoqja në historinë e njerëzimit, sepse gjatë kësaj fushate të zhvilluar me zgjuarsinë profetike të të Dërguarit të Allahut dhe me rrugë paqësore, nuk u bënë grabitje, nuk u vranë apo nuk u internuan njerëz, nuk u muar shpagim, nuk u bë gjakmarrje.

Në një ajet tjetër që u drejtohet ndjekësve të Librit, përcaktohet kështu: "Thuaju: "O ju, ndjekës të Librit! Ejani me ne në një fjalë të përbashkët që ta adhurojmë vetëm Allahun, të mos i bëjmë shok askënd Atij, të mos e lëmë Allahun për ta bërë zot njëri-tjetrin!" (Al-i Imran, 3/64) Duam ta përmendim edhe këtë ajet në lidhje me përcaktimin e metodës që duhet ndjekur për t'i ftuar të gjithë njerëzit në rrugën e drejtë, përfshi edhe ndjekësit e Librit meqë nuk ka ndonjë kufizim për

këtë: "Thirri (ata) në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshilla të mira dhe përpiqu me ta në mënyrën më të mirë..." (Nahl, 16/125) Një tjetër ajet e shpreh si "mëshirë nga Allahu" trajtimin me butësi të bashkëbiseduesve nga Profeti dhe tërheq vëmendjen se, po të sillet ashpër, edhe ata që ka përreth do të largohen prej tij e do të shpërndahen! (Al-i Imran, 3/159)

Profeti (s.a.s.) i kushtonte shumë rëndësi bindjes së njerëzve mbi bukurinë e Islamit dhe mbi përfaqësimin personal të tij prej tyre. Ndodhte që, për këtë qëllim, e përdorte xhaminë si një vitrinë, si një vend ekspozimi. Për shembull, disa delegacione të huaja i priste në xhami. Ata hanin, rrinin e flinin aty, shihnin se si rreshtoheshin muslimanët në namaz dhe dëgjonin këndimin e Kur'anit natën. (Vakidi, 1966, 3:964-65) Ka ndodhur që Profeti t'i lidhë disa fajtorë në shtyllat e faltores. Duke parë gjërat e përshkruara më lart, këta fajtorë, duke marrë një mësim efektiv, përmirësoheshin, madje politeistët hynin në Islam. Ka shumë shembuj individësh të ftuar në këtë mënyrë. Thumame Ibn Usal ishte njëri nga këta. Thumame ishte një mushrik, politeist i përzjerë në shumë faje. Profeti arriti ta zinte dhe e lidhi në një shtyllë të faltores. Tri ditë më pas, Thumame u bë musliman dhe hodhi nënshkrimin nën shërbime të mëdha për Islam. (Buhari, Megazi, 70; Muslim, Xhihad, 59)

Paqja botërore dhe Islami

Për ta kuptuar se sa rëndësi i jep Islami paqes, duhet njohur përmbajtja e luftërave të bëra nga Profeti. Po të shqyrtohet nga afër, shihet se, në fakt, këto luftëra janë me qëllim mbrojtjeje.

Lufta e parë e bërë me mekasit është lufta e Bedrit. Kjo luftë është menduar si një fushatë edhe me qëllim për t'ua thyer armiqësinë

kurejshve që i kishin përzënë muslimanët nga shtëpitë dhe vendi, e për t'i bërë që të anojnë nga paqja duke ua bërë të qartë se sa rëndësi kishte Medina nga pikëpamja ekonomike, edhe për t'ua marrë prapë mallrat e grabitura të muslimanëve të mbetura në Mekë dhe të ngarkuara në karvan për t'i çuar dhe shitur në Siri. Pra, qëllimi në vetvete s'ishte lufta.

Lufta e Uhudit e zhvilluar pas kësaj u shkaktua nga mekasit të cilët shkuan gjer në Medinë për të marrë shpagim për humbjen e Bedrit. Për muslimanët, kjo ishte krejtësisht një luftë mbrojtëse. Po kështu, edhe lufta e Hendekut ishte një luftë mbrojtëse e muslimanëve të pozicionuar pas hendeqeve të hapur përreth Medinës që e kishin rrethuar ushtritë idhujtare dhe, siç dihet, u zhvillua jo vetëm kundër mekasve, por kundër të gjitha fiseve politeiste të bashkuar në një radhë me ta.

Pothuajse të gjitha luftërat ku mori pjesë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), patën për qëllim ose për të sprapsur sulmet e ushtrive të mëdha, ose për të prishur përgatitjet e sulmeve të diktura me anë të shërbimit të zbulimit. Të gjitha fushatat apo luftërat serioze, si lufta e Hajberit, lufta Benu Mustalik, fushata e Mute-s, fushata e Tebukut, etj., i përkasin njërit nga dy llojet e luftërave të zhvilluara në Bedër, Uhud dhe Hendek.

Kurse triumfi i Mekës si njëra nga fushatat më me rëndësi, është një lëvizje paqeje dhe triumfi që s'i gjendet shoqja në historinë e njerëzimit, sepse gjatë kësaj fushate të zhvilluar me zgjuarsinë profetike të të Dërguarit të Allahut dhe me rrugë paqësore,

- * nuk u bënë grabitje,
 - * nuk u vranë apo nuk u internuan njerëz,
 - * nuk u muar shpagim,
 - * nuk u bë gjakmarrje.
- Në përfundim të kësaj fushate

dhe të triumfit të plotë të Mekës, u shpall amnisti e përgjithshme duke përjashtuar vetëm pak vetë tejet të tërbuar e mëkatarë, të cilët e patën kaluar gjithë jetën me armiqësi aktive kundër Islamit dhe muslimanëve dhe vazhdonin ende në të njëjtën rrugë, të cilët u përpoqën t'i kundërviheshin me shpatë triumfit të Mekës, të cilët, duke dalë jashtë rregullave luftarake të kohës, shkëlën të drejtën ndërkombëtare dhe që, sipas cilësimit të sotëm, futeshin në statusin e fajtorëve të luftës. Kjo është, në emër të njeriut, një tablo krenarie, një medalje që do të mbahet përjetësisht.

Muhammed Hamidullah bën të ditur se në luftërat e zhvilluara nga Profeti gjatë periudhës 10-vjeçare të Medinës, numri i politeistëve të vrarë është rreth 250, ndërkaq që në këtë periudhë, i gjithë Gadishulli Arabik, me një sipërfaqe prej 1.5 milion kilometrash katrorë, i qe nënshtruar Islamit. (Xhanan, 1998, 2:298-301)

Paqja e Hudejbijes
dhe koncepti *triumf* në Kur'an

Përta kuptuar konceptin *triumf* të përdorur në Kur'an, mjafton të tregojmë se është përdorur për paqen e Hudejbijes. Siç dihet, në vitin e gjashtë të hixhretit, Profeti (s.a.s.) doli në rrugë me 1500 muslimanë për ta bërë Qaben tavaf. Ndërkaq, një njësi ushtarake i zu rrugën në vendin e quajtur Hudejbije afër Mekës dhe ia bëri të ditur se nuk do t'i lejonte ta vizitonin Qaben. Debatet dhe bisedimet përfunduan me një traktat paqeje. Fundja, Profeti gjithmonë ka anuar nga paqja.

Profeti (s.a.s.) kishte bindjen se mjedisi paqësor ishte i domosdoshëm për kuptimin e Islamit nga të tjerët. Sipas tij, ishte jashtë çdo diskutimi se, po qe se Islami si fe e natyrshme dhe e arsyeshme, do të kuptohej ashtu siç

duhej, asnjë njeri me arsye të shëndoshë nuk do ta kundërshtonte, do t'i dilte kundër, nuk do t'i bëhej armik. Prandaj, duhej bërë një marrëveshje dhe duhej përgatitur një trull i përshtatshëm, domethënë, një mjedis paqeje që do t'u jepte mundësi njerëzve që, duke hyrë në marrëdhënie shoqërore, miqësore dhe tregtare me muslimanët, t'i shihnin dhe njihnin nga afër Islamit dhe muslimanët. Ndërkohë, mekasit i nxirrnin Profetin një mijë e një vështirësi dhe i paraqisnin

Profeti (s.a.s.) e pranoi marrëveshjen, sepse ai nuk ishte përkrahës i luftës, por i paqes dhe nuk kishte pikë dyshimi mbi të vërtetën e Islamit. Ja, për këtë paqe e përdor Kur'ani shprehjen "një triumf i qartë".

propozimit të tij për paqe kushte të papranueshme. Megjithatë, për ta arritur marrëveshjen, Profeti i pranoi kushtet e tyre të cilat, në çastin e parë, u erdhën shumë të rënda disa muslimanëve. Për shembull, muslimanët nuk do të hynin në Mekë atë vit, por do të mund ta vizitonin atë vetëm pas një viti nën disa kushte; ndërsa politeistët mekas që do të bëheshin muslimanë dhe do të kërkonin strehim në Medinë, do të ekstradoheshin, kjo nuk do të ndodhte me muslimanët medinas që do të ktheheshin nga feja dhe do të kërkonin strehim në Mekë. Këto ishin dy nga kushtet e rënda të marrëveshjes ose, asaj që quhet Pakti

i Hudejbijes. Pavarësisht nga këto, Profeti (s.a.s.) e pranoi marrëveshjen, sepse ai nuk ishte përkrahës i luftës, por i paqes dhe nuk kishte pikë dyshimi mbi të vërtetën e Islamit. Ja, për këtë paqe e përdor Kur'ani shprehjen "një triumf i qartë". (el-Feth, 48/1)

Përfundim
dhe një tërheqje vëmendjeje

Meqë është vendi, le ta bëjmë të qartë këtë specifikë: Disa mjedise antiislame që mendojnë se paqja është në interes të muslimanëve, nuk dëshirojnë që muslimanët të jenë në paqe me botën jomuslimane, përpiqen që muslimanët të jenë vazhdimisht në grindje me këtë botë dhe të krijojnë kushte e mjedise konflikti dhe lufte. Veç kësaj, ata nxjerrin në plan të parë disa liderë muslimanë të cilët me botëkuptimin e tyre Islam të gabuar, nxjerrin në shesh një imazh të Islamit të kundërt me Islamit, si dhe disa pushtetarë të vendeve islame me influencë. Prandaj duhet të themi se muslimanët duhet të jenë shumë të kujdesshëm në këtë drejtim.

Përkthyes: Mithat Hoxha

Burimet:

- Belazuri, Futuhu'l-Buldan, Bejrut, 1987.
- Canan, <brahim, Peygamberimizin Tebliq Metodlar>, Nesil Yay. <istanbul, 1998.
- En-Nebhani, Yusuf, el-Fethu'l-Kebir.
- Hamidullah, Muhammed, <slam Peygamberi, përkth. Salih Tu>.
- Ibn Abdilber, el-Isti'ab.
- Ibnu'l-Ethir, el-Kamil fi't-Tarih.
- Özdemir, Mehmet, Endülüs Müslümanlar -1, Ankara, 1994.
- Toynbee, Arnold, Tarihi Açınsından Din, Kayihan Y. <istanbul 1987.
- Turhan, Osman, Türk Cihan Hakimiyeti Tarihi, <istanbul, 1969.
- Vakidi, Megazi, Oxford, 1966.

Stili i orientimit dhe mirësisë

Ibrahim Hakiut të ftuar në një fshat për predikim dhe këshilla gjatë muajit të ramazanit, i kishin dërguar një shërbëtor armen që bënte këtë punë, dhe një kalë. Ibrahim Hakiu i shoqëruar nga shërbyesi doli në rrugë. Ndërkaq, meqë kishin vetëm një kalë, domethënë, vetëm një mjet rrugëtimi, Ibrahim Hakiu zbatoi moralin e lavdëruar të Omerit (r.anh) i cili, duke shkuar për në Jeruzalem, e kishte përdorur devenë duke u këmbyer me radhë me skllavin e vet që e shoqëronte.

Shërbëtori armen kundërshtoi:

“Zotëri, po t’u bjerë në vesh kjo gjë fshatarëve, edhe më shajnë, edhe s’ma paguajnë shpërblimin!”

Dhe me gjithë këmbënguljen e shërbëtorit, Ibrahim Hakiu nuk ia pranoi kundërshtimin. Ai i tha:

“Biri im, s’dihet se si do ta kemi hallin në frymën e fundit! Ti druhash se mos të të shajnë fshatarët, kurse unë frikësohem nga llogaridhënia e madhe para Allahut!”

Ibrahim Hakiu vuri radhë.

Siç kishte ndodhur me Hz. Omerin, kur do të hynin në fshat, radha për të hipur në kalë i ra shërbëtorit armen. Megjithëse shërbëtori i shkretë, me frikën nga fshatarët, i tha disa herë Ibrahim Hakiut se hiqte dorë nga radha e vet dhe e luti të hipte e ashtu të hynin në fshat, Ibrahim Hakiu i tha shërbëtorit me vendosmëri se e kishte radhën, dhe u vu të prijë para.

Kështu, shërbëtori i hipur mbi kalë, kurse Ibrahim Hakiu në këmbë duke prirë, hynë në fshat.

Kur e panë këtë gjë, fshatarët e qarkuan shërbëtorin dhe zunë ta shajnë:

“Pa shih, i paturpi! Je ngrefosur mbi kalë, kurse këtë plak mjekërbardhë e ke vënë të ecë më këmbë! A kjo është besnikëria jote? Kështu të porositëm ne ty?”

Por pasi Ibrahim Hakiu ua bëri të qartë se si ishte puna, fshatarët heshtën. Ndërkaq një fshatar i zgjuar i tha kështu shërbëtorit armen:

“O njeri! E pe çfarë virtyti dhe e jetove vetë! Të paktën, bëhu musliman!”

Pasi ndenji ca çaste i heshtur, shërbëtori armen u tha fshatarëve që ndodheshin aty këto fjalë me kuptim të thellë mësimdhënës:

“Po qe se më ftoni në fenë tuaj, kurrë! Por po të më ftoni në fenë e këtij njeriu të bekuar, fesë së tij i kam besuar që në rrugë!”

Ky shembull i shpalosur nga një mik i të Vërtetit, me zemrën të gjerë, është një mënyrë sjelljeje apo një stil i orientimit dhe mirësisë. Sjellja ndaj njeriut duke parë më shumë në esencën e tij, në një kuptim, do të thotë ta vështrosh krijesën me vështrimin e Krijuesit. Prandaj, zemrat e mira mendojnë se njeriut i është dhuruar nderi për të qenë zëvendësi i Zotit mbi tokë dhe, siç shprehet ajeti kur’anor, i “është fryrë një e fshehtë nga fuqia e Zotit të vet” dhe, sado i fëlliqur me mëkate të jetë robi, ata shohin përsosmërinë në esencën e tij dhe nuk ia kthejnë shpinën. Ata nuk e presin lehtë shpresën prej njeriut, veç kësaj, bëjnë që vetë ai njeri të mos e humbë shpresën. Ky, me të vërtetë është një shkak arsyeje dhe ndjenje që s’mund të mohohet. Kështu, Zoti na ka sugjeruar në Kur’an më shumë emrat e tij *Rahman* dhe *Rahim*, ka zbritur



Sugjerimi me një stil shpresëdhënës duke nxjerrë në plan të parë jetën dhe gjithësinë, mëshirën dhe mirësinë e Allahut, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shoqërinë tonë e cila, nën ndikimet negative materialiste, ndodhet në këtë kohë në një krizë shpirtërore si ajo e perëndimit. Jo t’i shtysh njerëzit në konflikte ideore, por t’i fitosh në ndjenja, është një rrugë më realiste, sepse një shumicë e tyre mund të jenë vënë nën kushtëzime të gabuara.

një sure me emrin “er-Rahman” / “Mëshiruesi” (mëshirues i të gjithë njerëzve, mohues e besimtarë) ku ajeti i patë nis me “er-Rahman”.

Prandaj, pozicionimi ndaj njerëzve nga kjo dritare zemre, pra nga pikëvështrimi i stilit të orientimit dhe mirësisë, përmban një specifikë më të suksesshme për fitimin e pëlqimit hyjnor dhe, për sa i përket përfundimit shumë të begatë, gjithashtu, blerues të bukurive të larta që ndodhen të fshehura tek njeriu. Sepse ky stil ka për veti t’i përftojë edhe atij që e zbaton, edhe bashkëbiseduesit, pra, të dy palëve, një delikatesë, pjekuri dhe intuitë të veçantë, si dhe karakteristika të interesimit për të vërtetën. Ky stil është një eliksir që i ka bërë Junusët Junusë, Mevlanatë Mevlana dhe që u ka dhënë jetë sa e sa shpirtave të sëmurë të vdekur moralisht e shpirtërisht!

Prandaj, si përmbajtja e tasavvufit, si përdorimi në kumtimin islam i stilit të tij të posaçëm, ka paraqitur në çdo kohë një rëndësi të madhe. Mistikë të mëdhenj si Mevlana dhe Junus Emre janë bërë pothuaj burime paqeje, qetësie dhe preheje dhe u kanë ofruar shërim dhe ngushëllim masave të rëna në krizë shpirtërore, plagëve që kullojnë gjak dhe zemrave të lodhura. Shumë e shumë indiferentë e të paditur ata i kanë konsideruar si të sëmurë që presin t’i shpëtojnë dhe, në sjelljet e tyre ndaj të tjerëve kanë jetuar gjithmonë larg urrejtjes dhe përbuzjes. Sa bukur shprehet poeti Junus Emre:

*Unë s’erdha për të gjykuar,
Puna ime është të dua;*

*Zemrat janë shtëpi e mikut,
Zemra erdha për të fituar...*

Ngaqë këta personalitete të mëdhenj kanë ardhur për të fituar zemra, i kanë parë njerëzit gjithmonë nga dritarja e zemrës dhe, duke predikuar përreth gjithmonë dashuri dhe dhembshuri, janë bërë pretekst për orientimin në rrugë të drejtë të sa e sa njerëzve. Po qe se ata do të vepronin në të kundërt të këtyre sjelljeve të bukura e të virtytshme, përfundimi do të ishte këputja e plotë e lidhjeve me njerëzit me të cilët i ndante humnera dhe, si rezultat, do të humbej mundësia për t’u kumtuar njerëzve të tillë të vërtetën, gjë që do të binte ndesh me dëshirën hyjnore. Sepse Zoti dëshiron shpëtimin e robve të vet nga baltovina ku kanë rënë dhe për këtë ka dërguar profetë gjatë gjithë historisë njerëzore duke i urdhëruar t’i pastrojnë zemrat me shprehjet më të mira. Kështu, sa e sa shpirta të mbushur me gjemba janë kthyer në trëndafila dhe zemra si burgje janë mbushur me dritë. Duke aluduar për këtë të vërtetë, Hz. Mevlanai e sugjeron domosdoshmërinë dhe rëndësinë e orientimit për në rrugën e drejtë të njerëzve qoftë mosbesimtarë, qoftë mëkatarë, si dhe stilin për këtë, me këto fjalë:

“Megjithëse hekuri është i zi e aspak i bukur, po të fshihet e të lustruhet, i ikën ndryshku. Qoftë edhe prej hekuri, një pasqyrë zbukurohet e shkëlqen pasi të lustruhet dhe mbi të duken format dhe trajtat!”

“Mos e turbullo ujin e qytetit të zemrës që të shohësh në të hënën dhe yjet që shëtisin, sepse njerëzit

i ngjasin ujit të lumit: me t’u turbulluar uji, nuk mund t’ia shohësh fundin. Kërkoje fundin e lumit se është plot me perla, me margaritarë!”

Siç shprehet Hz. Mevlanai, shpirti i njeriut është si ujë i kthjellët. Por po të turbullohet me punë të këqija dhe mëkate, në të nuk shihet më asgjë. Në këto kushte, ai ujë duhet kulluar që të mund të shihen margaritarët moralo-shpirtërorë dhe bukuritë e së vërtetës. Prandaj, qëllimi final i tasavvufit ose mistikës islame është që, duke i edukuar ndjenjat sensuale dhe egoistike, si përfundim, t’u jepet mundësi individëve dhe, si rezultat, shoqërive, të arrijnë paqen, qetësinë dhe kënaqësinë. Sepse Zoti e ka stolisur njeriun me delikatesë, elegancë dhe cilësi të larta. Edhe vlera e vërtetë e njeriut varet nga ajo se sa i vendos njeriu këto veti në botën e tij ndjesore dhe i zhvillon. Zemrat plot vlera moralo-shpirtërore janë të merituarat e moralit të bukur, të akteve të mira dhe të shfaqjeve moralo,shpirtërore. Në këtë mënyrë, robi realizon domosdoshmërinë e të qenit i krijuar në formën më të bukur, domethënë, si “krijim i përsosur”.

Duke u nisur nga të gjitha këto, asnjë njeri, sado që të ketë shkuar para në mohim, politeizëm dhe mëkat, nuk mund të lihet i privuar nga qenia bashkëbisedues i ftesës së rrugës së drejtë. Njëri prej shembujve të panumërt të kësaj në shekullin e lumtur, është edhe ky. I Dërguari i Allahut dërgoi njërin nga sahabet për ta ftuar në Islam Vahshiun i cili, duke ia varur të ungjin Hamza, e pati mbytur në hidhërim. Dhe Vahshiu i dërgoi këtë

Në fillim duhet që i sëmuri apo i plagosuri të shpëtojnë nga mikrobet, gjë që, në rastin tonë, do të thotë që zemrat të pastrohen nga mikrobi i mëkatit duke u larë me ujin e pendesës. Në fillim duhet pastruar plaga, pastaj duhet vënë ilaçi mbi të, në fillim duhen pastruar mëkatet, pastaj të veprojë shefaati, ndërmjetësimi për falje.



E dhe njerëzit tanë, bashkë me njerëzit e të gjithë botës, janë, për sa i përket besimit dhe Islamit, si zogj të plagosur. Është e domosdoshme t'u lidhen plagët me kujdes dhe ndjeshmëri, gjë që kërkon një trajtim të tyre me mëshirë dhe dashuri. Dhe kjo mund të realizohet brenda një përmbajtjeje dhe stili orientimi e mëshire të cilin u munduam ta shtjellojmë gjatë këtij shkrimi.

përgjigje:

“O Muhammed! Pse ti që ke deklaruar urdhrin e Allahut, më fton mua në Islam? Mua që kam bërë të gjitha të këqijat? Ç'rrugë shpëtimi mund të ketë për mua?”

Dhe Allahu i Lartë zbriti ajetin që thoshte:

“Thuaju: “O ju, robtë e mi që e teproni në padrejtësitë ndaj vetes! Mos e prisni shpresën nga mëshira e Allahut, sepse Allahu i fal të gjitha mëkatet. Pa dyshim, ai është Gafur (falës) dhe Rahim (mirëbërës!)” (edh-Dhumer, 53)

Më në fund, Vahshiu u qetësua me sihariqin e ajetit dhe, duke thënë, “sa e madhe është mëshira yte, o Zoti im”, bëri pendesë të thellë dhe, së bashku me shokët, u bë musliman!

Vahshiu që e pati vrarë Hz. Hamzanë në Uhud, tashmë ishte Hz. Vahshi (r. anh). Dhe, me shpresën për të fituar faljen, mes kënaqësisë shpirtërore të këtij orientimi dhe faljeje, si dëmshtëpërlim për Hz. Hamzanë, e vrau Musejlemetul Kedhdhabin, gënjeshtarin që pretendonte për profetësi, duke marrë në sy tërë rreziqet, dhe i dha fund një intrige.

Sahabet që i ndodheshin pranë, i thanë kështu Profetit:

“O i Dërguari i Allahut! Kjo falje dhe mëshirë, a mos është e posaçme vetëm për Vahshiun, apo i përfshin tërë muslimanët?”

Dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) iu përgjigj:

“Është për të gjithë muslimanët!” (Ruhul Bejan, vëll. 8, f. 124)

Zemrat e prirura për në pendesën e madhe, siç u pa edhe në këtë rivajet, i kanë dëgjuar tingujt më me ndikim të mëshirës dhe dashurisë me kuptimin e vërtetë e të plotë të fjalës, nga Profeti (s.a.s.). Shkurt, e gjithë bota njerëzore i ka dëgjuar meloditë që japin ngushëllim, shërim e prehje, nga buzët e tij të bekuara. Detin pa breg e pa anë të faljes dhe bujarisë dhe bregun e tij të shpresës,

prapë me bujarinë e Dritës së Qenies e ka parë. Edhe thirrjen hyjnore “o ju robtë e mi”, pavarësisht nga të gjitha mëkatet, e ka merituar për respekt të nderit të Krenarisë së Gjithësisë!

Prandaj, sugjerimi me një stil shpresëdhënës duke nxjerrë në plan të parë jetën dhe gjithësinë, mëshirën dhe mirësinë e Allahut, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shoqërinë tonë e cila, nën ndikimet negative materialiste, ndodhet në këtë kohë në një krizë shpirtërore si ajo e perëndimit. Jo t'i shtysh njerëzit në konflikte ideore, por t'i fitosh në ndjenja, është një rrugë më realiste, sepse një shumicë e tyre mund të jenë vënë nën kushtëzime të gabuara. Prandaj, në shumicën e rasteve, është e pamundur që të fitohen duke u përpjekur për t'i bindur me anë të debatit dhe polemikës, sepse kushtëzimet negative nuk i pranojnë argumentet racionale. Është një metodë më me rendiment që, për t'i afruar zemrat me të vërtetën, më parë t'u afrosh atyre me mirëkuptim dhe tolerancë duke u përpjekur për t'i zhvilluar prirjet e larta brenda tyre.

Madje edhe në rastin e një njeriu të mbytur në mëkate, para se të bëhet objekt i kritikave ose i propozimeve, me përparësi duhet fituar zemra e tij. Prandaj duhet punuar për ngritjen e një lidhjeje afërsie që do të formonte truallin e ndikueshmërisë së afërsisë personale dhe sugjerimit. Pasi zemra e bashkëbiseduesit të përgatitet në këtë mënyrë, mund të rregullohen dalngadalë gabimet. Veç kësaj, duhet mbajtur parasysh fryti i begatë i interesimit shpirtëror që do të zgjonin te bashkëbiseduesi premtimet dhe konsideratat materiale e moral-shpirtërore ndaj tij. Në këtë specifikë, duhet rrokur delikatesa e premtimit të Profetit (s.a.s.) i cili, duk u shprehur si më poshtë, u ka hapur një dritare qiellore zemrave të mbytura me tymra mëkati:

“Shefaati im është edhe për ata nga ummeti im që kanë bërë mëkate të mëdha!”

H.z. Mevlana e shtjellon kështu këtë qëndrim dhe shprehje të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) ndaj mëkatarëve:

“Ilaçi kërkon njerëz të plagosur e të sëmurë për t’i shëruar. Ku të ketë vuajtje, atje shkon shërimi. Ku të ketë vend të ulët ose gropë, për atje rrjedh uji!”

“Po t’u desh ujë mëshire dhe mirësie, edhe ti kështu vepra!”

Ndërkaq, në fillim duhet që i sëmuri apo i plagosuri të shpëtojnë nga mikrobet, gjë që, në rastin tonë, do të thotë që zemrat të pastrohen nga mikrobi i mëkatit duke u larë me ujin e pendesës. Në fillim duhet pastruar plaga, pastaj duhet vënë ilaçi mbi të, në fillim duhen pastruar mëkatet, pastaj të veprojnë shefaati, ndërmjetësimi për falje. Hadithi i mëposhtëm është një shfaqje mëshire me cilësinë e shprehjes, nga njëra anë, të lajmit të mirë, kurse, nga ana tjetër, të kushtit të këtij lajmi të mirë:

“Kush pendohet për mëkatet me një pendesë të thellë, është si të mos kishte bërë asnjë mëkat!”

Ashtu siç të gjithë profetët e kanë respektuar, në kornizën e këtij kriteri, delikatesën e lartë të stilit të orientimit dhe mirësisë, edhe të urtët dhe udhërrëfyesit që kanë ecur në gjurmët e tyre, e kanë respektuar me ndjeshmëri. Duke u mbështetur mbi këtë, fryti i parë i besimit është konsideruar mëshira dhe adhurimi është përkufizuar shkurt në kornizën e këtyre dy kriterëve:

a) Tadhim li emrillah ose zbatim i urdhrave të Allahut duke e madhëruar Atë.

b) Shefkat li halkillah ose trajtim i krijesave me dhembshuri dhe mëshirë për hir të Krijuesit.

Zoti e urdhëron Profetin (s.a.s.) dhe, në personin e tij, tërë ummetin:

“Ti mbaj gjithmonë rrugën e faljes dhe porositi të mirën...” (el-

A’raf, 199)

Në lidhje me zbatimin e këtij urdhri, pa asnjë dyshim, i Dërguari i Allahut është shembulli më i bukur dhe më i përsosur për ne dhe morali i bukur, shfaqjet e mëshirës dhe faljes të shpalosura prej tij janë të larta dhe të paarrtshme sa t’i bëjnë ziliqarë edhe engjëjt. Ja njëra nga këto:

Ditën e triumfit të Mekës, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) shpalli një falje dhe garanci të përgjithshme.



Qëllimi final i tasavvufit ose mistikës islame është që, duke i edukuar ndjenjat sensuale dhe egoistike, si përfundim, t’u jepet mundësi individëve dhe, si rezultat, shoqërive, të arrijnë paqen, qetësinë dhe kënaqësinë. Sepse Zoti e ka stolisur njeriun me delikatesë, elegancë dhe cilësi të larta.

Meka që kishte vite që bëhej dëshmitare vetëm e padrejtësive dhe armiqësive, me festën e madhe të faljes të shpallur atë ditë, jetonte shfaqjet e një dashurie dhe mëshirë të papërshkruar. Mirëpo ja që një mekas i quajtur Fudala, si të donte të hidhte hije mbi këtë bukuri, u afrua pranë Profetit me qëllim për ta vvarë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i cili e dalloj atë dhe qëllimin e tij, pa treguar asnjë shqetësim dhe

nervozizëm, e pyeti Fudala-n qetësisht me dhembshuri dhe mëshirë:

“A Fudala je ti?”

“Po!” - I tha ai.

Atëherë, profeti i dërguar si mëshirë për botët, e vuri dorën mbi gjoksin e Fudala-s duke i thënë kështu: “Pendohu për atë që sajove në mendjen tënde!”

Dhe kështu, mu atë çast, zemra e Fudala-s që ishte afruar aty me mendimin për ta vvarë Profetin, u mbush me dritën e besimit dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u bë aty për aty njeriu më i dashur për të!

Në një porosi të tij, Profeti pati thënë:

“Kur të shihni dy vëllezërit tuaj të zihen me njëri-tjetrin, ta ndihmoni edhe atë që ka të drejtë, edhe atë që s’ka të drejtë (edhe viktimën, edhe mizorin)!”

Sahabet e patën pyetur:

“O i Dërguari i Allahut! Për viktimën e kuptuam, po mizorin, si do ta ndihmojmë?”

“Duke e penguar në padrejtësinë dhe dhunën e tij...” - U pati thënë Profeti.

Shkurt, ajo që deshëm të thonim, është që, edhe njerëzit tanë, bashkë me njerëzit e të gjithë botës, janë, për sa i përket besimit dhe Islamit, si zogj të plagosur. Është e domosdoshme t’u lidhen plagët me kujdes dhe ndjeshmëri, gjë që kërkon një trajtim të tyre me mëshirë dhe dashuri. Dhe kjo mund të realizohet brenda një përmbajtjeje dhe stili orientimi e mëshire të cilin u munduam ta shtjellojmë gjatë këtij shkrimi.

Zoti ynë na bashkoftë me grupin e njerëzve të mirë, udhëzues të rrugës së drejtë, duke na e mundësuar të veprojmë gjithmonë në rrugën e orientimit, mëshirës dhe faljes!

Përkthyes: Mithat Hoxha

Jetoni që të mos vdisni...

Që të mos vdisni

POEZI nga Sidita
VITOJA
Shkëputur nga
cikli i tretë poetik
i vëllimit
“Kundrejt
shkëmbinjve të
një ëndrre”

Përmes vdekjes

Lind jeta.

Përmes jetës

Vjen vdekja.



Prandaj lindni

Që t'jetoni,

Por jetoni

Që t'mos vdisni.

Në zemrën e vogël, dashuri e madhe për Profetin

Një vëllai ynë, mik i Allahut dhe i pasionuar i Profetit, që punonte si elektrikist në një shoqëri elektrike të Medinës, ditën e fundit të shërbimit, në mëngjes, ndërsa po plotësonte detyrën që i ishte dhënë dhe po bëhej gati të largohej, bie nën tension në zonën e varrit profetik, vdes dhe varroset në varrezën profetike. Natyrisht, familja kthehet në atdhe. I biri shtatëvjeçar i asaj dite është sot nxënës i tetëvjeçares. Një ditë, bën një hartim si detyrë leximi letrar dhe del i pari.

Ja si e ka reflektuar një zemër e vogël dashurinë për Profetin që e përjeton në thellësitë e saj... Ne e dimë se gjuha nuk e shpreh dot çdo gjë që e ndjen zemra, por i lutemi Zotit të na e japë edhe neve si pjesë dashurinë e këtij vëllai të vogël për të Dërguarin e Tij! Amin, ashtu qoftë!

* * *

“Ty, o dielli im, babanë dhe shapkat i pata lënë në atë vend ku pata ardhur. I pata hapur sytë një ditë pranverë në qytetin e Medinës që i vinte era trëndafilë. Meqë spitali ku linda ndodhej mu pranë kopshtit tënd, aroma e parë që ndjeva ishte aroma e trëndafilte e bahçes tënde! Para se im atë të vinte për të më kënduar ezan në vesh, veshët më dëgjuan zërin e ezanit të xhamisë tënde! Kur u bëra dzyzetditësh, vizitën e parë në banesën tënde të lumtur e bëra. Hapat e parë në mermeret e kopshtit tënd i hodha dhe takimin e parë me Zotin tim, sexhden time të parë, në xhaminë tënde e bëra! Ti je pothuajse në çdo gjë të parë që kam bërë!

Unë mësova të të dua ty para se të mësoj të flas. Ndoshta s’ të njihja

shumë, por të doja sikur të ishe shumë i afërt me mua. Edhe nëse s’ e shihnim shtëpinë tënde sa herë që të vinim, qenien ta ndjenim, prandaj, sa herë që largoheshim, dëshpëroheshim. Kur fëmijët mërzhiten në shtëpi, baballarët kërkojnë t’i çojnë në park, në vende dëfrimi. Kurse ne, sa kohë që jetuam në Medinë, kurrë s’i kërkuam babait të na çonte në ndonjë park. Pse, vallë, s’ mërzhiteshim fare? Më duket se në Medinë asnjë fëmijë s’ mërzhitej, sepse atje ishte një lulishte trëndafilash dhe zotëria i asaj lulishteje! Shumicën e kohës atje e kalonim ne. Ne nuk shkelnim dot me këpucë në mermerët e lulishtes tënde. I hiqnim këpucët dhe shëtisnim ashtu, këmbëzbathur, mbi mermere. Kush e di, kishim frikë, ndoshta, se mos shkelnim aty për aty trëndafilat. Verës, mermerët na i digjin këmbët. Punë e madhe! Le që kjo na pëlqente! E pata pyetur babanë një radhë:

“Baba, pse është kaq e nxehtë Medina?”

“O bir, në Medinë ka dy diej, prandaj!” - Më pati thënë babai.

“Si është e mundur, baba, a nuk është vetëm një dielli?” - E pata pyetur unë.

Dhe babai më qe përgjigjur kështu:

“Shih, o bir, vërtet, është vetëm një diell që e ngroh tokën, por është edhe një diell tjetër që i ndriçon dhe i ngroh zemrat, tërë botët. E, meqë ky diell ndodhet në Medinë, këtu bën dy herë nxehtë!”

Më pati pëlqyer kjo përgjigje e tim eti, më qe ngrohur zemra! Me të vërtetë, mermerët na i ngrohnin

këmbët, kurse nën diellin dhe ngrohtësinë tënde na ngroheshin zemrat. Që kur jemi larguar nga Medina, këmbët na ngrohen, por zemrat s’na janë ngrohur kurrësi! Sepse diellin më të madh e kemi lënë atje. Që kur u largova nga Medina, unë e humba diellin tim! Tani s’ mund të shkoj më në shtëpinë e tij, në lulishten e tij! Vërtet që drita e tij na ndriçonte gjer këtu, por që të më ngrohej zemra, më duhej të vrapoja këmbëzbathur nëpër lulishten e tij!

Ndodhte që, ndërsa po ecnim nëpër bahçen tënde, këndohej ezan. Aq bukur e këndonte ezanin imami i Medinës, sa të dukej sikur po e këndonte abisnasi Bilal. Dhe ne vraponim për në xhami për të falur namaz edhe pse s’ dinim. Unë falesha pranë babait duke ndjekur lëvizjet e tij. Ajri i freskët që zbriste poshtë nga kreu i shtyllave të larta, na i shpushuriste flokët. Ndërsa falnim

Para se im atë të vinte për të më kënduar ezan në vesh, veshët më dëgjuan zërin e ezanit të xhamisë tënde! Kur u bëra dzyzetditësh, vizitën e parë në banesën tënde të lumtur e bëra. Hapat e parë në mermeret e kopshtit tënd i hodha dhe takimin e parë me Zotin tim, sexhden time të parë, në xhaminë tënde e bëra! Ti je pothuajse në çdo gjë të parë që kam bërë!



Dua të rritem vetëm që të mundem të të vij pranë. Edhe pse, kur të vij, do të jem i rritur, do të vrapoj këmbëzbathur mbi mermere ashtu si atëherë, gjersa dielli të ma ngrohë zemrën. Zemra më mërdhin nga malli për ty! Thonë për mallin që të djeg, por ja që mua më jep të ftohtë! Sepse shpirti im është mësuar të ngrohet me ty që kur kam lindur!

namaz, na ulej pranë urtë e butë një mace. Babai na thoshte: “Mos e ngacmoni, këto janë macet e Ebu Hurejres!” Dhe ne e besonim. Në xhaminë tënde mund të hynin edhe macet, sepse ti ishte një zot shtëpie shumë i mirë!

Të mërkurat shkonim përherë në Uhud. Shkonim për t’i bërë vizitë të tërë ungjë që ishte edhe ungjë ynë. Bashkë me vëllezërit ngjiteshim në majën Ajnejn dhe i përshëndesnim shtatëdhjetë dëshmorët që flinin në Uhud. Sa herë që ta hidhnim vështrimin në malin Uhud, na bëhej sikur të shihnim ty atje. Edhe në Uhud kishte një aromë trëndafilash si në trëndafilishten tënde. Edhe ai vend sikur ishte një trëndafilishte tjetër. Ja, kështu, shtatë vjetët e mi që qenë vjetët e mi më të çmuar e më të bukur, më kaluan në lagjen tënde, në kopshtin tënd me trëndafila, në vendet ku pate luftuar ti, dhe bashkë me ty, sikur të kisha gjithmonë pranë. Edhe pse s’ të shihja, u mësova aq shumë me ty, sa që kur u largova, m’u duk sikur lashë aty një pjesë nga qenia ime... Këtu jam në vendin tim, por që tashmë më duket i huaj, siç më duket e huaj edhe vetja. Unë këtu jam në kurbet! Ta kem në dorë, nisem menjëherë e të vij, por të mëdhenjtë më thonë gjithmonë “kur të rritesh”!..

Dua të rritem vetëm që të mundem të të vij pranë. Edhe pse, kur të vij, do të jem i rritur, do të vrapoj këmbëzbathur mbi mermere ashtu si atëherë, gjersa dielli të ma ngrohë zemrën. Zemra më mërdhin nga malli për ty! Thonë për mallin që të djeg, por ja që mua më jep të ftohtë! Sepse shpirti im është mësuar të ngrohet me ty që kur kam lindur! Kam aq nevojë për ngrohtësinë tënde, që edhe sikur të mos vij dot më asnjëherë, ti mos më lër! Bëna dritë netëve me dritën tënde! Ngrohna të gjitha qelizat me ngrohtësinë tënde! A s’i kishim në Medinë shtëpitë pranë e pranë? Ishim komshinj. Prania jote na jepte siguri. Prandaj eja herë pas here në shtëpitë tona këtu që të të ndjejmë përsëri pranë e të na japësh prapë siguri!

Ti e di, mua më quajnë Nebi, siç të thërrasin ty. Këtë emër ma paska vënë një miku yt që të doka shumë ty. Edhe emrin tjetër e kam si tëndin, Muhammed. Këtë emër ma paska vënë babai, shpirti im, ai që e lamë aty, në lagjen tënde, atë ditë në mëngjes kur do të largoheshim. Në një gjë tjetër akoma të ngjaj ty: edhe unë po rritem pa baba! Por jam me fat, sepse ti s’na le ta ndjenim mungesën e babait. Që kur jemi larguar nga Medina, më duket se të kemi pranë sikur të kishim pranë

babanë! Natën s’kam fare frikë, prandaj fle i qetë. Me mijra herë e falenderoj Zotin që të njohëm e të deshëm ty! Im atë mbeti aty, në lagjen tënde. Kur po e varrosnim babanë, shapkat e tim vëllai ranë në varr e mbetën aty. Unë i pata zili shumë ato shapka që do të rrinin gjithmonë pranë babait. Prandaj, kur i bëmë vizitën e fundit, edhe unë, pa më parë njeri, i mbulova shpejt e shpejt shapkat me dhë mbi varrin e babait. Edhe një gjë e imja do të mbetej tani e tutje gjithmonë pranë babait!

Thashë se kam lënë atje diellin, tim atë dhe shapkat! Im atë dhe shapkat s’mund të vijnë, kanë mbetur atje, por diellin e kemi gjithmonë pranë. A i lë pa dritë jetimët kujdestari më i madh i tyre? E dija se edhe sikur në fund të botës të shkonim, nuk kishe për të na lënë vetëm! Edhe sytë, edhe zemra, me ty na marrin dritë, imzot! Shpirti me ty na ngrohet! Edhe sikur ardhja ime të mbetet në një ditë të vonë, bëma të mundur të bredh përsëri këmbëzbathur mbi mermeret e trëndafilishtes tënde, imzot! Të bredh gjersa të më përcëllohet tërë trupi me dashurinë për ty dhe ai tempull i bukur ku kam lënë shapkat, të më bëhet vendqëndrimi i fundit i udhëtimit tim!”

Burim dhembshurisë

Nuk kishte qenie që të mos lahej në burimin e dhembshurisë së tij. Profeti i lartë i dërguar si mëshirë për botët, kërkonte që të gjitha krijesat të ishin të lumtura dhe që të jetonin në qetësi. Askush nuk mund t'ua merrte, nuk duhet t'ua merrte atyre prej duarsh rehatinë që ua kishte dhuruar Allahu, jetesën e qetë larg dhimbjeve e shqetësimeve!



Në zemrën e Profetit, e cila rrethonte me dashuri tërë njerëzimin, zinin fill burime dhembshurie. Ai i shihte me dashuri jo vetëm njerëzit, por të gjitha krijesat. Ai s'donte aspak që ata të shqetësoheshin, të dëshpëroheshin, të vuanin. Ngaqë ishte "tejet i shtënë pas besimtarëve", siç thuhet në Kur'an, s'duronte dot që besimtarët të pësonin shqetësime.

Ç'delikatesë!

Një ditë, Profeti kishte qëndruar në namaz. Edhe sahabet që ndjenin kënaqësi të thellë nga falja e namazit pas tij, të vënë në radhë, ishin gati ta ndiqnin atë imam të madh! Në xhemaat kishte edhe burra, edhe gra. Atë ditë, i Dërguari i Madh dëshironte që, duke kënduar sure të gjata, të drejtonte një falje të qetë e prehëse në praninë e lartë të Zotit të tij. Namazi filloi. Profeti po përjetonte një ekstazë të thellë. Qetësinë e thellë që kishte rënë, e prishi qarja e një fëmije.

Profeti i cili kishte menduar një

falje të gjatë, e preu namazin shkurt.

Të bërë kureshtarë, sahabet e pyetën Profetin se pse e fali namazin aq shkurt. Nga buzët prej trëndafili të profetit tonë burim dhembshurie, u derdhën këta tinguj mëshire:

"Ndjeva dhimbjen e ndjerë nga nëna që ndodhej mes xhemaatit, për shkak të të qarës së vogëlushit të saj, prandaj e mbarova namazin shpejt e shpejt..."

O Zot, ç'delikatesë kjo! Sa e ndjeshme, sa e prekshme kjo zemër e dashuruar pas njerëzve!

A nuk u këshillon kjo porosi e dhënë prej tij atyre që kanë për të drejtuar namaz, që ky mendim fisnik të pranohet dhe përvetësohet nga të gjithë?

Ja si ka porositur Profeti për drejtimin e namazit me xhemaat:

"Disa nga ju i ftohni njerëzit nga namazi. Personi që ka për të bërë detyrën e imamatit dhe ka për të dalë në krye të xhemaatit, ta drejtojë faljen shkurt, sepse mes xhemaatit ka njerëz të dobët, të moshuar, të

zënë me punë. Kurse kur të falet më vete, le ta zgjasë sa të dojë!"

Ty do të të digjte zjarri!

Para Islamit, skllëvërit nuk vlerësoheshin si njerëz. Të zotërit i rrihnin, i shanin, i gjymtonin, por askush nuk ngrihej t'u thoshte mizorëve: "Mjaft, mosni kështu!" Sepse skllavi nuk kishte asnjë vlerë!

Ishin ditët kur drita islame kishte ndriçuar botën. Një ditë, sahabiu Ebu Mes'ud el-Bedri po e rrihte skllavin e vet me kamxhik. Në këtë mes, dëgjoi se prej diku larg pas tij, dikush po i bënte zë. Sytë ia kishte zënë zemërimi, prandaj nuk e ktheu kokën pas për të parë. Zëri i afruar mjaft i atij që po i fliste, i thoshte kështu:

"Ebu Mes'ud! Ta dish mirë se fuqia e Allahut mbi ty është më e madhe se fuqia jote mbi këtë skllav!"

Thënia e kësaj të vërtete në mënyrë kaq të hapur e goditëse, e tronditi Ebu Mes'udin. Ai që po i fliste, ishte i Dërguari i Allahut!

Kamxhiku që kishte në dorë, i ra përtokë. Me dëshirën për të shpëtuar nga ndëshkimi hyjnor, Ebu Mes'udi tha:

“Për hir të Allahut, ia dhashë lirinë këtij skllavi!”

Atëherë, i Dërguari i Madh i tha:

“Po të mos kishe vepruar kështu, do të të digjte zjarri i xhehennemit!”

Pas asaj dite, skllavërit morën frymë më të qetë. Zotërinjtë që i rrihnin pa të drejtë, dolën mjaft të humbur. Tashmë, dëmshpërblimi i një shpulle dhënë skllavit ishte lirimi i tij!

Për atë që i djeg kafshët në fytyrë

Edhe kafshët përfituan nga dhembshuria e gjerë e Zotërisë së Gjithësisë të dërguar si mëshirë për botët!

Një ditë, Profeti pa një gomar të damkosur në fytyrë. Krenaria i Gjithësisë, i cili i jepte shumë rëndësi fytyrës dhe e kishte ndaluar edhe goditjen me shpullë në këtë organ që përfaqësonte personalitetin e qenieve, u dëshpërua shumë për atë që i kishin bërë gomarit. Fytyra e bukur e Profetit u dallgëzua nga zemërimi dhe ai mallkoi atë çast, gjë që e pati bërë shumë rrallë:

“Allahu e mallkoftë atë që e ka damkosur këtë kafshë në fytyrë!”

Disa nga ju i ftohin njerëzit nga namazi. Personi që ka për të bërë detyrën e imamit dhe ka për të dalë në krye të xhemaatit, ta drejtojë faljen shkurt, sepse mes xhemaatit ka njerëz të dobët, të moshuar, të zënë me punë. Kurse kur të falet më vete, le ta zgjasë sa të dojë!”

Prapë, një ditë, Profeti kishte dalë për udhëtim. Pranë kishte sahabet. Diku, Profeti u nda nga shokët dhe u largua mjaft prej tyre për të kryer nevojën. Ashtu bënte gjithmonë. Në këtë mes, sahabet panë një zog të vogël shkëmbenjsh. Në fole ishin edhe dy të vegjlit e tij. Pasi zogun nënë u largua nga foleja, sahabet i morën zogjtë e vegjël dhe

i fshehën. Kur zogun nënë u kthye dhe nuk i gjeti të vegjlit në fole, nisi të nxirrte tinguj dhimbjeje dhe të fluturonte rrotull mbi sahabet. Ndërkaq, edhe Profeti u kthye dhe, me ta parë zogun që klithte me dëshpërim, e kuptoi se ç'kishte ndodhur dhe u tha shokëve:

“Kush t'ia ketë marrë të vegjlit zogut e ta ketë shqetësuar, t'i vërë menjëherë në vend!”

Nuk kishte qenie që të mos lahej në burimin e dhembshurisë së tij. Profeti i lartë i dërguar si mëshirë për botët, kërkonte që të gjitha krijesat të ishin të lumtura dhe që të jetonin në qetësi. Askush nuk mund t'ua merrte, nuk duhet t'ua merrte atyre prej duarsh rehatinë që ua kishte dhuruar Allahu, jetesën e qetë larg dhimbjeve e shqetësimeve!

Ja, një lëmsh i tillë dhembshurie delikate kishte rrethuar jetën dhe marrëdhëniet e tij me njerëzit. Eshtë për këtë arsye që zotëria i gjithësisë e pati parë ummetin, bashkësinë e tij, si një tërësi organesh të ndryshme të një trupi të vetëm, kishte kërkuar prej tyre ta donin njëri-tjetrin, t'i ndjenin dhimbjet e njëri-tjetrit dhe i kishte ftuar muslimanët të bëheshin si struktura të lidhura fort me njëra-tjetrën!

Përkthyes: Mithat Hoxha



Pika Hollësie

**Ju erdhi i dërguar nga mesi juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja.
I brengosur për besimtarët, i butë dhe i mëshirshëm.**

Kur'ani: Tewbe, 128

* * *

Allahu nuk mëshiron atë që nuk mëshiron njerëzit.

Hadith: Buhari, Tevhid 2; Edeb 27.

* * *

**Dhembshuria, është një gjuhë, që atë edhe i shurdhi e dëgjon, edhe
i verbëri e shikon.**

Mark Twain

* * *

**As edhe një udhëtar i fesë, nuk mund të arrijë pjekurinë, deri sa të
dojë të gjithë njerëzit, deri sa të ushqejë dashamirësi për ta dhe deri
sa të mbulojë të metat që duken.**

Ibrahim Dussuki

* * *

Bëhu si dielli, në dashamirësi dhe në mëshirë.

Hz. Mevlana

Përktheu Arjan Ymeraj



Mbrojtja 2 e brezit

Zoti e ka krijuar femrën më të ndjeshme në perceptime dhe më të pasur në ndjenja se mashkullin. Ndërkaq, ndërsa kjo ndjeshmëri dhe pasuri perceptimesh dhe ndjenjash siguron një dobi dhe avantazh të madh në mbrojtjen dhe edukimin e brezit si detyra natyrore dhe themelore e femrës (gruas) brenda në familje, jeta shoqërore dhe e punës, e shndërruar në disavantazh nën kushte të vështira të papërshtatshme me natyrën e femrës, është duke ushtruar një ndikim dëmtes mbi të. Prandaj, po qe se femra (gruaja) shtyhet jashtë rregullimit hyjnor për të, i bëhet tradhti natyrës krijimore të saj.

Kur'ani i cili tregon si shembull mësimdhënës se, në këtë botë të krijuar nga Allahu si tempull, popujt që kanë humbur veçoritë morale-shpirtërore, shfaqjet e pozitës së njeriut si rob i Zotit dhe adhurues i Tij, vlerat dhe dinjitetin njerëzor, janë fshirë nga harta, duke u mbajtur njerëzve dritën e orientimit, ua ndriçon rrugët e lumturisë së përgjeshme.

Meqë njeriu është qenie e nderuar, për të, në ndryshim nga qeniet e tjera, kanë dalë urdhra hyjnorë për t'ia ruajtur dhe mbështetur nderin, dinjitetin, ndjenjën e turpit dhe seriozitetin. Njëri nga këta urdhra është edhe mbulimi. Mes krijesave, mbulimi është një cilësi e posaçme vetëm për njeriun. Në Kur'an thuhet: "O njerëz! Ju dhamë juve mbulesë për të mbuluar vendet intime dhe rrobë për t'u stolisur. Por rroba e devocionit është më e dobishme!" (el-A'raf, 26)

Njeriu është i detyruar të mbulohet për të mbrojtur nderin, dinjitetin dhe seriozitetin njerëzor që ia ka favorizuar Allahu. Në të kundërt, këto cilësi dhe karakteristika njerëzore humbin dhe njeriu bie në nivelin e krijesave poshtë tij.

Humbja në shoqëri e ndjenjës së turpit, përhapja dhe funksionimi sheshit i prostitucionit dhe

imoralitetit janë nga shenjat kryesore të kiametit. Në hadithin profetik thuhet: "Ndjenja e turpit është nga *besimi*" (Buhari, *Iman*, 3)

Në xhennet, megjithëse s'kishte njerëz të tjerë, Hz. Ademi me Hz. Havanë patën turp nga njëri-tjetri dhe nga krijesat e tjera. Të shqetësuar, u përpoqën të mbuloheshin shpejt e shpejt me gjethe pemësh. Dhe kjo tregon se mbulesa materiale dhe ndjenja e turpit me edukatën si shfaqje moral-shpirtërore të lidhura drejtpërdrejt me mbulesën, janë nga vetitë më të zgjedhura si pjesë përbërëse të natyrës krijimore të njeriut dhe shenja treguese të drojës dhe devocionit.

Poeti dhe mistiku i shquar Xhelaeddin Rumi, i mbiquajtur Mevlana, thotë:

"E pyeta mendjen time: "Ç'është besimi?" Dhe mendja, duke u përkulur te zemra, i pëshpëriti asaj në vesh: "Besimi është turp dhe edukatë!"

Islami ka sjellë disa rregulla mbi veshjen në përshtatje me dinjitetin njerëzor. Njëri nga këta është rregulli sipas të cilit rroba nuk duhet të jetë aq e ngushtë dhe e tejdukshme sa të nxjerrë në pah linjat e trupit. Kur Profeti (s.a.s.) pati parë motrën e Hz. Aishesë, Esmanë, të kishte veshur një rrobë të hollë, e pati kthyer kokën mënjane dhe i pati



Historia botërore është bërë vazhdimisht dëshmitare e faktit që ç'pamje fatkeqësish ka krijuar një brez njerëzish egoistë të cilët, për shkak të privimit nga besimi dhe feja, e kanë jetuar jetën vetëm në planin fizik-trupor, s'kanë menduar gjë tjetër veç kënaqjes së egos dhe dëshirave sensuale dhe u kanë dhënë lamtumirën nderit dhe dinjitetit njerëzor!

thënë kështu:

“O Esmā! Pasi femrat të arrijnë moshën e pjekurisë, nuk është mirë t'u duken pjesë të tjera të trupit veç këtyre (bën shenjë fytyrën dhe duart!)” (Ebu Davud, *Libas*, 31)

Nga ana tjetër, është e domosdoshme edhe që femra ta ruajë dinjitetin e saj femëror dhe mashkullit, dinjitetin e tij mashkullor. Në lidhje me këtë veçori, Profeti ka porositur:

“Meshkujt që vishen si femra dhe femrat që vishen si meshkuj do të mbeten larg mëshirës së Allahut!” (Ebu Davud, *Libas*, 28)

Islami i ka dhuruar femrës (gruas) një pozitë shumë të çmuar. Edhe femrat duhet ta kërkojnë lumturinë e vërtetë në klimën e qetë të Kur'anit dhe Sunnetit. Për fat të keq, në ditët tona, vajzat dhe gratë, me anë të premtimeve të ndryshme dhe fjalëve të zbkuruara, shtyhen ta kërkojnë lumturinë nëpër rrugë.

Zoti e ka krijuar femrën më të ndjeshme në perceptime dhe më të pasur në ndjenja se mashkullin. Ndërkaq, ndërsa kjo ndjeshmëri dhe pasuri perceptimesh dhe ndjenjash siguron një dobi dhe avantazh të madh në mbrojtjen dhe edukimin e brezit si detyra natyrore dhe themelore e femrës (gruas) brenda në familje, jeta shoqërore dhe e

punës, e shndërruar në disavantazh nën kushte të vështira të papërshtatshme me natyrën e femrës, është duke ushtruar një ndikim dëmtues mbi të. Prandaj, po që se femra (gruaja) shtyhet jashtë rregullimit hyjnor për të, i bëhet tradhti natyrës krijimore të saj.

Mashkulli (burri) i mençur e i zgjuar, duke hyrë në shtëpi, di ta lërë mendjen te pragu i derës, kurse, duke hyrë në një vend tregtie, ndjenjën. Kurse femra (gruaja) tek e cila sundojnë ndjenjat, nuk e tregon aq lehtë zgjuarsinë për ta lënë mënjanë ndjenjën kur kjo gjë të jetë e nevojshme apo e domosdoshme. Kjo e vërtetë është ndër shkaqet kryesore që i hapin rrugë shpërdorimit të femrës në shoqëri.

Zoti u ka dhënë femrës (gruas) dhe mashkullit (burrit) mundësi e aftësi të veçanta dhe ka bërë mes tyre një ndarje detyrash shumë të mirë, me anë të së cilës femra dhe mashkulli plotësojnë njëri tjetrin. Vetëm kur mashkulli dhe femra ta plotësojnë njëri-tjetrin materialisht dhe shpirtërisht, krijohet pjekuria shoqërore e duhur në përputhje me qëllimin e krijimit, për rrjedhojë, familja dhe, në vartësi të kësaj, shoqëria arrijnë qetësinë dhe prehjen e duhur.

Por sa keq që gara e barazisë së

sajuar mes mashkullit (burrit) dhe femrës (gruas) e nisur në kohën tonë i ka dëmtuar detyrat e gruas si nënë dhe zonjë shtëpie, qetësia dhe prehja e familjes kanë humbur, jeta shoqërore është tronditur dhe shoqëria është bërë skenë e fatkeqësive familjare. Mirëpo natyrat fizike dhe shpirtërore të mashkullit dhe femrës nuk janë të njëjta që të krijohet domosdoshmëria e barazisë praktike apo juridike mes tyre! Esenciale dhe e rëndësishme nuk është barazia në çdo fushë, apo, e thënë ndryshe, barazitizmi, por drejtësia dhe ekuilibri mes të drejtave dhe përgjegjësive!

Kur prishet ekuilibri në fjalë në antagonizëm me veçoritë e natyrës krijimore që Allahu ua ka dhënë mashkullit dhe femrës, konfliktet dhe shqetësimet brendafamiljare i shtyjnë njerëzit e pakënaqur ta kërkojnë qetësinë dhe lumturinë tjetërkund, si përfundim, me divorcet që e bëjnë të rrëqethet qiellin, shemben familjet, guri më i shenjtë i strukturës së shoqërisë! Kështu, edhe fëmijët që nuk e gjejnë dot ngrohtësinë familjare brenda shtëpisë, që u nënshtrohen keqtrajtimit të prindërve në vend që t'i marrin ata për shembullin më të mirë, braktisen nën mëshirën e rrugëve dhe rrugicave. Fëmijë që

ikin nga shtëpia dhe bashkohen me fëmijët e rrugëve, brenda një kohe të shkurtër, duke rënë në rrjetën e organizatave kriminale të duhanit, alkoolit, narkotikëve, prostitucionit, grabitjeve, vrasjeve, etj., përgatisin truallin e një fatkeqësie shoqërore. Pa dyshim, kjo gjendje sjell me vete edhe një erozion moral të frikshëm i cili e shterpëzon jetën shoqërore.

Njëri nga krimet më të frikshme e më të shëmtuara të shekullit tonë është edhe aborti artificial, i pajustificuar nga ana mjekësore, thjesht për egoizëm dhe rehati. Si të bëhej garë me njerëzit gjysmë të egër të periudhës paraislamike të mbi dhjetë shekujve më parë që i groposnin të gjalla vajzat e vogla, sot, me anë të një krimi modern, foshnjat e pafajshme copëtohen qysh në barkun e nënës! Para së gjithash, kjo është mosmirënjohje ndaj favorit hyjnor. Veç kësaj, ata që veprojnë

feja, e kanë jetuar jetën vetëm në planin fizik-trupor, s'kanë menduar gjë tjetër veç kënaqjes së egos dhe dëshirave sensuale dhe u kanë dhënë lamtumirën nderit dhe dinjitetit njerëzor!

Në krahasim me kafshët, madje edhe me bimët që rropaten për ta ruajtur brezin e vet me anë të një sensi vetëmbrojtjeje tejet të dukshëm, sa e hidhur dhe e pështirë është mungesa e këtij sensi dhe e kësaj përpjekjeje te njeriu, qenia më e nderuar ndër krijesat! Dhe sa e hidhur është rënia e njerëzve që e kanë braktisur pozitën e vet, në gjendjen e përshkruar nga Kur'ani:

“... ata janë si kafshët, madje, më të hutuar...” (el-A'raf, 179)

Jetesa e femrës (gruas) sipas natyrës krijimore të saj e kthen shoqërinë në xhennet, parajsë. Familjet e qeta e të kënaqura janë burimi i lumturisë për shoqërinë. Po



Islami ka sjellë disa rregulla mbi veshjen në përshtatje me dinjitetin njerëzor. Njëri nga këta është rregulli sipas të cilit rroba nuk duhet të jetë aq e ngushtë dhe e tejdukshme sa të nxjerrë në pah linjat e trupit.

kështu, s'dihet se me ç'të papritura të jetës kanë për t'u përballuar! Ata që e kryejnë ose marrin pjesë në këtë krim duhet ta mendojnë se ndoshta, nesër, kur të mbeteshin vetëm për vetëm në jetë, fëmija që po vrasin do të ishte e vetmja dorë që do t'u zgjatej! Ose duhet ta llogarisin se, po qe se edhe prindërit e tyre do të mendonin dhe vepronin kështu për ta, nuk do të ishin sot në jetë!

Historia botërore është bërë vazhdimisht dëshmitare e faktit që ç'pamje fatkeqësish ka krijuar një brez njerëzish egoistë të cilët, për shkak të privimit nga besimi dhe

t'u hedhim një sy faqeve të historisë, do të vëmë re se shoqëritë janë rregulluar dhe zbukuruar me gratë dhe prapë, me duart e tyre janë fëlliqur dhe shkatërruar. Po qe se femrave (grave) u tregohen rrugët si vende ku mund ta gjejnë lumturinë, rrugët e jetës mbushen plot copëra qelqesh të thyera!

Ndërkaq, t'u zgjasësh dorën e ndihmës atyre që kanë rënë në pozitë të vështirë për ta mbrojtur nderin dhe dinjitetin për shkaqe të tilla si përhapja e imoralitetit dhe mëkatit, presioni i intrigës dhe konfliktit ose shtrëngesa e pamundësive materiale e moralo-shpirtërore, është edhe një

domosdoshmëri islame, edhe një detyrim njerëzor. Në porosinë profetike thuhet:

“Nëse dikush nuk vrapon në ndihmë të muslimanit kur t'i jetë shkelur nderi dhe t'i jetë goditur dinjiteti, edhe Allahu s'i shkon në ndihmë në një çast kur ai të ketë nevojë! Allahu e ndihmon në çastet e nevojtarisë atë që vrapon në ndihmë të një muslimani kur këtij i shkelet nderi dhe i goditet dinjiteti!” (Ebu Davud, *Edeb*, 36/4884)

Lumturia e femrës (gruas) është te jetesa duke e ruajtur dinjitetin dhe te mbrojtja e familjes. Ç'dëshmi muhammediane e madhe është për një nënë të mirë porosia profetike, sipas të cilës, “Xhenneti është nën këmbët e nënave!” (Sujuti, *el-Xhamiu's-Sagîr*, I, 125)

Edhe në një hadith tjetër profetik është thënë:

“Kjo botë është një dobi e përkohshme. Qenia më e bekuar e botës, e cila jep dobi, është gruaja e mirë!” (Muslim, *Rada*, 64)

Një nënë e virtytshme është prehër mëshire e shfaqur nga fuqia hyjnore, burim lumturie në familje, dritë kënaqësie dhe gëzimi, epiqendër dhembshurie për pjesëtarët e familjes, është vendshfaqja përjashtimore dhe e posaçme në botë e emrave Rahman (mëshirues) dhe Rahim (shpërblyes) të Zotit. Nënata kanë një vend shumë të rëndësishëm në rritjen dhe përgatitjen e brezave të mirë e të dobishëm. Të gjithë të urtët dhe njerëzit e mëdhenj i kanë marrë frymëzimet dhe begatitë e para nga një nënë e mirë. Në një hadith të tijin, Profeti ka thënë:

“Gruaja muslimane që merret në shtëpi me edukimin e fëmijëve (jetimë), është bashkë me mua në xhennet!” (Sujuti, *el-Xhamiu's-Sagîr*, I, 104)

Shoqëritë e fuqishme formohen nga familje të fuqishme, kurse familjet e fuqishme janë, më shumë, vepër e grave të virtytshme që kanë

marrë edukim moralo-shpirtëror, pra, që e kanë kapërcyer pengesën e egos. Shembujt më të bukur të kësaj janë zonjat sahabe të cilat u patën mësuar fëmijëve të tyre të sakrifikonin me jetët dhe pasurinë. Ato i patën brumosur zemrat e të vegjëlve të tyre me dashurinë për të Dërguarin e Allahut.

Zonjat sahabe të shndërruara në modele për ummetin, bashkësinë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) me anë të edukimit të tij moralo-shpirtëror, ua hiqnin vërejtjen fëmijëve të vet që vonoheshin për ta parë të Dërguarin e Allahut dhe s'takoheshin me të për një kohë të gjatë. Hudhejfe (r.anh) e tregon kështu një kujtim të vetin:

“Kur je takuar më së fundi me të Dërguarin e Allahut?” - Më pyeti nëna.

Unë i thashë:

“U bënë ca ditë që nuk jam takuar me të.”

Nëna u nxeh shumë dhe më qortoi ashpër. Kurse unë i thashë:

“Prit, nënë, mos u nxeh! Ja, po shkoj menjëherë pranë të Dërguarit të Allahut, po fal namazin e mbrëmjes bashkë me të dhe po i kërkoj të bëjë pendesë edhe për ty, edhe për mua!” (Tirmidhi, *Menakib*, 30; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, V, 391-392)

Ja, pra, ato nëna që i patën edukuar në këtë mënyrë bijtë e vet, u bashkuan me Zotin e tyre me kënaqësinë që kishin formuar një brez shembullor i cili përhap, pastaj, në të gjithë botën drejtësinë, mirësinë dhe besimin në rrugën e drejtë. Edhe sot, ecja në gjurmët e atij brezi të bekuar me dashurinë dhe emocionet për sahabet duke ua bërë të njohur e të dashur bijve të vet të Dërguarin e Allahut, është detyrë e çdo nëne dhe babai besimtar.

Nuk duhet ndonjë aftësi parashikuese e veçantë për ta parë të ardhmen e një kombi. Për këtë, mjafton të shihen të rinjtë e tij. Rinia e çdo periudhe jeton në përputhje

me karakterin e vet, në një klimë emocionesh të veçantë ku mund t'i shpenzojë energjitë. Çdo komb formësohet sipas botës ndjesore dhe ideore të rinisë së vet. Po që se të rinjtë e një kombi i shpenzojnë forcat në rrugën e vlerave moralo-shpirtërore dhe virtytit, ai komb ka të ardhme. Shembulli më i qartë i kësaj janë luftërat e popullit turk për pavarësi. E gjithë bota është dëshmitare se si fuqia metafizike e atij brezi me zemrën të mbushur plot besim e shkatërroi fuqinë materiale të armikut. Por po që se, në të kundërt, rinia ia nënshtron dhe e bën rob tërë fuqinë e vet për interesa materiale, egoistike e sensuale, përfundimi, siç është fiksuar edhe me shembuj historikë, është disfatë dhe shkatërrim.

Në ditët e sotme, për të rritur dhe përgatitur një brez të virtytshëm, u bien detyra të mëdha institucioneve që japin arsim shpirtëror dhe, veçanërisht, kurseve të Kur'anit, sepse nuk ka gabim më të madh që ia nxin njeriut jetën shpirtërore sesa nënvleftësimi i treguar ndaj fjalës së Allahut. Prandaj, në kohën tonë kur shumica e njerëzve u janë nënshtruar interesave dhe botës materiale, është e domosdoshme t'i kushtohet më shumë kujdes arsimit dhe edukimit kur'anor.

Nuk duhet harruar se Kur'anit nuk është vepër e një njeriu vdekëtar, por udhëzuesi më i rëndësishëm i rrugës së drejtë i favorizuar nga Allahu për t'u dhënë mundësi robve të vet të arrijnë lumturinë e kësaj bote e të përjetësisë. Nga ky këndvështrim, në institucionet ku jepet arsim dhe edukim moralo-shpirtëror duhet t'u jepet rëndësi veçanërisht këtyre specifikave:

1) Nxënësit duhet të konsiderohen para së gjithash si amanet i Allahut; duke sugjeruar në qendër të mendimeve të tyre madhështinë hyjnore të Allahut dhe meditimin mbi rrjedhat e fuqisë hyjnore në gjithësi, të shtresohet



Humbja në shoqëri e ndjenjës së turpfit, përhapja dhe funksionimi sheshit i prostitucionit dhe imoralitetit janë nga shenjat kryesore të kiametit. Në hadithin profetik thuhet: “Ndjenja e turpfit është nga besimi”

morali impresionues i Profetit. Arsimit dhe edukimi moralo-shpirtëror, duke u mbështetur, krahas njohurive, edhe me dashuri, duhet shndërruar në shije e kënaqësi, sepse mundësia për ta ndjerë shijen dhe kënaqësinë e besimit është burimi më i madh i energjisë për shërbimin.

2) Këto institucione duhet të jenë çerdhe dhembshurie, sakrifice dhe shërbimi. Brenda atyre dyerve, më tepër se dhënia e një grumbulli njohurish, duhet të jepet një shërbim Kur'anit plot dashuri dhe emocion. Kurse zbatimi praktik i Kur'anit është jetesa sipas Sunnetit ose traditës profetike.

3) Nxënësit duhen trajtuar me delikatesë, edukatë dhe fytyrë të qeshur dhe, në paçin gabime, ato u

duhen meremetuar me dhembshuri dhe mëshirë. Nuk duhet harruar se arti dhe mjeshtëria e një meremetuesi del në shesh në veprën që meremeton.

4) Njeriu ndjen admirim dhe dashuri për personalitetin dhe karakterin e lartë. Ai përpiqet ta imitojë personin ndaj të cilit ndjen admirim. Njeriu mbetet nën tërheqjen e atyre që do, sepse dashuria është si një linjë rrjedhe mes dy zemrave. Prandaj është e domosdoshme që ata që ndodhen në shërbimin kur'anor, duke shpalosur një karakter të pjekur me anë të sjelljeve shembullore, ta bëjnë veten të dashur për të tjerët dhe, për këtë, duhet të kenë për parim që, edhe t'ua lehtësojnë barrën miqve, edhe të mos u bëhen barrë të tjerëve!

5) Krahas pastërtisë së zemrës, i duhet kushtuar vëmendje edhe pastrimit të jashtëm dhe paraqitjes së rregullt duke u bërë shembull edhe në veshje dhe në pamjen e jashtme. Profeti ynë, i cili porosiste pastrimin dhe mbajtjen pastër të rrobave dhe nuk e pëlqente çrregullimin në veshje e paraqitje, nuk e shihte me sy të mirë as çrregullimin e flokëve dhe mjekrrës. Kështu, një herë, kur Profeti (s.a.s.) ndodhej në faltore, hyri një burrë me flokë dhe mjekërr të ngatërruar në njëra-tjetrën dhe i doli para. Profeti i bëri shenjë me dorë që t'i rregullonte flokët dhe mjekërrën. Pasi burri e çoi në vend kërkesën, Profeti tha:

“A nuk është kështu më mirë se sa bredhja e cilitdo prej jush me flokë e mjekërr të trazuar si ndonjë djall?” (Aliju'l-Kaari, *Mirkat*, VIII, 261)

Një radhë tjetër, gjithashtu, Profeti e pyeti kështu dikë që i erdhi me veshje dhe pamje të çrregullt:

“A ke mall e pasuri? Si i ke hallet?”

Dhe, kur personi i tha se kishte mundësi materiale të mira dhe i kishte punët mirë, e qortoi duke i

thënë:

“Atëherë, meqë Allahu të ka dhënë mall e pasuri, kjo duhet të duket mbi ty!” (Nesai, *Zinet*, 54; Ahmed b. Hanbel, IV, 137)

6) Për të arritur thellësinë e ndjenjave me anë të Kur'anit dhe për t'i reflektuar kuptimet e larta të Kur'anit në sjellje në formën e akteve të mira, është e domosdoshme që zemrat të mbushen me energji pozitive, domethënë, me dashuri dhe frymë shpirtërore. Për t'u bërë denjesisht i aftë për të marrë frymëzime nga Kur'ani, kapaku i tij duhet hapur me respekt, madhërim dhe edukatë dhe duhet lexuar Kur'ani me vetëdijen që na e ka mësuar Mëshiruesi, sepse në ajetin kur'anor thuhet:

“Mëshiruesi ia mësoi (njeriut) Kur'anin. (Ai) e krijoi njeriun. Ia mësoi të shprehjet!” (er-Rahman, 1-4)

7) Më tepër se mësimin, kurset e Kur'anit duhet të synojnë një arsimim i cili, përballë madhësisë së Kur'anit, t'u japë thellësi ndjenjave të meditimit, ndjeshmërisë dhe kërkimit. Veçanërisht, duke trajtuar mesazhet plot shembuj mësimdhënës të rrëfimeve mbi profetët, intrigat që do të shfaqen afër kiametit, lajmet mbi shenjat e kiametit, konkluzionet që i dallojnë nga njëri-tjetri besimin me mohimin, bindjen me kundërshtimin, hallallin me haramin, dhe të vërtetën me gënjeshtërën, duhet t'u përftojnë nxënësve gjendjen shpirtërore të aftësisë për t'i vlerësuar jetën dhe gjithësinë nën dritën e ajeteve të Kur'anit.

8) Ata që janë të ngarkuar me detyrë në institucionet arsimore shpirtërore, duhet të jenë njerëz shërbimi të pjekur. Dhe, për këtë, duhet të jenë njerëz të punëve të mira të pajisur me veti të larta morale, si mëshira, dhembshuria dhe vetëmohimi. Veçanërisht, në cilindo grup shoqëror që të jetojnë, duhet të dinë ta mbrojnë qenien e vet dhe



Në ditët e sotme, për të rritur dhe përgatitur një brez të virtytshëm, u bien detyra të mëdha institucioneve që japin arsim shpirtëror dhe, veçanërisht, kurseve të Kur'anit, sepse nuk ka gabim më të madh që ia nxin njeriut jetën shpirtërore sesa nënvleftësimi i treguar ndaj fjalës së Allahut. Prandaj, në kohën tonë kur shumica e njerëzve u janë nënshtruar interesave dhe botës materiale, është e domosdoshme t'i kushtohet më shumë kujdes arsimit dhe edukimit kur'anor.

besimin. Ata duhet të zotërojnë një gjendje shpirtërore të shëndoshë, të aftë për të ndikuar pozitivisht mbi çdo lloj mjedisi intrige, ndërkaq, për të mos marrë vetë ndikime negative. Në çdo situatë, duhet ta mbajnë zemrën larg drojës dhe frikës për interesa materiale të kësaj bote, si posti dhe pasuria.

9) Këta persona duhet të ruhen nga mënyra trashamane e komunikimit, trajtimi i të tjerëve me padrejtësi, formimi i rrethit personal dhe mbrojtja e tij në dëm të të tjerëve, përdorimi i dhunës fizike, etj., që janë sjellje që e ftohin nxënësin nga mësuesi dhe edukatori. Ata që ndodhen në shërbim të Kur'anit, nuk duhet ta nxjerrin nga mendja se edhe vetë do të japin llogari një ditë para peshores hyjnore. Prandaj duhet të ruhen nga dhënia e mësimëve të thata me karakter të detyrueshëm, pa emocione e pa sinqeritet mbështetur në marrëdhënie komanduesi e zbatuesi ndaj nxënësve që u lihen në amanet. Veçanërisht, nuk duhet të harrojnë se për çdo njeri të fituar ka një shpërblim të padiskutueshëm në jetën e pasme, ahiret, dhe, po kështu, për çdo njeri të humbur, një pasojë të rëndë.

10) Duhet respektuar matura. Nuk duhen bërë përpjekje për ta dhënë çdo gjë në një çast. Duhet zbatuar një mënyrë arsimimi dhe edukimi gradual nëpërmjet përvetësimit dhe zbatimit praktik pjesë-pjesë. Duhet marrë parasysh niveli i aftësisë kuptuese të nxënësit si dhe mundësitë e përgjithshme të tij; të mos tentohet t'u mësohen nxënësve çështje të etapave të mëvonshme qysh në fillim dhe pa u dhënë kulturën e duhur bazë për to.

11) Duke i mbështetur temat me shumë metafora, anekdota, pyetje-përgjigje dhe rrëfime, duhen shpjeguar ato në mënyrë që të ushtrojnë sa më shumë ndikim te nxënësit dhe të lënë mbresa të

pashlyeshme mbi ta. Mjeshtëria dhe arti më i madh i një mësuesi dhe edukatori është të dijë ta gjejë rrugën për t'i hyrë nxënësit në zemër, sepse fitorja më e madhe është ngadhënjimi i zemrave. Siç ka thënë poeti Mevlana, "*Zemra është vendvështrimi i Allahut të madh!*"

12) Mësuesit dhe edukatorët duhet të jenë të aftë për ta kuptuar nxënësin nga fytyra. Duhet t'u japin vlerë nxënësve, të interesohen një për një dhe në mënyrë vetiake me

Edukatori i cili, ngaqë nuk e ndjen dot në zemrën e vet pasionin dhe dalldinë e besimit, nuk është i aftë as për t'i bërë zemrat e vogla e të pafajshme ta ndjejnë, mësuesi i cili, ngaqë nuk shijon dot vetë nga burimi i kuptimit të gjerë të Kur'anit, nuk i bën dot as nxënësit të shijojnë, ndodhen nën një përgjegjësi të rëndë.

secilin prej tyre dhe po kështu t'ua zgjidhin problemet që mund të kenë. Prandaj duhet t'i japin rëndësi veçanërisht lidhjes vetiake.

13) Shërbimi me falenderim ndaj robve të Allahut duhet bërë veti, sepse në sajë të tyre krijohet mundësia e shërbimit. Prandaj, duke u nisur nga ky këndvështrim i çështjes, në shërbimin shpirtëror, buzëqeshja dhe falenderimi ndaj personave që u shërbehet duhet shndërruar në natyrë bazë.

14) Është e domosdoshme që personat të cilëve u duhet t'u tejojnë zemrave dashurinë e besimit, të përmirësojnë më parë zemrat e veta. Puna më e vështirë është edukimi i njeriut. Si mund ta edukojë tjetrin ai që s'e edukon dot veten e që s'di

gjë për botën e brendshme të njeriut? Sa bukur e tregon poeti Mevlana gjendjen e një njeriu të paditur e kokëtrashë të privuar nga vlerat e zemrës:

"Një ditë, një shok rruge i Hz. Isait (a.s.), një njeri që s'dinte ç'fliste, i tha:

"Të lutem, o Isa, ma mëso edhe mua atë emër të madh të Zotit që di ti, që edhe unë t'i ngjall eshtrat e kalbura e t'i ngre në këmbë"

Hz. Isai iu përgjigj:

"Kjo punë s'është për ty! Për ta thënë atë emër të madh e për t'a ringjallur të vdekurin duhet të jesh njeri me veten më të pastër se uji i shiut, më i shquar se engjëjt në adhurim! Emri i madh i Zotit kërkon një zemër të pastër e një gjuhë të kulluar. Njeriut me zemër të pastër i pranohet lutja! Ç'dobi do të ketë sikur ta këndosh emrin e madh ti që s'e ke zemrën të pastër!"

Por pasi njeriu i paditur nguli këmbë, Hz. Isai u habit tejet me fjalët e atij kokëtrashë dhe tha i çuditur:

"O Zot! Ç'urtësi ka pas kësaj këmbënguljeje? Nga se rrjedh prirja në këtë shkallë e këtij kokëtrashë për të kundërshtuar? Vetë e ka zemrën të vdekur kurse përpiket ta ringjallë kufomën e tjetrit! Kurse ajo çka i takon atij, është ta ringjallë zemrën e vet e cila është i vdekuri i vërtetë! Në vend që të lutet për ringjalljen e zemrës së vet, përpiket t'i ringjallë të tjerët! Ç'injorancë, ç'indiferentizëm!"

Siç ndodh në këtë shembull, edukatori i cili, ngaqë nuk e ndjen dot në zemrën e vet pasionin dhe dalldinë e besimit, nuk është i aftë as për t'i bërë zemrat e vogla e të pafajshme ta ndjejnë, mësuesi i cili, ngaqë nuk shijon dot vetë nga burimi i kuptimit të gjerë të Kur'anit, nuk i bën dot as nxënësit të shijojnë, ndodhen nën një përgjegjësi të rëndë. Sepse institucioni ku merr pjesë dhe nxënësit për të cilët ka marrë përsipër mësimin dhe edukimin e

tyre, janë amanete të Allahut për të. Është e padiskutueshme se, po të mos mundet t'u japë nxënësve edukimin shpirtëror që kërkohet, do të mbajë përgjegjësi për shkeljen e të drejtave të personit!

Ja, pra, brezat shembullorë që kanë për të mbushur faqet e nderit të së ardhmes, do të jenë produkt i një edukimi moralo-shpirtëror të karakterizuar nga pajisja me këto cilësi dhe veti. Brezat që e kanë arritur këtë, me favorin e Allahut, janë lartësuar dhe përplotësuar. Me të vërtetë, është e ditur dhe e njohur gjerësisht se në themel të shtetit osman si shteti më jetëgjatë i historisë së njerëzimit, qëndron respekti, madhërimi dhe dashuria e treguar ndaj Kur'anit!

Fëmijët janë amanete hyjnore të dhuruar prindërve. Zemrat e pastra e të kulluara të fëmijëve të dorëzuar nënës e babait me natyrë islame, janë, si toka e pastër, një mineral i papërpunuar i gatshëm për përpunim. Varet nga fara e hedhur që ajo tokë të japë gjemb apo trëndafil, frut të hidhur apo të ëmbël!

Mbrojtja e fëmijëve nga zjarri i xhehennemit është, për prindërit, më e rëndësishme se mbrojtja e tyre nga tërheqjet dhe fatkeqësitë e kësaj bote. Ndërkaq, mbrojtja nga zjarri i xhehennemit varet nga begatimi i zemrave me dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Prindërit të cilët nuk munden t'ua bëjnë të dashur fëmijëve të vet Allahun e Lartë dhe Profetin, përgatisin për ta fatkeqësinë edhe të kësaj bote, edhe

të jetës së pasme, ahiretit!

Nga ana tjetër, edukimi i fëmijës duhet filluar në moshën 3 vjeç duke lënë mënjanë mendimet se "është ende i vogël, nuk kupton", etj. Në çdo rast, pranë fëmijëve, prindërit duhet të diskutojnë mbi madhësinë e Allahut të Lartë, mbi faktin se Ai është krijuesi i gjithçkaje, se Ai i jep të gjitha të mirat, se duhet falenderuar Allahu, se ndodhen çdo çast nën vëzhgimin e një kamere hyjnore, duhet t'u mësojnë fëmijëve pyetjet dhe përgjigjet e varrit, domethënë, gjuhën e varrit, duhet të mendojnë mirë se këto sugjerime të periudhave të zhvillimit shpirtëror të fëmijëve do të lënë mbi ta gjurmë të pashlyeshme dhe duhet ta llogarisin se edukimi në të ardhmen i fëmijëve që nuk përfitojnë siç duhet nga sugjerimet islame në këto moshë, do të bëhet më i vështirë.

Edhe mosngritja e fëmijës për namaz me mendimin që të mos ftohet e që të mos mbetet pa gjumë, është një përgjegjësi e madhe. Këto lloj sjelljesh nuk janë një e mirë që u bëhet fëmijëve, përkundrazi, një e keqe! Për t'i edukuar mirë fëmijët, prindërit duhet t'i mësojnë ata për adhurim dhe bamirësi qysh në moshë të vogël, duhet t'i mbrojnë ata nga ndikimet negative të mjedisit.

Fëmija i mbarë e i dobishëm është, për ne, jo vetëm një nga pasuritë tona më të çmuara në këtë botë, por edhe një nga vlerat dhe të ardhurat tona për jetën e përtejme, të ahiretit. Prandaj, konsumimi i dhuntisë fëmijë që është një favor

hyjnor, në vende të gabuara dhe për interesa materiale të kësaj bote, është një përgjegjësi e madhe për të cilën do të kërkohet llogari në jetën tjetër!

T'i nënvleftësosh aspektet moralo-shpirtërore të bijve e bijave duke u dhënë rëndësi vetëm niveleve temporale të tyre, të lejosh që ata të bëhen kapital për rrugët, shoqërinë e keqe dhe qendrat e së keqes, si dhe ta shohësh me tolerancë rënie e tyre në gjendjen e të pasionuarve të botimeve, emisioneve dhe reklamave imorale, të gjitha këto janë mosmirënjohja më e madhe ndaj këtij favorit hyjnor!

Përfundimisht, është e domosdoshme që, për arritjen e lumturisë së përgjeshme, mundësitë e kësaj bote, veçanërisht pasuria dhe fëmijët, të shndërrohen në mjete për të fituar pëlqimin e Zotit. Ne duhet ta vlerësojmë mirë të sotmen dhe të përpiqemi të lëmë pas një brez të mbarë e të dobishëm në mënyrë që konaku ynë i fundit në këtë botë, varri, të mos mbetet në errësirë, i heshtur e i vetmuar. Le t'i bëjmë fëmijët tanë një kapital të lartë të zemrave tona në mënyrë që, në udhëtimin tonë të gjatë e të vështirë, të na bëhen një sadaka, lëmoshë e dhënë prej nesh, me veprim të përhershëm!..

Zoti na i bëftë dhuntitë e kurorës martesore, familjes dhe fëmijëve, që na i ka dhuruar, pretekste të lumturisë sonë në këtë botë e në jetën e pasme, ahiret!



Urtësitë e kurbanit

Njeriu i nderuar nga Allahume titullin “zëvendës i Allahut mbi tokë”, është vlerësuar lart duke u pranuar si bashkëbisedues i revelacionit ose zbulesës hyjnore. Është si rrjedhojë e këtij vlerësimi të lartë që janë dërguar profetë dhe libra hyjnorë për t’i orientuar njerëzit në rrugën e drejtë. Atyre u është treguar “ruga më e drejtë”. Pa dyshim, forma më e fundit dhe më e përsosur e këtij zinxhiri orientuesish të nisur me njeriun dhe, njëkohësisht, profetin e parë, për të ardhur gjer në ditët tona, është Islami. Kjo përsosmëri është në të gjitha parimet e Islamit. Këtë e shohim edhe në ngjarjen e therjes së kurbanit që është një metodë mjekimi e shumanshme të cilën ia ka ofruar njerëzimit Islami.

* * *

Le të përpiqemi t’u japim përgjigje këtyre pyetjeve:

* Ç’është kurban? Pse theret kurban?

* Ç’kërkohet të na thuhet ne në rrëfimin e Hz. Ibrahimit ku e ka zanafillën kurban?

* Ndërsa ndarja e mishit të kurbanit në tri pjesë dhe shpërndarja e dy prej tyre është sunnet, pse derdhja e gjakut është vaxhib?

Kafsha të cilën muslimani që zotëron pasurinë në masën e quajtur nisab, e ka blerë me para të fituara në mënyrë legjitime (hallall) dhe e ther në ditë të caktuara në emër të

Allahut dhe për pëlqim të Tij, është kurban.

Disa prej urtësive në thelb të këtij akti dhe dobive që na siguron ne, mund t’i radhisim kështu:

Për sa i përket formimit të themelit të ngjarjes së kurbanit, iniciativa e Hz. Ibrahimit për ta bërë

Iniciativa e Hz. Ibrahimit për ta bërë kurban të birin Ismail “sipas urdhrit hyjnor”, është akti i lartë i gatishmërisë për ta këputur pjesën më të çmuar dhe frytin më të bukur të jetës për hir të Zotit! Dhe kjo ngjarje ka qenë e mjaftueshme që babë e bir të bëhen një shembull i pashoq dhe i përjetshëm i “zbatimit të urdhrit” dhe “durimit”!

kurban të birin sipas urdhrit hyjnor, ka kuptim të thellë, sepse fëmija është pjesë e trupit të nënës dhe babait, rezultat i qenies së tyre materiale, vazhdim i qenies së tyre edhe materiale, edhe shpirtërore. Pra, fëmija, duke mbledhur në vetvete përpjekjet shumëvjeçare të prindërve, shndërrohet në pjesë të jetëgjatësisë së tyre. Prandaj, iniciativa e Hz. Ibrahimit për ta bërë kurban të birin Ismail “sipas urdhrit hyjnor”, është akti i lartë i

gatishmërisë për ta këputur pjesën më të çmuar dhe frytin më të bukur të jetës për hir të Zotit! Dhe kjo ngjarje ka qenë e mjaftueshme që babë e bir të bëhen një shembull i pashoq dhe i përjetshëm i “zbatimit të urdhrit” dhe “durimit”!

Në ajetin kur’anor që e shpreh këtë, Allahu i Lartë thotë kështu: “Atëherë, kur i biri arriti moshën që ta ndiqte pas, i tha: “O bir, pashë në ëndërr sikur po të therja. Ti, ç’thua?” (I biri) i tha: “O im atë, bëj atë që je urdhëruar. Në dashtë Allahu, do të më gjesh durimtar!” (1)

Ja, pra, nga një burim i tillë i madh i dashurisë hyjnore buron ngjarja e kurbanit dhe, me anë të begatisë së kësaj dashurie, u ofron të gjithë muslimanëve mirësinë, dobinë, bollëkun dhe dashurinë!

Kuptimi i vazhdimit tek ne të ngjarjes së therjes së kurbanit në formën e therjes së dashit, është ky:

Pranimi nga njeriu që, me paratë si pjesë të jetës së tij, të blejë një dash e ta therë si kurban, është si pranimi nga ai që ta therë të birin, pjesën e qenies së tij si fryt të përpjekjeve të mëdha. Këtu ngjajnë me njëra-tjetrën ndodhia e Hz. Ibrahimit me kurbanin tonë.

Në thelbin e kuptimit të kurbanit qëndron parapëlqimi i idesë ndaj materies, i dashurisë hyjnore ndaj parasë! Kështu, edhe pikënisja e Hz. Ibrahimit ishte dashuria për Allahun. Kjo sjellje vazhdon tek ne në formën e një edukimi orientues ndaj dashurisë hyjnore. Këtu, iniciativa



e Hz. Ibrahimit për ta bërë kurban të birin dhe përpjekja jonë për të bërë kurban një dash, e kanë ndarë në nivele dashurinë mbilëndore. Ndaj dashurisë hyjnore për të cilën Hz. Ibrahim i qe i denjë me plot kuptimin e fjalës, ne përiqemi të bëhemi të denjë duke sakrifikuar dashuritë tona në nivel të dytë e të tretë, siç janë paraja dhe pasuria. Dhe kjo tregon se është e mundur që një dashuri lëndore-materiale çfarëdo mund të shndërrohet, me përpjekje dhe sakrifica, në dashuri hyjnore, e cila është ideale! Ky është edhe thelbi i çështjes, sepse Allahu s'ka nevojë as për gjakun e as për mishin e kurbanit. Të gjitha këto nuk kanë asnjë vlerë tjetër veç shtimit të afërsisë dhe dashurisë sonë ndaj Allahut!

Me anë të rrëfimit të Hz. Ibrahimit, Zoti na kujton neve se dashuria hyjnore qëndron mbi të gjitha dashuritë, se të gjitha dashuritë fisnike burojnë prej saj, se nga dashuria hyjnore askush dhe në asnjë formë s'ka për të parë dëm, se kjo dashuri do të sjellë vetëm mirësi dhe dhembshuri dhe se do të bëhet shpëtimtare për njeriun.

Fakti që shpërndarja e mishit të kurbanit është sunnet, që derdhja e gjakut është vaxhib, që therja e kurbanit nga vetë personi është virtyt, që personi i cili ther kurban, po të mos e therë vetë ose po të jetë grua, duhet të jetë i pranishëm gjatë therjes, si dhe fakti që kjo edukatë zbatohet rregullisht çdo vit, u mësojnë muslimanëve të jetojnë njerëzisht si në luftë, ashtu dhe në paqe!

Me këtë ajet kur'anor, Allahu i Lartë e shpreh qartë se tek njeriu ekziston instinkti i derdhjes së gjakut:

“Zoti yt u pati thënë engjëjve:

Allahu e trajton çdo gjë në mënyrën më të mirë. Kur ta bëni një kafshë kurban, theni në mënyrën më të mirë. Thikën mprihen mirë dhe kafshën qetësojeni!

“Unë do të krijoj një zëvendës mbi tokë!” Engjëjt i thanë: “A mos do të krijosh atje dikë që të prishë e shkatërrojë e që të derdhë gjak? Kurse ne të lavdërojmë e të madhërojmë pa pushim!” Dhe Zoti yt u tha: “Pa dyshim, unë di ato që ju s'i dini!” (2)

Nga kjo mund të nxjerrim këto përfundime:

1) Në natyrën krijimore të njeriut përmbahet instinkti i derdhjes së gjakut.

2) Zoti u ka bërë të ditur engjëjve se njeriu mund ta shërojë më së miri këtë instinkt me anë të ilaçit të kurbanit.

3) Popujt që s'therin kurban, e kënaqin këtë instinkt me rrugë dhe mjete jolegjitime, duke derdhur gjak me të tepërt në luftë, në paqe dhe dëfrime.

Kurbani i afron njerëzit te Allahu. Edhe Allahu ua dhuron njerëzve me shumicë të gjitha të mirat e buruara nga kurbanit. Kështu, muslimani fiton atributin “njeri i përkryer” i cili u jep vlerë të gjithë njerëzve si njerëz që janë, dhe tregon mëshirë për të gjitha gjallesat.

Në hadithin profetik thuhet: “Allahu e trajton çdo gjë në mënyrën më të mirë. Kur ta bëni një kafshë kurban, theni në mënyrën më të mirë. Thikën mprihen mirë dhe kafshën qetësojeni!” (3)

Nga të gjitha këto kuptojmë se qëllimi i kurbanit nuk është shpërndarja e mishit, por derdhja e gjakut. Dhe “derdhja e gjakut në mënyrën më të mirë”! Qëllimi i kurbanit është kënaqja e instinktit të gjakderdhjes që ekziston tek njeriu, përmes një shenjtërie të gjerë dhe në mënyrë të dobishme për shoqërinë, është pritja e kthimit të shërbimit në dashuri, është kërkimi i arritjes së dashurisë hyjnore duke sakrifikuar dashuritë e vogla.

Detyrat gojore në adhurimin e kurbanit janë të kufizuara. Ato përbëhen prej tekbireve dhe



Fakti që shpërndarja e mishit të kurbanit është sunnet, që derdhja e gjakut është vaxhib, që therja e kurbanit nga vetë personi është virtyt, u mësojnë muslimanëve të jetojnë njerëzisht si në luftë, ashtu dhe në paqe!

besmelesë. Kurse punët që do të bëjmë me trup ose fizikisht dhe materialisht, janë të fitojmë para dhe ta blejmë kafshën e kurbanit, ta sjellim, të kujdesemi për të, ta therim dhe ta shpërndajmë mishin. Të gjitha këto veprime kërkojnë një kohë të caktuar prej shumë ditësh. Me këtë, feja jonë na mëson të bëjmë punë sistematike duke folur pak e duke vepruar shumë.

Kënaqësia dhe begatia që vjen me kurbanin zgjat plot një vit dhe çdo vit, ky adhurim përsëritet me besim i cili është treguesi më i bukur i nënshtrimit ndaj Zotit, dhe me shpresë. Në këtë mënyrë, muslimanët bëhen personalisht dëshmitarë të së vërtetës së vdekjes dhe të kthimit përsëri tek Zoti!

Poshtëshënimet:

1. Kur'ani, Saffat: 102.

2. Kur'ani, Bakara: 30.

3. Muslim, Sayd, 12

NDJENJAT SHPIRTERORE TE HAXHIT

Arafati na kujton ngritjen nga varret për në mëngjesin e kiametit dhe mbledhjen në grupe në fushën e tubimit. Të gjithë njerëzit para Allahut, në një mënyrë të dobët, nevojtare dhe shqetësuese presin falje. Në të njëjtën kohë kjo falje është një simbol i Hz. Adem dhe nënës tonë Havasë të cilët u takuan në luginën e Arafatit dhe duke qarë kërkuan falje.

Haxhi, një nga pesë shtyllat themelore të islamit, është një adhurim madhështor, i cili që nga Ademi alejhisselam deri tek profeti i kohës së fundit, shprehjet e zemrave të djegura përplot lloj-lloj kujtimesh madhështore, të vërtetën dhe esencën e besimit, i shpie në zemra, dhe të njëjtën e tubimit, duke e jetuar në këtë botë, është shkak për të vërtetën e sekretit “vdisni para se të vdisni”.

Adhurimi i haxhit ka shumë hikmete urtësi për këtë botë dhe për botën tjetër.

Haxhi i vërtetë është një adhurim i shenjtë dhe madhështor brenda të cilit miqësohet ndjenja dhe emocioni i dashurisë së një besimi të thellë të muslimanëve, që është arritje e faljes dhe shfaqje e pafundme e mëshirës së Allahut.

Haxhi është një vëllazërim në besim që mund të marrin pjesë nga mbështetja dhe nënshtimi (ndaj Allahut) i Ibrahim (a. s.) dhe Ismail (a. s.), që të mund të godasim me gurë armikun “ego”, në brendinë tonë dhe tendencat djallëzore, që janë jashtë nesh, duke dalur nga dallimi i klasave dhe duke hyrë në klimën e qefinit që të mund të strehohemi te Zoti, që të rrënqethemi me ndjenjën e



tmershme të panoramës së kiametit, që mbledh mes muslimanëve popujt e largët dhe të huaj.

Haxhi, në një kuptim tjetër, është dalje nga veshja trupore duke influencuar në thellësinë e shpirtit dhe një përpjekje për shpëtimin nga furtunat e forta vetjake.

Ndërsa vendet e bekuara ku bëhet haxhi, janë klimat e ndjenjave shpirtërore të një bote madhështore.

Këto vende të shenjta, që nga Ademi alejhisselam deri më sot janë ushqyer me ndjenjat shpirtërore të zemrave besimtare dhe janë njomur me lotët e ëmbël të dashurisë. Ata që bëjnë haxh në ato vende, kërkojnë dhe gjejnë këto

dhe gjurmët e hapave të shumë profetëve. Në veçanti, këto vende të shenjta që janë një burim i qetësisë shpirtërore, janë të mbushura me kujtimet e shkëlqyera të zinxhirit pejgamberik.

Ne një fjalë, obligimi i haxhit është një adhurim përfshirës, që e drejton individin në përsosmërinë e fesë.

Haxhi është një adhurim i mbushur me manifestimet shpirtërore, harmoninë shpirtërore të njeriut, klimën dhe ngjyrën që ka gjetur, personalitetin origjinal që ka fituar, pastrimin me shirat e qetësisë shpirtërore dhe me arritjen e së vërtetës.

Arafati është një vend faljeje dhe strehimi.

Arafati na kujton ngritjen nga varret për në mëngjesin e kiametit dhe mbledhjen në grupe në fushën e tubimit. Të gjithë njerëzit para Allahut, në një mënyrë të dobët, nevojtare dhe shqetësuese presin falje. Në të njëjtën kohë kjo falje është një simbol i Hz. Adem dhe nënës tonë Havasë të cilët u takuan në luginën e Arafatit dhe duke qarë kërkuan falje. Ashtu që Allahu i cili është bujar dhe mirëbërës, duke i pranuar duatë e tyre dhe nga brezi i tyre deri në ditën e gjykimit, çdo vit në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën orë të gjithë ata që vijnë atje dhe kërkojnë falje ka premtuar se do t'i falë.

Pas këtij takimi, Ademi alejhissalam me nënën tonë Havanë, vendin në të cilin sot gjendet qyteti i Mekës, e bënë atdhe të tyre. Për këtë arsye edhe një emër tjetër i qytetit të Mekës, në kuptimin “nëna e vendeve të banuara”, është Ummul-Kura.

Muzdelifeja është një vend i mbushur me manifestimet mëshirore me ndjenjën shpirtërore “el-Mesh’aru’l-Haram, e cila tregohet në Kur’anin fisnik. Ky është vendi ku zemrat, duke iu përlur madhësisë së Zotit, fuqisë së Tij, dhe mbretërimit madhështor të Tij, me manifestimet hyjnore, e hedhin prapa dynjanë dhe botën tjetër.

Mina është një vend nënshtrimi dhe mbështetjeje, ku Ibrahim alejhissalam dhe Ismail alejhissalam fituan ndaj shejtanit.

Kodrat Safa dhe Merve, në pikën ku sot gjendet burimi (pusi) i zemzemit, janë dy kodra që neve na kujton paafësinë njerëzore me lutje Allahut dhe ku Hz. Haxher e shqetësuar shkonte dhe vinte me qëllimin për të gjetur ujë për birin e saj Ismailin alejhissalam, i cili ishte i shqetësuar nga etja. Kjo është një shtyllë themelore që në



Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë), e dobishme udhërrëfyese për mbarë njerëzimin.

Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në të, ai është i sigurt. Për hirë të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimit te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (adhurimin që e bëjnë) njerëzit.

manifestimet e haxhit ka marrë vendin e tij me emrin Sa’j. Kodra Safa na kujton, që gjërat, të cilat e prishin pastërtinë e zemrës, të mos hyjnë në zemër.

Qabja është qëllimi i drejtësisë

së adhurimit të namazit, që e ka urdhëruar Allahu me thënien e Tij në Kur’an “Bëj sexhde dhe afroju (Allahut)”. (el-Alak, 19). Në të njëjtën kohë është pika ku të gjithë myslimanët drejtohen sëbashku, domethënë është vendi ku bota islame hedh depresionin e saj. Vendi i pamjeve hyjnore të njeriut është zemra, ndërsa në gjithësi është Qabja. D.m.th Qabja në një kuptim në trupin e njeriut ka vlerën e zemrës. Për këtë arsye haxhi është një adhurim i ndjeshëm, që kryhet me pastërtinë e zemrës.

Atje është vendi i Halilullahut, i cili e mbajti premtimin që ia dha Allahut. Allahu i ka urdhëruar ata të cilët ishin para dhe pas Halilullahut, me faljen e namazit të tavafit prapa vendit të tij.

Edhe “haxheri esved” që është në Qabe, është një gurë i bekuar, që përshëndetet dhe uthet dhe ku i jepet besa dhe fjala Allahut. Të përshëndesësh atë, në të njëjtën kohë është dhënie e fjalës për tërheqjen e dorës nga prirjet vetjake dhe veprimet djallëzore.

Qabja, e cila cilësohet si “Bejtullah”, duke filluar që nga Ademi alejhissalam, është një vend i shenjtë adhurimi, dhe obligimi i peligrinazhit për ata që kanë

mundësi, ne ajetin fisnik shprehet kështu: “ Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë), e dobishme udhërrëfyese për mbarë njerëzimin.

Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në të, ai është i sigurt. Për hirë të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (adhurimin që e bëjnë) njerëzit.” (Al-i Imran, 96-97)

Duke kuptuar mirë sekretin e ajetit fisnik, duhet larguar menjëherë nga mosdëshira dhe mos interesimi ndaj adhurimit të haxhit. Në të kundërt paralajmërimi i Profetit salallahu alejhi ve sellem është i frikshëm dhe i tmershëm: “ Nëse dikush posedon ushqim , pije dhe mjet transporti, kur ka mundësi të shkojë në Bejtullah (Qabe) dhe nuk shkon, nuk ka asnjë pengesë që ai të vdesë si çifut apo si kristian”.


Ky paralajmërim profetik u kujton ndëshkimin e Zotit të gjithë atyre, që posedojnë të gjitha kushtet e shkuarjes në haxh dhe për shkak të pakujdesisë e lënë pas dore.

Sepse kjo gjendje nënvlerësimi e këtij adhurimi, do të thotë mospërfillje e tij.

Haxhi për arsye se është një herë në jetë, ta vonosh është shumë gabim. Po ashtu i dërguari i Allahut ka thënë: “ Kushdo që ka për të shkuar në haxh, duhet të nxitojë”.

Bejtullah është një vend i mbushur me kujtimet e mbështetjes dhe nënshtrimit (ndaj Allahut) të Ibrahimit alejhisselam dhe familjes

Në haxhin e lamtumirës, nga Profeti alejhisselam, në të njëjtën kohë është bërë një shpërndarje dashurie. Ligjet kryesore mes muslimanëve janë siguruar me fuqinë e dashurisë dhe mëshirës. Njëri nga rezultatet më natyrore është veshja me moralin hyjnor dhe posedimi i një zemre të butë dhe plotë me mëshirë. Konceptimin e adhurimeve me një zemër të tillë veçanërisht të vëtetën e haxhit,



së tij.

Kur përmenden fjalët mbështetje, nënshtrim dhe haxh vjen në kujtesë Ibrahimit alejhisselam dhe Ismailit alejhisselam, sepse haxhi në sajë të sinqeritetit të tyre është një punë e devotshme që do të përsëritet deri në ditën e kiametit.

Në zemrën e Ibrahimit alejhisselam nuk kishte vend për asnjë gjë veçse për Allahun, por melekët thanë: “O Zot Ibrahim ka shpirt, fëmijë dhe pasuri! Si mund të bëhet ai miku Yt?!” Por Allahu teala u tregoi melekëve nënshtrimin pa kundërshtim të Ibrahimit. Këto sprovime dhe rezultate do të jenë shembull për ummetin.

Kur Ibrahimit alejhisselam do të hidhej në zjarr, melekët i erdhën për ndihmë, por ai:

“Nuk kam nevojë për ju!. Kush ia ka dhënë forcën djegëse zjarrit?”- tha dhe duke thënë “Sa ndihmues i mirë është Allahu”, u strehua te Zoti i tij.


Si shpërblim kundrejt këtij nënshtrimit të tij, zjarrit iu tha: “ O zjarr, bëhu i freskët dhe paqe për Ibrahimin”.

Përsëri babë e bir gjatë një dhimbjeje nënshtrimit, njëri për të bërë kurban dhe tjetri për t’u bërë kurban, e goditën me gurë shejtanin, icili punonte për të prishur lidhjet që kishin me Zotin e tyre. Kështu që në pikën më të lartë të nënshtrimit, atyre iu zbrit si mëshirë hyjnore një dash nga xhenneti.

Lëvizjet e ngjashme me manifestimet e haxhit, që urdhërohen për çdo haxhi, janë që të kujtojnë këto ngjarje dhe të merret urtësia hyjnore që ndodhet në to.

Edhe pasuria e Ibrahimit alejhisselam kundrejt tri herë përkujtimit të Xhebrilit është bërë e pavlefshme. Tha:- “Merri këto dërgoju!”, sepse adhurimi i vëtetë është nënshtrimi. Allahu xhelle xhelaluhu do që robi të mos i bindet askujt përveç Tij.

Nënshtrimi është një çështje



bindjeje e mbështetur në dashuri. Me këtë fryt bindjeje dhe nënshtrimi, Ibrahimit alejhisselam, në rrugën e Zotit të tij të madhërishtë, nuk mundi t'i krijojë asnjë lloj pengese as shpirti, as pasuria e as fëmijët e tij, sepse gjuha e Ibrahimit alejhisselam gjithmonë i thoshte zemrës së tij: “ E kam nënshtruar veten time (si mysliman) ndaj Zotit të gjithësisë”. (el-Bakara, 131).

Haxhi, i cili është simboli i mbështetjes dhe nënshtrimit të Ibrahim dhe Ismail alejhimassalam, duke dalur nga cilësitë e njeriut, është një hyrje për në atmosferën e faljes, nënshtrimit dhe mbështetjes. Haxhi është një zbatim i adhurimit plot me dashuri. Ai është një nënshtrim i plotë i zhveshjes së robit nga niveli i dynjasë me një peshqir lartë e poshtë dhe me kokë e këmbë hapur, duke u ngritur nga një lloj varri, ardhja e tij në tubim dhe lutja nga zemra Zotit të tij.

Kështu pra adhurimi i haxhit na tregon, që rënia e gjynaheve realizohet vetëm pas bërjes së një lutjeje dhe adhurimi me frytin e mbështetjes dhe të nënshtrimit.

Haxhi dhe hutbeja e fundit e Pejgaperit a.s. sa shembull i bukur është për haxhet që do të bëjë ummeti deri në kiamet.

Në haxhin e lamtumirës nga Profeti alejhisselam, në të njëjtën kohë është bërë një shpërndarje dashurie. Ligjet kryesore mes myslimanëve janë siguruar me fuqinë e dashurisë dhe mëshirës. Njëri nga rezultatet më natyrore është veshja me moralin hyjnor dhe posedimi i një zemre të butë dhe

Kur je me ihram (rrobë që vishet në haxh), nuk këputet bar, nuk shkullet qime. Nuk vriten kafshë. Nuk ka imoralitet as çrregulli. Edhe Omeri (Zoti qoftë i kënaqur prej tij), me ankthin për të mos lënduar një musliman, në gjendje kallaballëku, ndaloi puthjen e gurit të zi.

plotë me mëshirë. Konceptimin e adhurimeve me një zemër të tillë veçanërisht të vëtetën e haxhit, Xhelaleddin Rumi kuddise sirruh e shpreh me tregimin e mëposhtëm:

Njëri nga të mëdhenjtë e ummetit, Bejazid Bestami, për bërjen e haxhit dhe të umres shkonte me nxitim. Në rrugë takoi një të moshuar që sytë i kishte nga dynjaja, por zemra e tij shpërthente dritë si diell. I moshuari i tha atij:

“Ej, njeri, ku po shkon? Ku po i çon plaçkat e kurbetit?”

Bejazidi tha: “Kam vendosur të shkoj në haxh dhe kam dyqind dirhem”.

I moshuari i tha atij: “O njeri, një pjesë të pasurisë, që e ke në këtë dynja, shpërndajua nevojtarëve, të vetmuarve dhe të mjerëve. Hyr në zemrat e tyre, që të të hapet horizonti

i shpirtit tënd! Fito një jetë të pavdekshme!

Së pari bëji haxh zemrës tënde, pastaj vazhdo rrugën për në udhëtimin e rëndësishëm të haxhit, sepse Qabja është shtëpia e vizitës së Zotit, dhe kjo vizitë është një nga pesë shtyllat farze të islamit.

Por zemra e njeriut është një thesar fshehtësie. Qabja është ndërtesa e Ibrahimit, birit të Azerit, ndërsa zemra është vendi i cili shihet nga Allahu i cili është më i madhi.

Nëse ti ke objektivitet, bëji tavaf “Qabes” së zemrës! Kuptimi origjinal i Qabes për të cilën ke pandehur se është bërë nga toka, është zemra.

Zoti ta ka bërë obligim ty bërjen tavaf Qabes, në një mënyrë, që duket dhe dihet, që të fitosh një zemër të pastruar nga papastërtia dhe të rafinuar.

Këtë dije mirë: në qoftë se lëndon ose thyen vendin, që shikon Allahu, i cili është zemra, sevapi që e ke fituar duke shkuar në Qabe në këmbë, nuk e ekuilibron gjynahun e zemrës së thyer.

Kije kujdes këtë hadith kuds: “Qiejt dhe toka nuk mundën të më merrnin mua brenda, por zemra e robit tim besimtar, të pastër dhe i shpëtuar nga gjynahet, më mbuloi mua”.

Kur të vijë koha e haxhit, shko vizitoje Qaben me njetin e tavafit! Nëse shkon me këtë njet, do të shohësh realitetin e Mekkes!”

Bejazidi i konceptoi këshillat e të moshuarit dhe me zemër e dashuri mori një pjesë nga të fshehtat e mëshirës.

Dhënia e haxhit në shembull e

Mevlanës, është nga që haxhi është një adhurim shumë i rëndësishëm, sepse në haxh, shumë gjëra që janë të lejuara, ndalohen. Për këtë arsye në udhëtimin e haxhit duhet të shkohet me një përgatitje shpirtërore. Veçanërisht kur një person vendos të shkojë në haxh, shejtani i vihet nga pas. Për këtë shkak, arma e parë, që veshin ata që do të shkojnë në haxh, duhet të jetë “durimi”.

Në haxh zemrat të cilat strehohen te Allahu, duke iu përgjigjur thirrjes së Tij, pas pohimit se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, duhet të dinë se kanë dhënë fjalën për të mos iu drejtuar më thirrjeve vetjake, thirrjeve të shejtanit dhe dëshirave të epshit.

Manifestimet e haxhit e drejtojnë njeriun për te jeta shpirtërore, sepse ky adhurim i rëndësishëm, është i mbushur me shfaqjet e përzemërsisë, mëshirës dhe dashurisë dhe me ndalimin si mosgjuetia, moskëputja e një dege të gjelbërt, mosposhtërimi i një krijese të Zotit.

Kur je me ihram (rrobë që vishet në haxh), nuk këputet bar, nuk shkulet qime. Nuk vriten kafshë. Nuk ka imoralitet as çrregulli. Edhe Omeri (Zoti qoftë i kënaqur prej tij), me ankthin për të mos lënduar një musliman, në gjendje kallaballëku, ndaloi puthjen e gurit të zi.

Këto sjellje dhe gjendje në haxh, duke e lënë njeriun ballëpërballë me llogarinë e vetes, ndikojnë në jetën e ardhshme të tij. I vetmi qëllim i të gjithë adhurimeve është afrimi te Allahu.

Siç kanë namazi dhe agjërimi nafilet e tyre, edhe haxhi ka nafilen e tij. Të bëshë qortime me injorancë rreth adhurimit të haxhit nafile, Allahu na ruajtë, këto janë fjalë kufri. Këta, duke qenë mendime injorante dhe të pa baza, janë shprehje mërzitëse dhe provokative për kënaqësinë e adhurimit.

Nafilet kanë filluar me një ndjenjë imani që nga Asri-Seadet.

Adhurimet nafile, të cilat bëhen me emocion dhe përmallim, e bëjnë robin të suksesshëm ndaj shfaqjes së afrimit tek Allahu, e thellojnë shpirtin, zgjerojnë cilësitë e mëshirës dhe bujarisë. Bëhet syri që shikon Zotin dhe veshi që e dëgjon Atë, d.m.th. shikimet, ndjenjat, mendimet dhe shprehjet e tyre janë gjithnjë një rrjedhojë e dritës hyjnore.

Këto ngritje bëhen të mundura me dashurinë ndaj adhurimeve që janë nafile dhe me mëshirë ndaj krijesës. Është e mjaftueshme për këtë çështje të thuhet se Imam Azami (Ebu Hanife) ka bërë haxh 55 herë.

Siç është haxhi me Arafat që bëhet një herë në vit dhe në ditë të caktuara, është edhe umre që bëhet në çdo kohë. Kësaj i thonë haxh i vogël.

Në umre nuk ka Arafat, por ka vetëm tavaf Qabes dhe sa’j ndërmjet Safa dhe Merve. Umre, nëse bëhet

në Ramazanin fisnik, nga ana e Profetit sallallahu alejhi ve sellem është dhënë një përgëzim sevapi haxhi.

Ndërsa vendi i Profetit sallallahu alejhi ve sellem që e vizitojmë në Medine, është një vend, ku zemra duke u zbukuruar me dekoret e dashurisë hyjnore, fiton fisnikëri, sepse vetëm ai (Profeti) është nderuar me fjalën e Zotit “habibim”.

Për këtë arsye, kur mbaron ibadeti i haxhit, duhet të drejtohem i nga Medine. Duke i vizituar ata vende që mbajnë Profetin sallallahu alejhi ve sellem, duhet të merret hise (pjesë) nga era e Tij sublime dhe e frytshme. Në një hadith fisnik i dashuri jonë sallallahu alejhi ve sellem thotë: “Ai i cili më viziton mua pas vdekjes sime, është sikur më ka vizituar në jetën time”.

Arkitekti shpirtëror i Pakistanit Muhammed Ikbal, një ditë duke



Bëji haxh zemrës tënde, pastaj vazhdo rrugën për në udhëtimin e rëndësishëm të haxhit, sepse Qabja është shtëpia e vizitës së Zotit, dhe kjo vizitë është një nga pesë shtyllat farze të islamit.

Bëji tavaf “Qabes” së zemrës! Kuptimi origjinal i Qabes për të cilën ke pandehur se është bërë nga toka, është zemra.

vizituar haxhitë e kthyer nga Medina, duke iu ekspozuar atyre një zemër myslimani, u bëri atyre këtë pyetje:

“Keni vizituar Medinen! Me çfarë dhuratash i keni mbushur zemrat tuaja nga tregu ahiretor i Medines? Dhuratat materiale si takket, tespihet që i keni sjellë, pas një farë kohe do të vjetërohen, do të veniten dhe do të mbarohen. A keni sjellur dhuratat shpirtërore të Medines të cilat i japin jetë zemrave dhe nuk veniten?”

Brenda dhuratave tuaja a ndodhet sinqeriteti dhe nënshtrimi i Hz. Ebu Bekr, drejtësia e Hz. Omer, turpërimi dhe bujaria e Hz. Osman, entuziazmi dhe xhihadi i Hz. Ali? Botës së sotme islame, e cila është e zhytur në një mijë vështirësi, a mund t’i jepni nga zemra juaj një entuziazëm të Asri Seadet?

Allahu, duke na e bërë risk përfitimin nga ndjenjat shpirtërore të Haramejnit, na e bëftë risk (nasip) që me një zemër të djegur të vizitojmë të dërguarin e Tij.

Zoti ynë na faltë një jetë brenda mbështetjes dhe nënshtrimit! Vendi ku strehohemi, qoftë vetëm Ai! Na e bëftë risk kryerjen e haxhit me një zemër që ndjen!...

Amin!...

Përktheu Fatmir Sulaj

Bajram

**Bajrami vjen, bota e përlotur po gëzohet sot;
Bajrami vjen një jetë e re shpërthen...
Çdo pamje mëngjes e mbrëmje në të qarë duke qenë,
Bajrami vjenë e shpirti i gjithësisë merr gëzim...**

**Bajrami vjen, kohë e vend mbushen me hare;
Për gëzimin e çdo zemre është një shkak i ri...
Buzëqeshje e jetimëve, e të varfëve, e të mjerëve;
Lumturi e botës është në sytë e mi...**

**Kemal Efendi Aruçi
Nëntir 1939**

Abetarja e Hafiz Ali Ulqinakut

Analizë

Në vazhdim trajtohet tema “Fjalë për besimin”, ku jepen njohuri fillestare në përshtatje edhe me mundësitë dhe nivelin e fëmijëve.

Nëpërmes një teksti të lidhur, autori shtron në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë shtyllat e besimit islam.

Në pamje të parë është një grumull fjalësh e shprehjesh, por duke i lidhur ato, ne nxjerrim të plotë dhe të qartë këto njohuri: Zoti (Përendia) gjithçka është ai që shpif (e krijon). Zoti (është) një. Shok nuk ka. Ne na ka dërguar qitabe (libra) dhe pejgamberë. Edhe dita e kametit, me të vërtetë, është. Mirë e keq, çdo send prej Zotit vjen. Pas vdekjes papë ke për t’u ngjallë. Muhammedi alejhis-selam, është Rob i dashur i Zotit.

T’gjithave i besuam. Këto ide janë të njohura për të gjithë, prandaj edhe nuk kanë nevojë për t’u analizuar. Në kushtet e mësimin për fëmijët e klasës së parë autori, në mënyrë të thjeshtë, me fjali të shkurtëra e të kuptueshme, parashtron idetë me themelore të besimit.

Pjesa “Përseri fjalë për kohën”

nuk është përsëritje e temës së mëparshme, ajo është më e zgjeruar. Në vend të fjalëve ka për bazë fjalitë që kanë karakter pyetës me përgjigjet përkatëse. Trajtimi metodik i lëndës ndryshon. Mësimi zhvillohet në formë pyetjesh e përgjigjesh mes mësuesit (librit) dhe nxënësit.

Pyetje të tilla kanë të bëjnë me vitin, muajt, javët, ditët, orët, minutat e sekondat, ato kanë një shkallëzim të natyrshëm dhe krijojnë një tablo të qartë për kohën dhe lidhjet logjike mes përbërësve dhe njësive të saj

Ja, për konkretizim pyetjet e paraqitura: *Nji vjet sa muj isht? Nji muj sa jav isht? Nji jav sa dit ka? Nji muj sa ditë ka? Nji dit sa ças isht? Nji ças sa dekike ka? Nji dekike sa sanije ka?*

Këtyre pyetjeve u jepen përgjigjet përkatëse: *Nji vjet dymdhet muj isht, nji muj katyr jav isht, nji jav shtat dit ka, nji muj tridhet ditë ka, nji dit dymdhet ças isht, nji ças gjashdhet dekike ka dhe nji dekike gjashdhet sanije ka.*

Një tjetër pjesë, për subjekt, ka kohën. Ajo titullohet “Emrat për kohën”. Edhe këtu nuk ka përsëritje, por ka elemente të reja. Nëpërmjet kësaj pjese, jepen emrat e ditëve dhe të muajve. Shënojmë se emrat e



Hafiz Ali Ulqinaku

në bazë të kalendarit hënor e atij diellor. Sipas hënës emrat e muajve i shënon: *Muharrem, Safer, Rebi’ul-evvel, Rebi’ul-ahir, Xhumad’il-evvel, Xhumad’il-ahir, Rexhep, Sha’ban, Ramazan, Sheval, Zi’l-ka’de dhe Zi’l-hixhxe.*

Duke vazhduar paraqitjen e përmbajtjes së pjesëve i vjen radha “Emrat e muajve dijellit”. Kjo është një pjesë e gjatë, ku jepen emrat e muajve si vijon: Mars, Prill, Maj, Qershyr, Korrik, Gusht, Briti, Britni, Britmuri, Shinondre, Kallnur dhe Shkurt hem frur.

Pas muajve jepen stinët. Pyetjes: *Nji vjet sa copa ka*, i jepet përgjigja: *Nji vjet katyr copa ka.*

Në vazhdim trajtohet tema “Fjalë për besimin”, ku jepen njohuri fillestare në përshtatje edhe me mundësitë dhe nivelin e fëmijëve.

Nëpërmes një teksti të lidhur, autori shtron në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë shtyllat e besimit islam.



Autori, për konkretizim të përgjigjes, jep emrat e stinëve: *Prandver, ver, vjështë e dimyn*. Njëkohësisht, me këtë, në vazhdim jepen muajt që përfshin secila stinë si dhe karakteristikat atmosferike të secilës prej tyre.

Në Abetare jepen emrat përkatëse dhe ajo që të bën përshtypje janë përgjithësimet për çdo stinë. Për pranverën thuhet: *Bin barnet, lulet çilin*. Për verën: *Bahet vap, korren arat*. Për vjështën: *Gjethet derdhen, vneshtat prishen*. Për dimrin: *Bien borna, ftohen motet*.

Pjesa vazhduese "*Fjalë për vendin*", u kushtohet njohurive gjeografike për rruzullin e për kontinentet. Edhe për këtë pjesë përdoret sistemi i fjalëve dhe dhënia e përgjigjeve të duhura.

Fillimisht bëhet pyetja: *Shesha forma e tokes si isht*. Përgjigja është: *Si portogal rrumbullak*. Pyetja: *E sa uj sa tok*, ka marrë përgjigjen: *tri uj një tok*. Më poshtë vazhdohet me pesë kontinentet: *Europa, Asia, Afrika, Amerika dhe Zelanda e Re*.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj pjese trajton veçoritë e sipërfaqes së secilit kontinent, të ujit e të temperaturës, të banorëve, të popullsisë, të madhësisë e të zbulimit të tyre.

Të gjitha këto jepen me pyetje e përgjigje të qarta, që u japin mundësi nxënësve të kuptojnë konkretisht të dhënat.

Pjesa "*Nevojat e domosdoshme*", ka të bëjë me problemet jetësore, me nevojat e ushqimit, të veshjes e të pushimit, me ushqimet më të domosdoshme, me detyrat e njeriut për të punuar tokën e për zbatimin e zanateve, për llojet e punëve, me kujdesin për të ngrënë me masë, për t'u veshur sipas kohës dhe sipas stinës, si duhet të jenë vendet e banimit dhe sa kohë duhet të flihet

duke pasur parasysh moshën si fëmi, si djalosh dhe si plak.

Edhe për këtë pjesë përdoret e njëjta ecuri: pyetje e përgjigje. Përmbajtja e tyre ka karakter edukativ, për të ngulitur te lexuesit e librit norma të rregullta pune e jetese, sjellje të kulturuar, në zbatim të detyrave që shtron jeta e përditshme.

Pjesa e fundit "*Allahu është Krijuesi më i mirë*", ka përfshirë disa lutje fetare të titulluara: "*Përkthimi i Subhaneke*", "*Përkthimi i Ettehijjatu*", "*Përkthimi i "Salavatit"*,

"*Përkthimi i Duave te Kunutit*" dhe përfundon me "*Amentu bi'l-lahi*" arabisht dhe shqip.

Kjo pjesë u shërben nxënësve për të mësuar disa lutje fetare bazë të fesë Islame, që u nevojiten për të zbatuar ritet e të falurit, ose për të shprehur lutje në adhurim të Zotit (xh.sh.) e të derguarit të tij të fundit Muhamedit (a.s.).

Pas paragjithësimit të përbajtjes dhe të një analize të shkurtër të pjesëve përberëse të saj, mund të nxjerrim përfundimin se vlerat pedagogjiko-didaktike të kësaj abetareje mund të përgjithësohen në tre drejtime kryesore:

Së pari. Për mësimin e shkrim-leximit me njohjen e shkronjave e të tingujve, me shkrimin e shqiptimin, me kuptimin e dallimit të tyre, me mësimin e alfabetit, me përdorimin e tyre në fjalë të ndryshme.

Ndarja e abetares në pjesë të ndryshme, ka krijuar mundësi të shumta për pasurimin e fjalorit dhe për shfrytëzimin e tij për formim fjalish. Secila pjesë, sipas temës së caktuar, shërben si një kapitull, ku krijohet një tekst i lidhur që shërben për kalimin nga fjalët në fjalitë e nga fjalitë në tekstin përkatës.

Fjalori dhe fjalitë shërbejnë për zhvillimin e të folurit e të menduarit të nxënësve, për të gjallëruar aktivizimin e tyre në punimin e pjesëve, për të zërthyer kuptimin dhe zbatimin e kerkesave për lexim, shkrim, për të bërë biseda, për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të krijuar shprehje për rregulla praktike gjuhësore.

Së dyti. Për dhënien e njohurive të ndryshme nga mjedisi shkollor, familjar, natyror e shoqëror si bazë për mësimet që do të zhvillohen si lëndë të veçanta. Të kësaj natyre janë njohuritë që kanë lidhje me diturinë e natyrës, gjeografinë e arithmetikën. Konceptet për organet

Vlerat pedagogjiko-didaktike të kësaj abetareje mund të përgjithësohen në tre drejtime kryesore:

Së pari. Për mësimin e shkrim-leximit me njohjen e shkronjave e të tingujve.

Së dyti. Për dhënien e njohurive të ndryshme nga mjedisi shkollor, familjar, natyror e shoqëror.

Së treti. Për edukimin moral, fetar, qytetar e estetik të fëmijëve, aq të nevojshëm që në moshë të re si bazë për një edukim të shëndoshë në të ardhmen.

e trupit, për tokën, për qiellin, për kohën, për vendin dhe për nevojat e domosdoshme jetësore për ushqimet dhe konceptet për veshjen, banesen dhe shendetin, në përputhje me moshën dhe zhvillimin e fëmijëve janë dhënë me saktësi, me thjeshtësi e në mënyrë konkrete dhe kanë ndihmuar për formimin shkencor.

Ky formim, është arritur gradualisht, duke i mësuar njohuritë, duke i grupuar, duke treguar vështirësitë, duke i klasifikuar për tiparet, cilësitë, dukuritë e funksionet e përbashkëta e të veçanta.

Në këtë mënyrë, njohuritë e nxënësve kanë kaluar nëpërmes një shkallëzimi, nga fjala te grupe fjalësh, te fjalia e te teksti, sipas një teme të caktuar.

Shqyrtimi i temave të caktuara sipas pjesëve të ndryshme, fakton në mënyrë bindëse, se sasia e fjalorit është e bollshme, se shumica e njohurive të dhena përmes tyre është e kënaqshme, se ngarkesa me materialin faktik ka qënë e favorshme për formimin e fëmijëve.

Ky vëllim njohurish, ka bërë të mundur kalimin nga abetarja te libri i leximit dhe nga abetarja në lëndë të veçanta me karakter shkencor të ciklit të shkollës fillore, siç janë dituria e natyrës, gjeografia e



arithmetika. Kjo Abetare, si tekst fillestar i shkollës fillore, tregon qartë se në atë kohë, në shkollat tona, të cilesuara të prapambetura, në mënyrë krejt të njëanëshme me paragjykime dhe në bazë të kriterëve të paravendosura, niveli i njohurive, jo vetëm që nuk ka qënë i ulët, por sikurse edhe e treguam në mënyrë shumë të përmbledhur, ai ka qënë mjaft i lartë dhe i ka shërbyer formimit shkencor dhe edukativ të fëmijëve.

Së treti. Për edukimin moral, fetar, qytetar e estetik të fëmijëve, aq të nevojshëm që në moshë të re si bazë për një edukim të shëndoshë në të ardhmen.

Për këtë janë caktuar dy pjesë: "Fjalë për besimin" dhe "Allahu është Krijuesi më i mire", që janë një mbështetje e madhe për të dhënë njohuritë më të domosdoshme për bazat e besimit Islam, për kuptimin e vlerësimin e cilësive të rralla, të veçanta e të pakrahasueshme për Allahun, për meritat e Profetit Muhammed, për shtyllat e besimit, për lutje të duhura për të zbatuar ritet e të falurit ose për t'i përdorur për adhurimin e Zotit (xh.sh.) ose për nderimin e Profetit (a.s.).

Njohuri të tilla fetare përforcojnë, saktësojnë dhe pasurojnë ato më fillestaret, që fëmijët e vegjël kanë degjuar ose kanë mësuar në mjedisin familjar, apo në ndjekjen e mejtepeve pranë xhamive.

Lidhur me njohuritë e këtyre dy pjesëve, shërbejnë edhe ato të pjesës "Nevojat e domosdoshme", që kanë material për edukimin moral, sjellje të kulturuar, qëndrime dhe veprime të drejta, të matura e të urta në marrëdhënie me rregullat e normat jetësore.

Për probleme edukimi të përgjithshëm dhe të veçantë estetik e shëndetësor të gërshetuar me atë fetar, shërbejnë edhe materialet e pjesëve të tjera duke i paraqitur, zberthyer, mësuar dhe kërkuar sipas parimeve të moralit Islam.



A betarja e H. Ali Ulqinakut, është një krijimtari e lavdërueshme që nderon autorin dhe që e rendit atë krahas autorëve të tjerë të vlerësuar të Rilindjes Kombëtare që kanë dhënë shembullin e bukur për hartimin e teksteve të tilla.

Kur flasim për vlerat e Abetares, nuk duhet lënë jashtë edhe vlerat e mirëfillta didaktike të saj.

Përmbajtja e abetares, struktura e saj, hartimi dhe kronologjia e pjesëve, mënyra e paraqitjes së tyre, flasin për aftësinë profesionale të autorit, për karakterin shkencor të librit, për zbatimin e parimeve kryesore didaktike.

Gjithë teksti i Abetares përshkohet nga gërshetimi i karakterit shkencor, pedagogjik, didaktik e psikologjik.

Mësimet e ndryshme kanë karakter shkencor, lidhen me jetën, kanë lidhje sistematike e vijimësi nga njëra temë në tjetrën, janë të dhena që e bëjnë të mësuarit të



Hafiz Ali
 Ulqinaku,
 njëkohësisht, është
 edhe përkthyesi i
 Mevlud-i Sherifit
 me autor
 Suleyman Çelebi,
 që ende këndohet
 pothuajse në të
 gjitha trevat
 shqiptare. Ai gjatë
 shkrimit të këtij
 mevludi ka
 përdorur po këtë
 alfabet.

vetëdijshëm e veprues, u japin temave qëndrueshmëri, njohuritë janë konkrete dhe u përshtaten nivelit të zhvillimit të nxënësve, veçorive psikologjike të moshës së tyre.

Të gjitha mësimet shtjellohen nga e afërta tek e largëta, nga e njohura tek e panjohura, nga e lehta tek e vështira, nga konkretja tek abstraktja, nga e veçanta tek e përgjithshmja.

Zbatimi i këtyre parimeve ka ndikuar që autori të mos përdorë një metodë të vetme, analitike, sintetike a globale, por një bashkërenditje të tyre, gjë që ka lehtësuar nxënësit në fitimin e njohurive, aftësive e shprehive gjuhësore, lëndore e edukative.

Një tjetër vlerë e abetares është kujdesi i autorit për paraqitjen e materialit. Gjatë gjithë tekstit, të bie në sy materiali konçiz, pa fjalë të tepërta, pa përsëritje, pa mbingarkesë, pa vështirësi për nxënësit.

Përdorimi i tabelave të shumta për alfabetin, grupimi i problemeve drejtshkrimore e drejtshqiptimore për zanoret e bashkëtingëlloret, sqarimi i çështjeve të veçanta, përgjithësimi i rregullave për lexim e shkrim, shfrytëzimi i shenjave dalluese përkatëse kanë siguruar një varg kërkesash e detyrash për nxënësit që kanë shërbyer për një mesim të menduar e të studjuar mirë gjatë gjithë kursit të abetares.

Vështirimi kritik i lëndës së abetares nxjerr edhe ndonjë boshllëk, dobësi a paraqitje jo të plotë të problematikës së kërkuar gjuhësore, metodike a lëndore.

Kështu p.sh.: në tekst, në mësim të ndryshme, autori nuk përdor shenjat e pikësimit si presjen, piken, pikëpyetësen e të tjera të domosdoshme për drejtshkrim dhe lexim. Në pjesët e ndryshme nuk ka ushtrime për llojet e zanoreve e të

bashkëtingëlloreve, për rrokjen, për fjalët, për fjalitë e për tekstet e lidhura, mungojne vjershat, fotografitë, kërkesa për lexim, për kopjim a për bukurshkrim.

Materiali i tekstit do të ishte më tërheqës po të kishte shembuj nga bota feminare, po të përmbante proverba të thjeshta, përvojë nga jeta që t'u shërbente atyre si model, si udhëheqje për veprim nga ana morale dhe etike në përshtatje me moshën, kohën dhe përspektivën

elif (a)	b	t	th	xh
ا	ب	ت	ث	ج
h	h	d	dh	r
ح	خ	د	ذ	ر
z	s	sh	s	d
ز	س	ش	ص	ض
t	dh	ajn	g	f
ط	ظ	ع	غ	ف
p	ç	c	rr	X
پ	چ	خ	ر	ز
zh	gj	ng (n)	nd (n)	Nj
ژ	گ	نگ	ند	ن
ll	o	y	e	Ë
ل	و	ی	ه	ی
k	k	l	m	n
ق	ک	ل	م	ن
v	h	Lam-elif	j	
و	ه	لا	ی	

e zhvillimit të tyre.

Pavarësisht nga këto verejtje të kuptueshme e të pranueshme për kohën,

Abetarja e H. Ali Ulqinakut, është një krijimtari e lavdërueshme që e nderon autorin dhe që e rendit atë krahas autorëve të tjerë të vlerësuar të Rilindjes Kombëtare që kanë dhënë shembullin e bukur për hartimin e teksteve të tilla.

Pikërisht për këtë është detyrë e studjuesve që, në të ardhmen, Abetarja të përfshihet krahas veprave të tjera në jetëshkrimin e H. A. Ulqinakut, në fjalorët pedagogjikë e enciklopedikë, në tekstet e letërsisë, në historinë e arsimit, në botimet e ndryshme me karakter pedagogjik, didaktik e bibliografik.

Shënim: Po botojmë nga Abetarja e H. A. Ulqinakut një fragment: "Alfabeti i gjuhës shqipe" të transkriptuar dhe të përkthyer nga Dr. Mehdi Polisi.

Alfabeti i gjuhës shqipe

Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim
"O Zot, lehtëso dhe mos vështirëso! O Zot, përfundoje (çdo punë) me të mirë!"

Një pikë (.), dy pika (..), tre pika (:.), shenjat e zanoreve të shkurtra e, i, u (np 0 tenvini: en, in, un (km], shenja e sakinit (), shenja e dyf0 shimit të bashkëtingëlloreve/teshtidi (), shenja e zgjatjes (), hemzeja (), elif ()13

5. Është bashkëtingëllore specifike arabe. Nuk ka barasvlerës në gjuhën shqipe. Është faringale e shurdhët. Në transkriptimin shkencor, për ta dalluar nga h-të e tjera e shënojmë me një vizë poshtë.

6. Nuk ka barasvlerës në gjuhën shqipe. Është frikative prapaqiellore e shurdhët. Gjatë shqiptimit të saj hetohet një grithje. E transkriptojmë me një pikë poshtë.

7. Nuk ka barasvlerës në gjuhën shqipe. Është frikative emfatike alveolare e shurdhët. Dallohet nga s-ja normale, prandaj në transkriptim e shënojmë me një pikë poshtë.

8. Nuk ka barasvlerës në gjuhën shqipe. Është okluzive emfatike alveolare e zëshme. Shqiptohet kur pjesa e brendshme e gjuhës shtrëngohet fortë në qiellzën e butë, kurse maja e gjuhës i prek dhëmbët e sipërm. E transkriptojmë me një pikë poshtë, për t'u dalluar nga d-ja normale.

9. Nuk ka barasvlerës në gjuhën shqipe. Është okluzive emfatike e shurdhët. Për ta dalluar nga t-ja normale, në transkriptimin shkencor e shënojmë me një pikë poshtë.

10. Është bashkëtingëllore specifike arabe. Është frikative ndërthembore e zëshme. Dallohet nga dh-ja e shqipes me faktin se shpina e gjuhës ngrihet te qiellza e butë dhe e ngushton hapësirën, ku del ajri. Në shumë gjuhë e transkriptojnë me z me një pikë poshtë.

11. Është bashkëtingëllore shumë specifike arabe. Është okluzive grykore e thellë. Gjatë shqiptimit të kësaj bashkëtingëlloje muskujt e fytyrës janë të mbledhur dhe të shtrënguar fortë, e pastaj menjëherë lirohen. Edhe në arabishte vështirë shqiptohet pa u përcjellë me një zanore. Në transkriptimin shkencor e shënojmë me këtë shenje (').

12. Paraqet një okluzive velare të pazëshme. Vëndshqiptimi i saj është në pjesën e prapme të gojës.

13. Sikurse shihet, autori në këtë tabelë jep të plotë alfabetin arab. Në u përpoqëm që t'i dallojmë bashkëtingëlloret specifike arabe, disa prej të cilave, siç do të shihet më poshtë, autori nuk do t'i përdore për të shkruar fjalët shqipe.

39. Kjo shkronjë, që në gjuhën arabe quhet hemze, në fjalët shqipe me alfabet arab, autori e ka vënë për të shprehur zanoret (e, i, o, u, y), kur këto zanore janë në pozicion nistor (shih parathënien e veprës). Ky shpjegim dhe sqarim do të vlejë edhe për tabelat e tjera të përdorura në vijim. Në tabela, e kemi vënë vetëm zanoren (e) për të mos e ngarkuar tabelën.



Të gjitha mësimet shtjellohen nga e afërta tek e largëta, nga e njohura tek e panjohura, nga e lehta tek e vështira, nga konkretja tek abstraktja, nga e veçanta tek e përgjithshmja.

Zbatimi i këtyre parimeve ka ndikuar që autori të mos përdorë një metodë të vetme, analitike, sintetike a globale, por një bashkërenditje të tyre, gjë që ka lehtësuar nxënësit në fitimin e njohurive, aftësive e shprehive gjuhësore, lëndore e edukative.



KOSOVË E BUKUR!

Ka kohë që fati s'të ka qeshur,
Ke britur pa pra në mjerim...
Në gërmadhë çdo vend të qe kthyer,
Nga padrejtësitë s'kish mbetur kalim...

Mëngjeset në horizont lindin të mërzitur,
I përgjakur fund e krye qielli me yje qe!
Netët e zeza e të përzishme
Sikur qanin Kosovë,për ty!

Nga toka jote u dëbove; hajduti malazez
I bëhej yot dhe shtëpisë tënde,bile;
Mallit, pasurisë, një jetë të tërë
Dhe, ndërkaq, dhe si shok të hiqej!

Ndërtesat madhështore sot të kuj janë?
Kosovë, ku e ke atë të moçmen pasuri?
Qave e lotove e dënuar,
Gëzohu se fytyra do të të qesh në ditët që do të vijnë!...

Të drejtat e popullit duke u marrë nëpër këmbë,
Ky vatan nga Zoti ndihmë rrinte duke kërkuar...
Tani në gëzim po i kthehet
Loti i derdhur, klithma e lëshuar

Yll i shpresës shkëlqen në horizont,
Zemra e qarë e popullitqë ka për të qeshur,
Errësira në qiell, më në fund po ndriqon,
Mëngjesi i pavarësis, fytyrëtrëndafilor...

Nga robëria shpëtove tani;
E jotja,e jotja është kjo fushë e gjerë!
Tridhjet vjetë qo hoqe s'janë pak
E, n 'u gëzofsh, ke të drejtë, e bukura Kosovë!

*Kemal Efendi Aruçi
Tetor 1941*

Nëna e Hz. Aliut (r.anh.), Fatime binti Esed (r.anha)



Fatime binti Esed - Allahu qoftë e kënaqur me të! - është nëna e Hz. Aliut (r.a.), një nënë e dhembshur dhe e dashur, e cila i shërbeu me gjithë shpirt profetit tonë kur qe fëmijë, u përpoq ta ruante nga të gjitha rreziqet, e ushqeu para se të ushqente fëmijët e vet, e pastroi dhe e kreu, një zonjë sahabe që ka merituar konsideratën e profetit tonë, të Dërguarit të Allahut (s.a.), i cili e ka quajtur *“nëna ime e dytë”!*

Ajo i përkiste tribusë Hashim. U martua me Ebu Talibin që e kishte djalë xhaxhai. Nga martesja e tyre lindën katër djem, *Talibi, Akili, Xhaferi, Aliu* dhe katër vajza, *Ummu Hani, Xhumane, Rajta, Esmaja*.

Fatime binti Esed është një zonjë me fat, të cilës i takoi nderi t’i shërbente si nënë profetit tonë të dashur qysh nga mosha tetë vjeç. I marrë nën kujdesin e xhaxhait Ebu Talib pas vdekjes së gjyshit Abdylmuttalib, Muhammedi i vogël u rrit në duart e saj, me interesimin e saj të afërt e të ngrohtë dhe nën shikimet e saj plot dhembshuri e dashuri.

Fatime binti Esed i shërbeu me gjithë shpirt, si nënë e vërtetë, jetimit të vogël, pa i lënë mangët vështrimet e saj plot dhembshuri e mëshirë për të. Duke treguar kujdes të veçantë në sjelljet dhe shërbimet ndaj tij, ajo u përpoq t’ia bënte shtëpinë atij një fole të ngrohtë familjare. Muhammedi nuk e harroi kurrë përpikmërinë e sjelljeve dhe shërbimit të veçantë të saj dhe, kur erdhi dita, u shpreh kështu për të:

“Ajo ishte nëna ime! Ajo më ushqente e më ngrohte ndërsa fëmijët

e vet i kishte të paushqyer, më pastronte e më krihte dhe s’më kursente ngrohtësinë e nënës!”

Në këtë vatrë të ngrohtë familjare, nën mbrojtjen dhe kujdesin e xhaxhait dhe xhaxheshës i kaloi profeti ynë i dashur vitet e rinisë gjersa ngriti follenë e vet familjare. Kur u bë njëzet e pesë vjeç, u martua me zonjën kurejshe Hatixhe, me të cilën krijuan së bashku një familje të lumtur. Ndërsa kur arriti moshën dyzetvjeçare, Allahu i Lartë e zgjodhi si të dërguar të vetin mes njerëzve. Ai i dërgoi engjëllin Xhebrail (a.s.), me të cilin ia bëri të ditura parimet e fesë së re dhe e urdhëroi të mos u falej idhujve e të mos binte në politeizëm.

Kur në sokakët e Mekës nisën të përhapen lajmet e ardhjes së fesë së re dhe të profetit të fundit që priteshin, politeistët deshën ta linin atë pa mbrojtje, madje, ta vrisnin. Por xhaxhai Ebu Talib dhe e shoqja, Fatime binti Esed, i dolën krah dhe e morën nën mbrojtje. Ata vetë nuk vrapuan dot menjëherë në Islam, por atë e lanë të lirë në çështjen e tij. Ata i krijuan mundësitë për të vepruar si të donte. Pasi Islami nisi t’i fitonte zemrat një nga një dhe muslimanët të shtoheshin, politeistët e tërbuar nisën të përdornin çdo lloj padrejtësie e dhune për ta penguar këtë zhvillim. Ata arritën gjer atje sa t’i shkaktonin mundime edhe vetë Profetit. Duke u bërë muslimanëve të vetëm e pa mbrojtje tortura që s’t’i merr mendja, u përpoqën t’i kthenin nga Islami, por asnjë musliman me zemrën të ndriçuar me dritën e Islamit s’e kthyen dot

Fatime binti Esed i shërbeu me gjithë shpirt, si nënë e vërtetë, jetimit të vogël, pa i lënë mangët vështrimet e saj plot dhembshuri e mëshirë për të.

Në këtë vatër të ngrohtë familjare, nën mbrojtjen dhe kujdesin e xhaxhait dhe xhaxheshës i kaloi profeti ynë i dashur vitet e rinisë gjersa ngriti folenë e vet familjare.

nga vetja!

Kur xhaxhai Ebu Talib që e kishte nën mbrojtje, mërgoi nga kjo botë, profetit Muhammed, diellit të dy botëve, iu vështirësua puna edhe më shumë. Ai iu nënshtua mundimeve dhe keqtrajttimeve që arrinin gjer në tortura. Të gjitha këto ngjarje e dëshpëronin shumë Fatime binti Esedin. Ajo e donte shumë Muhammedin dhe i besonte, por, për shkak të të shoqit, nuk e pati shfaqur besimin e saj ndaj Islamit. Tashmë kishte ardhur koha. Duke njoftuar se ia kishte dhënë zemrën çështjes së tij, dëshironte t'i bëhej mbështetje atij njeriu të dashur! Fatime binti Esed tha Fjalën e Dëshmisë dhe u bë muslimane. Profeti (s.a.) u gëzua shumë që xhaxhesha të cilën e donte si nënë, u bë muslimane, dhe i harroi sadopak hidhërimet.

Erdhi dita që Hz. Fatime binti

Esed (r.anha), ta shihte se nuk mund të jetohej më në Mekë dhe, si muslimanë të tjerë, emigroi për në Medinë. Ky nuk ishte një emigrim ekonomik, por për bindje, për besimin ndaj Allahut, prandaj edhe ajo fitoi lumturinë për të qenë emigrante ose, siç thuhet në gjuhën e Islamit, muhaxhire e hixhretit (emigrimit për bindje) në rrugën e Allahut! Në Medinë ajo bëri dasmën e të birit Ali me Fatimenë, të bijën e Profetit. Dhe vjehërr e nuse shkuan së bashku një jetë të lumtur!

Fatime binti Esed i qe bërë vjehërr Fatimesë, vajzës shumë të dashur të Profetit, për të cilën ai thoshte: *"Fatimeja është një copë prej meje"*! Këtë ajo e quante një fat të madh për veten e saj. Vjehërra sillej me kujdes shumë të madh për të mos e hidhëruar nusen. Ato i kishin ndarë punët e shtëpisë, megjithëkëtë, pasi mbaronin punët e veta, i shkonin në ndihmë njëra-tjetrës. Ishte formuar një fole dashurie! Në këtë shtëpi plot gëzim e hare dukeshin shembujt më të gjallë të dashurisë mes nuses dhe vjehërrës. Marrëveshja me dashuri dhe respekt mes tyre i gëzonte shumë edhe Profetin (s.a.), edhe Aliun (r.a.). Në banesën e tyre reshonte mëshirë e begati!

Profeti ynë, dielli i dy botëve, nuk i harroi kurrë mirësitë e gruas së xhaxhait, Fatime binti Esed (r.anha). Ai u përpoq në çdo rast të tregonte se sa e vlerësonte dhe se sa besnik i ishte në mirënjohjen ndaj saj. E vizitonte vazhdimisht në shtëpi, e pyeste për mirëqenien dhe shëndetin dhe kujdesej për të duke e ndihmuar me mënyra dhe mjete të ndryshme. Profeti u përpoq të bënte ndaj saj më shumë se ç'i takonte një biri të bënte ndaj nënës së vet. Ai e thirri gjithmonë *"nënë"* dhe po me këtë fjalë e kujtoi gjithmonë. Herë pas here i bënte vizitë në kohën e drekës dhe e kalonte atje gjumin

dhe pushimin e pasdrekës.

Kishin kaluar katër vjet pasi Profeti qe vendosur në Medinë. Në fytyrën e tij të bekuar kurrë nuk mungonte gëzimi, në sytë e tij çelnin çdo ditë lulet e lumturisë. Por një ditë Profeti mori lajmin e vdekjes së xhaxheshës Fatime dhe aq u hidhërua e u dëshpërua, sa tha: *"Ja, sot më vdiq nëna!"* Kështu e shprehu ai dashurinë dhe respektin e thellë që ushqente për nënën e të dhëndërrit Ali (r.a.)!

Si tregues të besnikërisë së vet për nënën e tij të dytë ose për nënën që e kishte rritur, atë ditë Profeti hoqi nga supet këmishën dhe ia dha Hz. Aliut duke i kërkuar t'ia bënte qefin nënës. Edhe faljen e namazit të saj vetë e drejtoi. Pastaj, si shenjë dashurie dhe konsiderate të lartë për të, zbriti në varrin e saj, u shtri në



Ajo ishte nëna ime e dytë! Pas tim ungji Ebu Talib, nuk ka pasur tjetër njeri veç kësaj gruaje që të më ketë bërë aq shumë të mira! Ia vesha asaj si qefin kë-mishën time që t'i veshin nga këmishat e xhennetit! Dhe që t'i vijë e lehtë dhe e rehatshme jeta e varrit, u shtriva pak në varrin e saj!”

“Erdhi Xhebraili dhe më lajmëroi: “Kjo grua është nga të xhennetit!” Veç kësaj, më tha se Allahu i Lartë urdhëroi shtatëdhjetë mijë engjëjt të merrnin pjesë në namazin e saj dhe të shtatëdhjetë mijë engjëjt e falën namazin e saj!”

krah dhe qëndroi pak ashtu, i shtrirë. Mes lotësh, doli nga varri. Lotët e kishin lagur varrin. Pastaj kufoma e Hz. Fatimesë binti Esed (Allahu qoftë e kënaqur me të!) u zbrit në varr.

Sahabet bujarë, shokët e Profetit, nuk kishin parë gjë të tillë gjer atë ditë. Kureshtarë, e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! S’të pamë të kesh bërë për ndonjë tjetër ato që bërë për këtë grua!” Dhe Profeti, për t’ua shuar kureshtjen shokëve, u dha këtë përgjigje:

“Ajo ishte nëna ime e dytë! Pas tim ungji Ebu Talib, nuk ka pasur

tjetër njeri veç kësaj gruaje që të më ketë bërë aq shumë të mira! Ia vesha asaj si qefin kë-mishën time që t'i veshin nga këmishat e xhennetit! Dhe që t'i vijë e lehtë dhe e rehatshme jeta e varrit, u shtriva pak në varrin e saj!”

Pasi e mbuluan me dhë, Profeti (s.a.) bëri këtë lutje për nënën e tij të dashur:

“Allahu të mëshiroftë dhe të shpërbleftë me të mira! Nëna ime e dashur! Allahu të mëshiroftë! Ti m'u bërë nënë pas nënës sime! Vetë ndenje e uritur, por mua më ushqeve! S'u veshe vetë, por më veshe mua! Gjërat më të mira s'i hëngre vetë, por m'i dhe mua t'i shijoj! Dhe të gjitha këto i bërë vetëm për pëlqim të Allahut dhe duke shpresuar jetën tjetër!

Allahu është ai që jep jetën dhe vdekjen, kurse vetë është i pavdekshëm! Allahu është i gjallë gjithmonë!

Allahu im! Fale nënën time Fatime binti Esed! Dhe bëja varrin të gjerë! Dhe pranoma lutjen për hir tim, të dërguarin tënd, dhe të të gjithë të dërguarve të tjerë, o më mëshiruesi i mëshiruesve, Zoti im i madh!”

Pasi i kreu të gjitha detyrat ndaj Hz. Fatimesë binti Esed (r.anha) që e quante nënën e tij të dytë, Profeti nisi të qeshte. Dhe u dha këtë lajm të gëzuar të pranishmëve:

“Erdhi Xhebraili dhe më lajmëroi: “Kjo grua është nga të

xhennetit!” Veç kësaj, më tha se Allahu i Lartë urdhëroi shtatëdhjetë mijë engjëjt të merrnin pjesë në namazin e saj dhe të shtatëdhjetë mijë engjëjt e falën namazin e saj!”

Falenderuar qoftë Allahu! Lavdëruar qoftë Allahu! Ç'fat i bardhë! Ç'lumturi! Ç'besnikëri dhe ç'vlerësim i lartë! Ç'shërbim me gjithë zemër dhe ç'shpërblim i bukur! Allahu ynë, na bëj pjesë edhe neve nga një lumturi e tillë!

Hz. Fatime binti Esed është një grua e mirë e cila solli në botë fëmijën e parë mashkull nga soji i të bijve Hashim. Veç kësaj, ajo ka nderin të jetë nëna e kalifit të parë nga ky soj. Kurse nënat e kalifëve të tjerë janë Hz. Fatimeja (r.anha), bija e dashur e Profetit dhe nëna e Hz. Hasanit, si dhe zonja Zybejde, grua e Harun Reshidit dhe nëna e kalifit Emin. Allahu qoftë i kënaqur me të gjitha!

Zoti na bashkoftë në xhennet bashkë me nënën tonë, Hz. Fatime binti Esed (r.anha)! Amin, ashtu qoftë!



Vlerat e të humburës ndërmjet mësimimit/porosisë dhe së kaluarës

O njeri, ku po rebelohesh? A nuk e di vallë, ç'është jeta? A e di së jeta është kalimtare? A e di së në jetë çdo gjë është kalimtare? Në një ngushticë nëpër kohë, mbesin vetëm vlerat e vazhdueshme. A dëshiron të jesh njeri i kohës, dhe atë njeri kohës në tërësi, e jo vetëm i kohës së jetës tënde të dunjallëkut. Dëshiron të jesh i pavdekshëm? Të gjithë e dëshirojnë Xhennetin, e askush nuk dëshiron të vdes. Vetëm ai, që beson dhe falë namazin bëhet pjesë e kohës, pjesë e historisë, të cilën e krijoi Zoti i Mëshirshëm sikur edhe vetë kohën. Ai, madje behet pjesë e metahistorisë! Kulmi i arritjeve të tua në kohën ku jeton është NAMAZI. E ku po rebelohesh pra?


Përse nuk dëshiron amshueshmërinë? Përse do më shumë kalimtare? Shkon pas gjërave kalimtare. Shkon nga drita sikur mushkoja, por nuk shërbehesh me të. Vetëm paramendoje sa i pakuptimtë është konfori i trupit. Trupi i përflakur (djegur) i mushkonjës, askënd nuk e iriton. Nuk dëshiron ta lësh shënimin tënd, në listën, të cilën e harton koha. Duke i kushtuar vemendje të përpiktë trupit, nuk arrinë as edhe deri të një faqe e kalendarit. Vetëm përmes namazit lë gjurmë në kalendar, në udhëtimin nëpër kohë. E merr një pjesë të përjetësisë, priresh nga vlerat e qëndrueshme.

Ej, po ti e do më shumë kalimtare se përjetësinë? Ti je njeri i vogël! Ti nuk je prej atyre njerëzve të mëdhenjë, që lënë gjurmët e ekzistencës dhe qenësisë së tyre. La ilahe il-lall-llah. Vallë, a nuk e ke kuptuar së mbështetja jote e fuqishme për këtë botë, në të vërtetë, është njëra nga të metat tua, sepse

ti, në të vërtetë, nuk mund të kuptosh thellësinë dhe ta njohësh botën e përjetshme.

Ti mendon se ke arritur në lartësi të mëdha, por je në lajthitje, sepse nuk e ke kuptuar gajbin. A e di ti ç'është gajbi? Ti u ngrite dhe menodve se e tërë bota është e jotja, e në të vërtetë ti ke të metën më të madhe ndër të tjerat - nuk e sheh atë botë, kalon nëpër kohë padobishëm dhe në fund nuk i sheh bukuritë dhe nuk arrinë te i Mëshirshmi.

Sa të vogla janë mundësitë e tua, e mendon se je i madh. O ç'lajthitje dhe gënjeshtëri e madhe është kjo me të cilën jeton. Nuk e ke zbuluar as edhe një fshehtësi, e menodn se bota është e jotja. "Nuk kalon i vogli nën yje". Këto fjalë të shërbejnë për ta ushqyer mburrjen tënde dhe egoizmin tënd, e nuk e kupton se je i vogël nën yjet nga një aspekt tjetër. A e di o njeri i mirë se nga çdo gjë e botës së gjallë në Tokë, kush kujdeset vetëm për konforin e trupit?! Ai që nuk e vret mendjen dhe ai që nuk ka shpirt. Kush i është kthyer vetëm kesaj bote dhe kush mendon vetëm për sot? Kush nuk e njeh botën e ardhme dhe punën për të? Këta janë ai lloj që ne, më fal, i quajmë kafshë! Me siguri nuk dëshiron të jesh i ngjashëm me këtë lloj apo edhe më keq se ata. Ç'është ajo që të bën njeri - mëkëmbës në Tokë? A je ngritur në të vërtetë, sipas cilësive të tua, mbi këtë lloj? Të Mëshirshmit të gjithë i falën, sipas urdhërit dhe instinktit të brëndshëm, por vetëm njeriu këtë duhet ta bëjë sipas bindjes së vet dhe sipas vetvendosjes. Dhe me këtë i Mëshirshmi e bëri atë dallimin (distinktin) e rëndësishëm ndërmjet njeriut dhe atyre llojeve të tjera. Arsyeja është ai dallimi (distinkti)



Ti mendon se ke arritur në lartësi të mëdha, por je në lajthitje, sepse nuk e ke kuptuar gajbin. A e di ti ç'është gajbi? Ti u ngrite dhe menodve se e tërë bota është e jotja, e në të vërtetë ti ke të metën më të madhe ndër të tjerat - nuk e sheh atë botë, kalon nëpër kohë padobishëm dhe në fund nuk i sheh bukuritë dhe nuk arrinë te i Mëshirshmi.

thelbësor, por ti e sheh se ajo është mjet për ta njohur të Mëshirshmin dhe për t'u kthyer nga Ai. Për këtë arsye i Mëshirshmi e krodhi atë në ty. Ration i Mëshirshmi ta dha ty, duke ia mësuar Ademit (a.s.) kuptimin e fjalëve, por ti je mosmirënjohës, i bën vetes keq dhe rëzonosh kështu: "Meqë tashmë jam duke i bërë vetes keq, përse të mos u bëj edhe të tjerëve"?

O njeri, përse e merr të huajën? A nuk të mjafton që mbush stomakun tënd me fruta të prishura nga kopshti yt, por i kthehesh edhe kopshtit të huaj? Zoti yt të jep fruta të mira, por ti më shumë ke qef të hashë e të pishë atë që me kalbësirë është rritur. Bëhu sikurse h. Mevlana, i cili e do më shumë Pronarin e vreshtës, se verën nga e cila të dhemb stomaku dhe koka. Ushqehesh me haram, e nuk e kupton se çdo kafshatë duhet arsyetuar. Vetëm që nuk je i sigurt në këtë. Një këmbë në dynja e tjetrën në varr, megjithatë të huajën e merr dhe ushqehesh me haram. Ti mendon se çdo frut nga kopshti i Zotit është i lejuar dhe se pikërisht për ty është destinuar. Ti, madje as që mendon se ka edhe të tjerë, të cilët kanë të drejtë të shijojnë frutin e lejuar nga kopshti i Zotit. Sepse, vetëm All-llahu (xh.sh.) është një, i Vetmi Krijues i përkryer dhe Zot i çdo gjëje, Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Atij i takon falenderimi dhe lavdërimi i përjetshëm. Ti, o njeri, në egërsinë (ashpërsinë) tënde nuk je i barabartë as me luanin. Lakmia jote është e pafrenueshme dhe e pangopshme. Nuk është fakir (i varfër) ai që s'ka, por ai që kurrë s'ngopet, - i cili nuk e kupton se ka edhe njerëz tjerë në mjedisin e tij. Kjo do të thotë se, ti je nga brendësia i varfër, gjë që është lloji më i madh i varferisë. Po, miku i dashur, si po e sheh, çdo gjë është e kundërta, mendon se je i mençur - por nuk je, mendon së je i pasur - e nuk je. Mendon se ke të drejtë - por nuk ke.

Për ty është e vertetë kjo botë e dukshme dhe kalimtare dhe ti jeton vetëm për të, por bota tjetër është më e sigurt, në të vertetë shumë më reale. Jeta jote është shumë e shkurtër dhe kalimtare, ndërsa shenja e qenësisë tënde është reduktuar në ditarin tënd. Më tej prej fillimit nuk ke lëvizur.

Ti rrënon çdo gjë para vetes, duke shkelur dhe nuk e vëren nën këmbë se nëpër çka je duke ecur, ndërsa të folurit tënd, është në kundërshtim me atë çka vepron. Ai vetëm mashtron. Duke dëgjuar njeriu fjalë ëmbelsinë tënde, vetëm në lajthitje mund të bie. Ti i largon edhe të tjerët nga rruga së cilës duhet shkuar. La ilahe il-lall-llah. Këto fjalë të mëdha nuk i kupton.

* * *

A e di se, duhet të përgjigjesh për veprat tua, ndërsa për shkak të gjuhës sate edhe më keq do t'a pësosh. Gjuha jote të ka holluar ushqimin dhe fjalët, kështu duke e mbushur stomakun me therra dhe ujë të valë. Kjo do të të ndodh me siguri nëse nuk përmirësohesh, nëse nuk ndryshohesh. Por, a do të ndryshohesh ti? Sepse, mëndjemadhësia në shpirtin tënd është e paasgjësueshme, ndërsa lakmia dhe epshi ta bëjnë edhe më të keq shpirtin e tillë. Si të ndryshosh, atëherë kur nuk ka ilaç më për atë

shipt? Ti e mashtron edhe veten edhe mjekun. Sepse si do ta shërojë mjeku të sëmurin, kur ai e fsheh sëmundjen tij dhe nuk merr ilaç nga terapia e përcaktuar. La ilahe il-lall-llah. Por të gjitha këto gjëra ti nuk i sheh, e mbase i Mëshirshmi t'i ka mbyllyr sytë, e nuk meriton të shohësh. Kush është i verber i vërtetë, mendo mirë! Ilaçet e vërteta janë gjithmonë të idhta dhe ato shpesh nuk merren, prandaj fëmijët dhe njerëzit e vegjël nuk mund t'i kuptojnë. Sepse mendja e fëmijës është shkurtëpamëse, ndërsa gjuha shumë e shpejtë, mbase u ngatërrohet mendja dhe fillojnë t'i lidhin fjalët dhe mendimet, por kjo është joadekuate për moshën fëmimore. A e sheh, o njeri, që mendja jote është e cekët dhe se je në lajthitje, por, me gjithë këtë traktat të kuptueshëm, më shumë dëshiron t'i pëlqesh vetvetes dhe ta ushqesh nefsin tënd, duke mos zgjedhur mjete për t'ia arritur qëllimit. Ti nuk kupton ose nuk don të kuptosh. Faktet dhe të vërtetën i refuzon apo, në momentin kur duhet t'i rrëmbesh si plaçkë, i flakë ato. Për ty nuk kanë absolutisht rëndësi kufijtë, kriteret, vlerat. Në garën e jetes, ti nuk zgjedh mjete. Ty fare nuk të shkon ndërmend se Gjykatësi Suprem çdo gjë shënon dhe e peshon në gram dhe në milimeter. Tani mendo pak për këtë fakt: ti merr me tonëlatë, E





Gjykatësi e di për çdo gram që e ke marrë në mënyre të padrejtë dhe për mjetet që i ke shfrytëzuar në tërë lojën e jetes dhe në këtë garë, e cila ka qëllimin dhe kuptimin e saj. Por ti nuk e sheh.

Ti vrapon në drejtim krejtësisht të kundërt nga qëllimi. Sepse, nëse i Mëshirshmi dhe Gjykatësi e ka caktuar dhe u ka dhënë garuesve një qëllim: grumbullimin i gjërave dhe veprave të mira, devotshmërinë, e ti ngarend nga e kundërta; grumbullon të këqija dhe vepra të liga dhe duke mos iu frikësuar dënimit, ti atëherë fund e krye gabon.

Për arsye se shkon në vend të gabuar duke arritur në qëllim nga drejtimi i kundërt dhe duke sjellë me vete ngarkesa vështirësish. Atë që e ke sjellë për gjykatës të vërtetë është një gurë i pavlerë, të cilin e ke lidhur me mbështjellës, rreth qafës (vetanake) tënde. E ti, tërë këtë kohë të jetës sate në këtë botë e ke kaluar duke mbledhur gurë të pavlerë. Duke shkuar në drejtim të gabuar dhe duke shfrytëzuar mjete të palejueshme, duke gabuar ndaj vetvetes, duke mos respektuar ato që i Mëshirshmi t'i dha si mjete në atë rrugë dhe në atë garë devotshmërie, ti nuk i

respektove rregullat e lojës. Ti me siguri gjatë rrugës i ke lejuar vetes ushqimin e nefsit nëpër disa kënaqësi që janë kalimtare dhe shpesh të palejuara në rregulloren e lojës, por si nuk e kupton se është i rëndësishëm qëllimi? Nëse të thotë dikush të shkosh në ndonjë vend dhe t'i sjellësh pasuri në formë margaritarësh, gurësh të çmuar, diamantësh, dhe ta jep biletën për atë rrugë dhe të furnizon me të gjitha mjetet e mundshme të nevojshme për atë rrugë, e përkundër të gjithave, shkon në një vënd tjetër, i harxhon të gjitha gjatë rrugës dhe në fund ke sjellur gurë të thjeshtë të pavlerë, atëherë kush është fajtor, i paarsyeshëm dhe gabimtar?!!

Ai që të ka udhëzuar apo i udhëzuar?! Si mund të mos e dëgjosh Atë i cili ta mundësoi në çdo mënyrë që të udhëtosh? Ti e përfill dhe e dëgjon atë që të nxit të bësh keq, që të mashtron, i cili nuk të çon nga e mira dhe për të cilin i vetmi qëllim është mashtrimi.

Devijimi yt nga drejtimi i lejuar është kuptimi dhe detyra e tij themelore, e ti, fatkeqësisht atij i përulesh. O njeri, ktheju Atij Krijuesit dhe Gjyqtarit të Përkryer që është gjithmonë i falenderuar dhe i lavdëruar, All-llahut xh. sh., që është i mëshirshëm ndaj robit të vet dhe i cili do ta udhëzojë gjithmonë nga e mira.

“Jeta e secilit njeri duhet të jetë si libri i hapur: vetëm jeta e hapur është guximtare, vetëm jeta e hapur është e pastër” (Ervin Sinko)

All-llahu (xh. sh.) ia cakton afatin gjethit, kështu ai thith ujën dhe rrezet diellore, dhe fillon të shushurisë. Në vjeshtë gjethi përsëri fillon të shushurisë, por bie dhe shpërndahet në tokën e ftohtë dhe me ujë të zhytur.

Gjëja më e vështirë si dëshmitarë për mua është, kur në mes të ditës takoj njeriun në errësirë, e nuk i bën fare përshtypje kur i ofroj Dritën që të dalë nga errësira.

Vallë, a është më e fuqishme gënjeshtra dhe lajthitja e huaj se e Vërteta jote? Më vjen të thërras, të bërtas... Por jo, kam frikë që urrejtja të mos ma pushtojë dëshirën dhe atëhere s'do të mund të bëja asgjë për njeriun. Unë edhe këtë, zaten, nuk mund të bëj pa vullnetin e Zotit, por dëshira mund të mbetet e pastër dhe ajo është më e fuqishme se kur bashkohet me urrejtjen, që të dyjat do të lodheshin shpejt dhe do t'u tërhiqeshin nga përpjekjet e mëtejshme që të shpëtohet dikush. Kjo do të ishte krim.

Në botë më shumë ka të verbër dhe të shurdhër dhe prej atyre që zemrat i kanë të sëmura... E vërteta për ata është ilaç dhe mëkëmbëngulje - u duhet ofruar (ilaçi duhet të jetë më këmbëngulës se sëmundja që të ketë efektin e vet), ndodh që disa përjetojnë shërimin, vetë kam qenë dëshmitarë i të tillëve.

Po, kush do të ofrojë ilaçin, kur të shëndoshët janë të pakët?

Ku jeni o vëllezër e motra, që dikur ishit betuar me të Vertetën se kurrë nuk do ta tradhtoni, përse tani e keni ngatërruar (ndyrë) besimin me jobesimin (diturinë me injorancën) siç ndyhet uji i pastër me të papastrin?!

Vallë, a më mirë ju duket të



bridhni në moçal, në vëndin ku myshku përgatitet për kundërmim... Vallë, njohja juaj, a fare nuk ua bëri të mprehtë të parit tuaj?

Këtë botë e keni shikuar si fotomorganë dhe me pasion i jeni dorëzuar, duke menduar se fundi i sprovës është shumë largë, dhe akoma nuk e keni flijuar asgjë për të vërtetën, prandaj, ia ktheni shpinën.

Por nuk është kjo fakeqësia më e madhe, më e rënde është të përballosh atë që ju veten të besueshëm e quani, ndërsa mu' minët e vertetë për fanatike i mbani dhe talleni me ta siç talleshin idhujtarët me Pejgmaberin dhe fenë e tij, paqja e Zotit qoftë në shpirtin e tij dhe të pasardhësve të tij të vertetë!

Nuk dua më të merrem me ju, të cilët dynjanë e keni më afër se Zotin, pabesimtarin më afër se vëllain dhe motrën, dredhinë e shejtanit më afër se mëshirën e Zotit...

Qofshit larg meje edhe në këtë botë edhe në botën tjetër!

Por, shejtani nuk do të më bëjë të hesht dhe të pushoj së zbuluari hipokrizinë dhe aleancat me të. Nëse do të dëshmoj për turpin tuaj dhe dredhinë e shejtanit, do ta privoj atë nga kënaqësia që të ma sundojë shpirtin.

E ju o vëllezërit e motrat e mia, që jeni në pakicë, ju të bindurit dhe të nënshtruarit e Lartmadherishmit (të vetmit ju jeni vëllezërit e motrat e mia), ngjeshni radhët, kthehuni nga ata që vuajnë nga shumë fatëkeqësi, kthehuni nga të varfërit, të uriturit, të sëmuret, të trishtuarit e të humburit, drejt atyre të cilët ende nuk i ka shtrënguar mëndjemadhësia e shejtanit, ngjeshni radhët që t'u ndihmojmë.

Zgjojeni misionarizmin e fesë dhe jepni çdo gjë prej vetes, flijimin, vetëmohimet e qoftë edhe pak komoditet nga jeta jonë dhe të fillojmë nga individi te individi, t'u kthehemi të lajthitureve që të jemi njeri pranë tjetrit, të kthejmë gëzimin

Gjëja më e vështirë si dëshmitarë për mua është, kur në mes të ditës takoj njeriun në errësirë, e nuk i bën fare përshtypje kur i ofroj Dritën që të dalë nga errësira.

në zemrat e të mërziturve dhe të vetmuarve, t'u ofrojmë ilaçin të sëmureve, t'i ushqejmë dhe t'i veshim të uriturit dhe të zhveshurit që të jemi njësoj. T'a çojmë në vend të drejtën atij që i është marrë. Kemi nevojë për të gjithë ata, sepse bashkarisht jemi më të fuqishëm dhe më të mirë. Të kultivojmë mëshirën ndaj njeri-tjetrit dhe ashpërsinë dhe trimërinë ndaj armiqëve (Kështu urdheron i Lartësuari).

Të thërrasim njeri-tjetrin në reshta dhe vendi i tubimit le të jetë i përbashkët për të gjithë ne... Dhe të punojmë... Ka tepër shumë prej atyre që vetëm flasin!

Literatura:

1. Ebu Hamid Muhammed el-Gazali, Savjeti vlastima, Sarajeve, 2001.
2. El-Hasan el-Basri, Cujem sum prijateljja ne vidim, Zagreb, 1989.
3. Elharun Sëlimovic, Psihologija namaza, pa vit dhe vend botimi.
4. Feriddudin Attar, Pend-nama, Sarajeve, 1990.
5. Ismet U. Shehibrahimoviq, Snagom vjere do savsensva du se, Sarajeve, 1984.
6. Dr. Mustafa Ceric, Vjera, narod i domovina, Sarajeve, 2002.
7. Mr. Refik Catic, Vjeronauka za cetvrti razred osnovne skole, Sarajeve, 1996.
8. Muallim, nr. 12- Islamska revija, Sarajeve, 1991
9. Takvim, 1993, Podgorica, 1993

Familja dhe njeriu



Islami i caktuar nga Allahu dhe i dërguar njerëzve si institucion mëshire dhe uniteti, përfaqëson të drejtën juridike të krijimit. (1) Çdo njeri gjen qetësi dhe arrin shpëtimin vetëm brenda këtij sistemi.

Kur'ani, libri-burim i Islamit, faktin që Allahu e ka ngritur jetën e njeriut mbështetur në burrin dhe gruan, që mes tyre ka vënë një afërsi të caktuar, që i ka përgatitur burrin dhe gruan në atë mënyrë që të gjejnë te njëri-tjetri dashuri dhe prehje, i shpreh kështu në këtë ajet: “Dhe një nga provat e Tij është se ka krijuar nga lloji juaj bashkëshorte që ju tërheqin dhe se mes jush ka shtresuar dashuri dhe dhembshuri. Në këtë ka mesazhe për një popull që mendon!” (2) Siç tregohet qartë në ajet, jeta e njeriut qëndron mbi familjen. Natyrisht, kjo jetë duhet rregulluar sipas vlerave të besimit dhe parimeve të Islamit. Dhe zbatimi praktik i jetës islame me mbajtjen gjallë në mënyrë të vazhdueshme të vetëdijes së devocionit (takva) si në familje, ashtu dhe në njësitë e tjera shoqërore, shprehet kështu:

“O njerëz! Ruhuni nga kundërshtimi i Zotit tuaj i cili ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm nga i cili ka krijuar, pastaj, shoqen e tij dhe nga të dy ka krijuar shumë meshkuj dhe femra...” (3)

Martesa, të cilën e drejta juridike islame (fikh) e shpreh me konceptin sunnet, (4) është një qëndrim i

rjedhur nga krijimi i vënë në zbatim nga Profeti (a.s.). Kjo do të thotë se, sipas Islamit, martesa nuk është një fantazi pa kuptim ose privilegj, por nevoja më e natyrshme dhe një e drejtë legjitime.

Përkufizimi i familjes dhe veprimtaritë e saj të natyrshme

Familja, e cila formohet prej prindërve (nënës, babait) dhe fëmijëve dhe, me anë të farefisit të afërm (lidhjes së gjakut), zgjatet në

“O njerëz! Ruhuni nga kundërshtimi i Zotit tuaj i cili ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm nga i cili ka krijuar, pastaj, shoqen e tij dhe nga të dy ka krijuar shumë meshkuj dhe femra...”

një fushë më të gjerë, është një unitet themelor me ndikim mbi të gjitha shtresat e shoqërisë. Roli më i rëndësishëm i saj është të sigurojë vazhdimin e brezit dhe rritjen e përgatitjen e tij të mirë. Ndërkaq, mundësia e familjes për ta vazhduar këtë veprimtari varet nga përbërja

dhe funksioni i saj i rregullt dhe harmonik. Një familje e tillë mund të ngrihet duke plotësuar kushtet përkatëse ndjesore, shoqërore, ekonomike dhe moralo-etike. Familjet e ngritura mbi vlera të larta, si besnikëria, dashuria e sigurtë, bindja e vetëdijshme dhe morali i bukur, janë garancia më e madhe e shoqërisë islame. Detyra më e rëndësishme dhe përparësore e një familjeje muslimane është të rrisë dhe përgatisë njerëz me personalitet që i besojnë Allahut pa dyshim dhe e jetojnë Islamin pa ndryshim. Kur'ani tërheq kështu vëmendjen mbi përparësinë e detyrës në fjalë: “Dhe Lukmani, duke i dhënë këshilla të birit, i pati thënë kështu: “O bir, kurrë mos i bëj shok Allahut, sepse t'i bësh shok Allahut është një padrejtësi e madhe!” (5)

Kalaja mbrojtëse: Familja Janë edhe funksione të tjera që kryen institucioni i familjes në jetën e individit dhe shoqërisë. Familja ka një funksion shumë të rëndësishëm për kontrollin dhe rregullimin e instinktit seksual si dhe për përfitim e moralit dhe edukatës së bukur. Familja e formuar me anë të martesës siguron plotësimin në mënyrë legjitime të dëshirave të natyrshme, rritjen dhe përgatitjen e brezave me një prejardhje gjenetike të njohur e të përcaktuar qartë. Familja është kala mbrojtëse përballë jetës boheme, sepse familja është vendi ku natyra njerëzore mundet ta shprehë veten në mënyrën më të mirë, ku mundet t'i realizojë dhe kthejë në praktikë vlerat e larta, si dashuria, respekti, dhembshuria dhe vetëmohimi. Familja, e cila siguron mjedisin material dhe moralo-shpirtëror më

të përshtatshëm për përfitim, zhvillimin dhe maturimin e personalitetit njerëzor, është një lloj shkolle morali të lartë. Se sa e rëndësishme është, për sa i përket njeriut, familja e formuar si rezultat i martesës, pohohet me këto fjalë në Kur'an: "... ata (burrat) janë veshje për ju, gratë, dhe ju, gratë, jeni veshje për ta..." (6) Ky ajet i përkufizon gratë dhe burrat si veshje për njëri-tjetrin. Siç dihet, veshja ose rroba e mbulon trupin dhe e zbukuron atë që e vesh. Njeriu pa rroba (i paveshur ose i zhveshur) e ndjen veten të mangët dhe të pasigurtë. Funkcionimi i gruas me burrin si veshje apo robë të njëri-tjetrit realizohet me rrugën e martesës, sepse martesë i mbron bashkëshortët nga shumë mëkate, si lidhjet dhe marrëdhëniet seksuale jolegjitime e të ngjashme, e fuqizon botën moralo-shpirtërore dhe e zbukuron moralin.

Familja luan rol të rëndësishëm edhe në formimin e shoqërisë. Familja është institucioni që i zhvillon lidhjet farefisnore ose të gjakut mes njerëzve, që i shndërron këto lidhje, në masë të madhe, në solidaritet shoqëror-ekonomik dhe mbështetje të dyanshme. Gjithashtu, familja vjen në krye të institucioneve që kontribuojnë në njohjen e brezave me vlerat islame si dhe në formimin e shëndoshë dhe të qëndrueshëm të ndërrimeve shoqërore. Fundja, ekzistenca e një institucioni matet me efektivitetin e tij. Institucionet që e kanë hu mbur efektivitetin, në një aspekt, nuk ekzistojnë.

Sulmet kundër familjes

Në ditët tona, familja ndodhet përballë një sërë sulmesh bashkëkohore. Tregtarët e epshit që pandehin se mbrojnë të drejtat e vajzave dhe grave, duke zhvilluar armiqësi veçanërisht ndaj Islamit, në çdo rast të përshtatshëm e tregojnë martesën si të keqe dhe kërkojnë ta asgjësojnë ndikueshmërinë dhe efektivitetin e familjes. Një numër i madh njerëzish të rënë në grackën djallëzore të ngritur nga ata që e përdorin femrën si mjet kënaqësie e dëfrimi, duke u dhënë pas kërkimeve jashtë familjes dhe Islamit, kryejnë të gjitha llojet e mëkateve në emër të të ashtuquajturit qëndrim bashkëkohor. Veç kësaj, institucionet arsimore bartin te brezat e rinj në masë të madhe vlera jashtë Islamit, kurse mjetet e informacionit masiv kanë marrë përsipër të formojnë pothuaj një mënyrë jetese jashtë Islamit. Zhvillimet negative, si hedhja e slloganeve mbi "lirinë seksuale" nga disa zëra të çjerrë dhe konsiderimi nga disa të tjerë i "bashkëjetesës pa kurorë" si domosdoshmëri të jetesës bashkëkohore, po na shpalosin para syve se në ç'përmasa kanë arritur sulmet kundër familjes dhe rreziqet pasuese, dhe ata që dalin kundër Islamit dhe martesës së propozuar prej tij, kërkojnë liri veprimi që të mundin ta përdorin femrën si mjet kënaqësie e dëfrimi.

Përballë të gjitha këtyre zhvillimeve negative, muslimanët po përpiqen pa u mbrapsur për t'i

vënë në jetë të vërtetat që i besojnë dhe i shprehin, si dhe për të siguruar rritjen dhe përgatitjen e brezave të rinj me dashurinë për Allahun dhe dëshirën për të jetuar sipas mënyrës islame të jetesës. Ndërkaq, kjo përpjekje duhet nisur veçanërisht me zbatimin në familje të një modeli jetese islame. Tashmë nuk ka asnjë dobi thënia se muslimanët e mirë kanë mbetur në të kaluarën. Sot, në çdo fushë të jetës ekziston nevoja e shembujve të muslimanëve të mirë, sepse ajo që është përgatitur dje, realizohet sot dhe përgatit të nesërmen.

Ka ardhur koha për ta parë të vërtetën dhe për ta thënë atë hapur. Zbatimet arsimore-edukative islame si në familje, ashtu dhe në njësitë e tjera shoqërore, ose kanë mbetur në fjalë, ose janë bërë me të meta dhe gabime. Puna e parë që duhet bërë në këto kushte, është të rishikohen familjet dhe institucionet e tjera që janë ushqyesit më jetikë të individit dhe strukturës shoqërore dhe, duke u përfutur atyre strukturën dhe funksionet origjinale bazë, të shndërrohen në institucione që rrisin dhe përgatisin njeriun islam.

Poshtëshënimet:

1. Kur'ani, Rum: 30.
2. Kur'ani, Rum: 21.
3. Kur'ani, Nisa: 1.
4. Feteva-y' Hindiye, I, 267.
5. Kur'ani, Lukman: 13.
6. Kur'ani, Bakara: 187.



Një numër i madh njerëzish të rënë në grackën djallëzore të ngritur nga ata që e përdorin femrën si mjet kënaqësie e dëfrimi, duke u dhënë pas kërkimeve jashtë familjes dhe Islamit, kryejnë të gjitha llojet e mëkateve në emër të të ashtuquajturit qëndrim bashkëkohor.



Në Keshmir, filluan vdekjet nga pneumonia.

Në Pakistan, të cilin e qëlloi tërmeti, moti i ftohtë po merr shpirtra. Me qindra fëmijë i ka zënë pneumonia.

Pas tërmetit i cili, më 8 Tetor, qëlloi Pakistanin e veriut, kushtet e vështira të dimrit që kanë zënë mirë vend, në ditët e fundit, u bë shkak që qindra fëmijë t'i kapë pneumonia. Serdar Mahmud Han drejtori i shëndetësisë së Muzafferabad, kryeqytetit të zonës së Keshmirit në Pakistan, tha se sipas të dhënave që ka marrë nga vende (burime) të ndryshme, ngjarjet e pneumonisë midis fëmijëve, janë rritur. Autoritetet Pakistaneze, të cilat thonë: "Kemi marrë me qindra lajme ngjarje pneumonie nga vende të ndryshme", konstatuan se këtë vit, dimri do të kalojë shumë i ashpër dhe se, me kuptimin e poltë të fjalës, nuk ka vende për të strehuar fëmijët, dhe se nuk ka ushqime dhe rroba të mjaftueshme për t'i mbajtur ngrohtë ata. Pozitat Pakistaneze, në sqarimet që kanë bërë ditët e kaluara, thaksuan se dy fëmijë kanë humbur jetën me diagnozë pneumonie.

Digjet çadra turke, 3 të plagosur.

Pranë një province Ballakot, në largësi një orë nga Muzaffarabadi, në çadrat ku rrinin punëtorët e (TOK) administratës së vendbanimit të përgjithshëm (union), rra zjarr. Në zjarrin që rra në orët e vona të natës, në spitalin Sahara të Gjysëmhënës së Kuqe, u morrën nën mjekim gjeologjisti Xhenk Yakin, gjeofiziku Ufuk Arslan dhe operatori i sondazhit Kenan Çanak.

SHËNDETI

Numri i të prekurve nga SIDA i kaloi 40 milionë.

Sipas raportit të SIDA të vitit 2005 të Organizatës së Shëndetësisë Botërore (WHO), në të gjithë botën, numri i të prekurve nga SIDA i gjeti (arriti) 40 milionë e 300 mijë vetë.

Brenda një viti, humbën jetën 3,1 milion vetë, për shkak të SIDA-së. Ndërsa në Turqi, numri i të prekurve nga SIDA është mbi dy mijë vetë. Sipas raportit, virusi HIV që është shkaktar i SIDA-së, vitet e fundit, është shtuar me shpejtësi në mesin e fëmijëve dhe të grave. Numrin 2 milion të të prekurve nga SIDA, e formojnë fëmijët nën moshën 15 vjeç. Numri i grave me HIV, i kaloi 17,5 milionvetë. Në të gjithë botën, 65 % i numrit të të prekurve nga SIDA, jetojnë në Afrikë. Kurse numri i të sëmurëve në Azi, është rreth 8,3 milion vetë. Sipas Who-së, në 20 vite, numri i të prekurve nga SIDA do t'i kalojë 70 milion vetë. 95 % i të prekurve nga SIDA, ndodhen (jetojnë) në shtetet e prapambetura dhe në ato shtete që ajnë në zhvillim. Vetëm 4 % e këtyre të sëmurëve, kanë mundësinë të mjekohen. Sepse çmimi i ilaçeve vjetore të në të sëmurë është 12 mijë dollar. Çmimi i ilaçeve depozito mund të zbresë në 300 dollar. Por për shkak të ndalesës së ilaçeve, shtetet e Afrikës nuk mund t'i përdorin këto ilaçe. Prandaj me miliona vetë të prekur nga SIDA, për një kohë të shkurtër, për shkak të mos kurimit vdesin.

Harresa, Matufosja (Bunama – Depression) dhe Shkaqet e Saj

Pothuajse, harresa që ankohemi herë pas here, nga aspekti i shkaqeve, po bllokton intensivisht rendin e ditës së shkencës. Në shtetet e zhvilluara, me rritjen e përqindjes



Sipas Who-së, në 20 vite, numri i të prekurve nga SIDA do t'i kalojë 70 milion vetë. 95 % i të prekurve nga SIDA, ndodhen (jetojnë) në shtetet e prapambetura dhe në ato shtete që ajnë në zhvillim. Vetëm 4 % e këtyre të sëmurëve, kanë mundësinë të mjekohen.

Sepse çmimi i ilaçeve vjetore të në të sëmurë është 12 mijë dollar. Çmimi i ilaçeve depozito mund të zbresë në 300 dollar.

së popullsisë së plakur, me kalimin e kohës, depresioni shihet e vlefshme të kihet mjaft kujdes edhe nga aspekti i ekonomisë së vendit.

Harresa dhe demans (depresioni), është një nga çështjet më të rëndësishme të sjelljeve të

neurologjisë dhe ka një fushë të gjerë ekzaminimi. Depresioni që shihet veçanërisht te njerëzit e moshuar, mund të jetë simptomë e shumë sëmundjeve. Prandaj, në shumë universitete dhe spitalet studentore, janë formuar njësitë e veçanta që i përkasin kësaj sëmundjeje dhe organizojnë protokolle mjekimi. Në shtetet e zhvilluara, për këtë çështje, janë veçuar burime materiale në sasi të mëdha.

Të sëmurët që kanë depresion, zakonisht, nga që nuk janë shumë të vetëdijshëm me gjëndjen, vetë nuk ndiejnë shumë shqetësime të tepërta, por shqetësimet dhe ngutjet e të afërme janë shumë të mëdha. Shumica e njerëzve, kanë frikë të në demansa (depresion) dhe madje thonë se do të preferonin të vdisnin herët se sa të jetonin duke u depresionuar në këtë mënyrë.

Te të sëmurët, në fillim, fillojnë harresa dhe shqetësime nga pakica e vëmendjes. Kjo, herë pas here mund të jetë simptoma e një sëmundje të shërueshmë. Veçanërisht te të sëmurët me depresion, mund të ketë simptoma të prishjes së të menduarit dhe të moskujtimit mirë. Në shtëpi dhe në vëndin e punës, mund të shihen ulje të rendimentit të punës, pavendosmëri dhe indiferencë, pakësor energji dhe ngadalësi mendore. Mund t'i vihet diagnoza me një vëzhgim dhe ekzaminim (kontrollim) të mirë, dhe mund të rregullohet me mjekim.

Harresa, edhe në disa sëmundje organike mund të shihet. Proçesi i depresionit, zakonisht, zhvillohet disi ngadalë. Hipotiroidi, si rezultat i disa sëmundjeve të damarëve të trurit dhe gjendrave të guzhës, pamjaftueshmëria e vitaminës B12, prishjet e qarkullimit të gjakut që zhvillohet në tru si pasojë e sëmundjeve të damarëve të trurit, sëmundja parkinson që është një sëmundje e çrregullimit të lëvizjeve (veprimeve) dhe sëmundja më e

njohur Alzheimer, AIDS, sifilizi, sëmundjet prione dhe disa sëmundje trunore që avancojnë trashëgueshëm, janë shkaqët e konsideruara në një ashkël.

Edhe përdorimi i alkolit, nga që prish funksionet e trurit, zë një vend të denjë midis shkaqeve më të rëndësishme të depresionit. Qelizat e lëvores së trurit, me efektin e alkoolit pakësohen gradualisht dhe shihen depresione të shtrira

Të sëmurët, që kanë prishje të kujtesës, thonë se harrojnë ngjarjet që kanë ndodhur veçanërisht në kohët e fundit dhe se ngjarjet e vjetra i kujtojnë më lehtë. Veçanërisht kanë prishje pajtimi me kohën. D. m. th. herë pas here, mund të kenë vështirësi të kujtojnë se çfarë dite është sot dhe se a është verë apo dimër.

plotësisht. Me marrjen e disa ilaçeve bashkë me alkool, mund ta rëndojë tabllon.

Veçoritë e demansit (depresionit)

Pakësimi në funksionet intelektuale dhe efektet e tyre, në pacientët që sillen me ankesa harrese, nga aspekti i ndihmesës për të sëmurë, janë qështje të rëndësishme për t'u ditur. Nga që shqetësimet zhvillohen ngadalë, në këta të sëmurë, kur sillen te mjeku, zakonisht, tabllaja përparon.

Të sëmurët, që kanë prishje të kujtesës, thonë se harrojnë ngjarjet që kanë ndodhur veçanërisht në kohët e fundit dhe se ngjarjet e vjetra

i kujtojnë më lehtë. Veçanërisht kanë prishje pajtimi me kohën. D. m. th. herë pas here, mund të kenë vështirësi të kujtojnë se çfarë dite është sot dhe se a është verë apo dimër. Gradualisht pakësohet kujdesa për mirëmbajtjen personale dhe për pastërtinë. Nuk kujtojnë vëndet e sendeve. Mesazhet i harrojnë dhe përpiqen t'i përsëritin në vetvete. Fillon vartësia me mjedisin dhe vartësia rutine e përditshme. Kur pyeten, për shqetësimet e tyre, kthejnë përgjigje si: "Doktor, po të pyesni gruan time, ajo e di më mirë."

Mendimi, të kuptuarit dhe nxjerrja e rezultateve logjike prishet. Organizimi i mendimit është dobësuar, bën fjalë rreth e rrotull (çevresel) të papërshtatshme. Diskutimet dhe bisedat, nuk i kuptojnë mirë. Fillon të bëjë lëmsh punë të rëndomta.

Aftësia e vendimit dhe e gjykimit, është prishur. Vërehen pakësime në mendime të reja dhe vështirësi në përdorimin inivativë të tyre. Vartësia me të afërmit, dalëngadalë, rritet.

Ndërkohë, edhe funksioni i gjuhës, te të sëmurët, prishet. Dituria e fjalëve pakësohet. Fillon të përdorë fjali të thjeshta dhe prishet shqiptimi i fjalëve. Fillon të duken edhe prishje të leximit e të shkrimit. Sa më shumë që avancohet sëmundja, llogaritjet i ngatëron dhe punët e parasë (lektur) nuk i kryen dot vetë. Të afërmit e këtyre të sëmurëve, pas një periudhe të caktuar, mbeten të detyruar të marrin kujdestarinë e të sëmurëve. Ndërsa kjo, bënë të nevojshme vlerësimin e të sëmurit nga komisioni mjekësor dhe i drejtësisë.

Kohët e fundit, te të sëmurët vërehen edhe humbje fare lehtë, bredhje të paqëllimita dhe vështirësi në të veshur. Përshtatjet me kohën, vende dhe njerëz janë prishur. Mund t'a ndiejnë veten se janë në moshë shumë të re.

Njerëzit zemërbardhë të Pakistanit

Njeriu turk dhe shteti i tij iu ndodhën më pranë se kushdo tjetër pakistanezëve pas fatkeqësisë së rëndë të tërmetit të fundit.

Varfëria e tyre nuk i përngjet asaj të tanëve. Në vendin më të veçuar të botës, çdokush është i varfër. Ata s' dinë asgjë për të mirat që i nuhat hunda edhe më varfanjakut prej nesh. Janë ndoca pasanikë që jetojnë në pallate të kristalta; dhe ata janë jomuslimanë, siç ndodh në përgjithësi! Shtëpitë dhe sokakët nuk i kanë dhe aq të pastra, siç duket, nga varfëria, por zemrat ...

Unë s'i përshkruaj dot hallet e tyre! Duhet shkuar e duhet parë aty! Edhe kur ecin, edhe kur rrinë, gjithë me qafën të përkulur. Sikur të gjithë, nga më i thjeshti e gjer te më i shquari, presin t'u vijë koha!

Buzëqeshin ashtu, pa zë, sikur të deshin të thonin "është e përkohshme, s'e vlen të ankoresh"! Në vështrimet e tyre ka një durim të çuditshëm, një maturi të papërshkrueshme. Sikur në shkretëtirat e Pakistanit të ketë mbetur një gjurmë nga medinasit e shekullit të lumtur që e bënë iftarin me gjysmë hurme, por kurrë nuk harronin të falenderonin!

Po, në trenin e vjetër që bën para përmes shkretëtirës, i riu që na e zgjat neve, shëtitesve që na ka rënë rruga andej, një hurmë gjatoshë nga bohçja e vogël dhe

që, duke na e zgjatur, na thotë, "ejani, vëllezër, të këndojmë Kur'an së bashku", sikur është njëri nga shokët e sofatit...

Ata na duan ne më shumë se ç'e duam ne veten tonë. Si shkëlqejnë ata sy të zinj të kredhur në largësi kur dëgjojnë emrin e Turqisë! Ashtu na përqafojnë, ashtu na shfaqin respekt, sikur ne të jetokëshim në përfytyrimet e tyre!

Ata na e kanë treguar se sa e lartë është në të vërtetë të *duash për hir të Zotit*. Dhe ne sjellim ndërmend mendjemadhësinë dhe indiferencën individualiste të Perëndimit që na është ngjitur sipër si fëlliqësirë, sjellim ndërmend se edhe në xhami ku shkojmë për t'u falur, ia kursejmë njëri-tjetrit një selam, një përshëndetje me urim për paqe, dhe turpërohemi... Sikur ta dinin se ne s' kemi thesar tjetër përveç bëmave të të parëve tanë që edhe atyre s'u dalim dot për zot! Prandaj janë ata që duhen respektuar, jo ne, janë ata që duhen vënë në krye të vendit! Ndërsa për vete s' kishin as bukë për të ngrënë e as liri, qenë ata që qenë përpjekur për shpëtimin e gjyshërve tanë që përlesheshin me dushmanët që i kishin rrethuar nga të katër anët, ata, njerëzit e mirë dhe





zemërbardhë të Pakistanit!

Tani një klithmë këputet, vajtime lartësohen nga ato vende. Thonë se është humbur tërë një brez. Këta njerëz të vetmuar edhe si komb, përfyten me pamundësitë. Mu në mes të gërmadhave, i pari i një familjeje këndon ezanin e mbrëmjes. Ata që kanë mbetur në jetë, e hapin agjërimin me një gllënjë ujë dhe bukë të thatë duke

u dridhur në të ftohtit që të pret. Dhe unë i sodis të gjitha këto nga shtëpia ime e ngrohtë duke ngrënë iftar me lloj-lloj gjellësh! Duhet të bëj diçka, patjetër duhet të bëjmë diçka për ta, për ata krijesa të mira por të mjera të Mëshiruesit, për nipërit e Muhammed Ikbalit...

Ne jemi borxhllinj ndaj tyre! Le ta paguajmë borxhin tonë tani, në kohën më të keqe për ta! Le të mos kemi frikë për ta futur dorën në xhep, fundja, është një Zot që të jep 700 për 1! Dhe le ta përdorim forcën tonë më të madhe, më me rëndësi, t'i lutemi e përgjrohemi Mëshiruesit i cili u përgjigjet lutjeve tona:

O Ti, më i mëshirshmi ndaj robve të tu, zotëruesi i bujarisë së pafundme, Zoti im! Bëjua të lehtë llogarinë këtyre vëllezërve tanë që e kaluan jetën pa ditur se ç'është mirëqenia e rehatia! Kthejua varret në kopësht xhenneti!

Mërguan ata në botën e përjetshme atë ditë kur mbetën të

uritur e të etur me shpresën për të shijuar një pikë nga deti i mëshirës tënde!

O Mëshirues! Jepua iftarin në kopshtet e Adnit këtyre robve të tu të urtë, paqësorë, zemërbardhë por të munduar, që na duan ne vetëm pse të kemi besuar Ty, ne, që s'ia shohim të mirën as vetes sonë!

Zoti ynë, shpëtona ne nga preokupimi vetëm me veten tonë, zgjona nga përgjumja dhe bëna të shtënë pas njëri-tjetrit!

Amin, ashtu qoftë!

O vëllezër të vuajtur që ju kemi lënë pas dore gjithmonë! Ju jeni në këtë botë të madhe i vetmi komb që na doni nga zemra! E ngrënci iftarin në sofrat e parajsës së atij Zoti për tek i cili u nisët duke qenë të agjëruar!

Sikur ta dinim se sa shumë të drejta keni mbi ne! Ju lutemi, falnani ne!



Të sëmurit me paralizë mund të flasin me mendje



Shkencëtarët Japonez, kanë zbuluar një mjet për të sëmurit e paralizuar, që në të gjithë trupin, me anë të të cilit bëhet e mundur të thojnë “po” ose “jo”. Ky mjet që quhet “Kokoro-gatari” (Të flasësh me mendje), është zhvilluar me bashkpunimin e firmave “Hitachi Elektronik”, grupi Mechatronix, që është pjesë e firmës “Excel” dhe qendra e të sëmurve “Japan Amyotrofik Lateral Skleroz”.

Aparati që mund të përdorë i sëmuri, i cili ka rënë në kthetrat e kësaj sëmundje serioze për shkak si rezultat shkatërrimit të nervave, nuk mund të flasë, po ashtu nuk mund të mbyllë as sytë e tij por vazhdon të mendojë normalisht, punon duke matur rrjedhjen e gjakut në tru.

Shiriti i veçantë që i është vënë të sëmurit në kokë, bën matjen e shpejtësisë së gjakut në tru. Dëshiron të thotë “po” psh.: bën llogari nga koka e tij ose këndon këngë me mendje. Kështu që, më anë të këtij mjeti matet gjaku i tepërt që shkon në tru.

Në të kundërtën nëse dëshiron të thotë “jo” duhet të rahatohet dhe qetësohet në mënyrë që të sigurojë kthimin mbrapsht të qarkullimit të gjakut. Aparati që do t’u sigurojë lehtësi të sëmurëve me paralizë, gjatë provave për 36 sekonda, ka arritur 80% sukses.

Aparati “të flasësh me mendje” afërsisht në fund të këtij viti në Japoni, mendohet të hidhet në treg me vlerë 470 mijë jen (përafërsisht 3470 Euro). Në këto momente nuk mendohet eksporti i tij.

Klaviaturë që paloset



Klaviaturat kompjuterike që mund të mbyllen, nuk depertojnë ujë dhe kanë një pamje të tejdukshme, gjithashtu nuk mbajnë mikrobe në sajë të veçorisë anti bakteriale.

Këto klaviatura, me veçoritë dhe ngjyra të ndryshme nga njëra tjetra, shikuesve i ka tërhequr vëmendjen. Klaviatura, për shkak të veçorive që ka, fillimisht, është preferuar nga spitalet, nga çerdhet e fëmijëve dhe klubet femënore.

Klaviatura nuk pëson gjë edhe po t'i bie ujë ose kafe. Klaviaturën mund ta lani kur të doni. Ka një përbërje me veçori antibakterial që nuk strehon bakterie. Preferimi i 9

nngjyrave të ndryshme dhe palosja e saj u ka tërhequr vëmendjen të gjithëve.

Për shkak të jetëgjatësisë së shtypjes 5 milion herë të butonit, qytetarët janë çuditur shumë kur kanë parë për herë të parë këtë produkt. Nuk besojnë se kjo është një klaviaturë dhe mendojnë që brenda saj është një aparat. Të gjithë e shohin si të çuditshme. Nga çmimi tepër i ulët, disa njerëz për shkak të ngjyrave karakteristike që ka klaviatura marrin njëherësh disa prej tyre.

Sexhadja me dritë që nuk huton Qabenë



Prodhimi

Soner Ozen që jeton në Londër ka projektuar një sexhade me busull që quhet “sajjadah 1426”.

Sa herë që kthehet nga qabeja, ndriçon. Shpikësi Turk Soner Ozenç që jeton në kryeqytetin Anglez Londër ka projektuar sexhade me dekore që tregojnë drejtimin e qabes.

Ka busul dixhitale

Një ndër gjërat që të tërheq vëmendjen e sexhades në këtë projekt, është përdorimi i rrallë i teknologjisë së stampimit të fosforit. Ozençi, ka krijuar dekore tradicionale ka integruar një busull dixhitale brenda sexhades. Sa herë që kthehet nga kibla rritet ndriçimi i dekoreve. Ozençi thotë se: “Me anë të dekoreve që gjenden sipër sexhades duke marrë shembull nga tradita e vjetër dhe ritualet, kam pas për qëllim të krijoj atmosferë në xhami. Sexhadja me emër “Sajjadah 1426” që ka numrin 1426, tregon kalendarin hixhri që përfaqëson vitin 2005.

Ozençi që ka bërë një projekt të lirë në Londër, punon akoma mbi zbatimet teknologjike të “Electro Luminescent Printing”. Projekti “sajjadah 1426”, në qershor, është ekspozuar në qytetin e Londrës.

Të dish të përdorësh kohën

Pasuria më me vlerë që humbasim pa e vënë re, është koha. Ajo rrjedh si uji. Zoti ynë për të vlerësuar pikërisht këtë të vërtetë betohet në kohën duke theksuar se jemi në humbje në këtë drejtim. Ndërsa Pejgamberi ynë i cili e ka përdorur kohën më së miri, thotë:

“Ka dy mirësi që njerëzit nuk ua dinë vlerën ashtu siç duhet. Këta janë shëndeti dhe koha e lirë”

Kjo ndodh sepse ne e kuptojmë vlerën e kohës vetëm kur e humbasim atë dhe themi me vete: “Ah sikur të bëja kështu, sikur të bëja ashtu!” Por në asnjë rast nuk mund ta kthejmë kohën prapa. Ja një ngjarje që lidhet me vetëdijen e përdorimit të kohës:

Në një universitet të njohur, në mësimin “Drejtimi i kohës” mësuesi hyn në klasë dhe pasi i shikon njëherë nxënësit u thotë:

- Sot do të bëjmë një provë në lidhje me përdorimin e kohës.

Shkoi në tavolinën e tij dhe nga poshtë tavolinës nxori një kavanoz të madh. Më pas nxori disa gurët të çrregullt dhe filloi t’i vendoste brenda në kavanoz. Pasi u sigurua se kavanozi nuk zinte më gurë, u kthye tek nxënësit dhe i pyeti:

- Si mendoni a u mbush kavanozi?

- U mbush...- iu përgjigjën nxënësit njëzëri.

- Ashtu? - iu përgjigj me një mënyrë habitore profesori dhe duke u përkulur nxori nga poshtë tavolinës një kovë me mbeturina. I hodhi lehtë në kavanoz. Më pas e tundi disa herë atë në mënyrë që copat të zinin vend mirë. Më pas duke u kthyer nga nxënësit, i pyeti përsëri:

Sonte para se të flini mendoni mirë se cilët janë gurët tuaj të mëdhenj, merrni një vendim të mirë. Ta dini se, nëse gurët e mëdhenj nuk i vendosni në fillim në kavanoz, nuk keni mundësi t’i vini më vonë. Atëherë nuk do të jeni i dobishëm as për veten tuaj, as për vendin ku punoni dhe as për atdheun tuaj dhe kjo tregon se në të vërtetë nuk do të mund të bëheni diçka.

- A u mbush kavanozi?

- Si duket akoma nuk është mbushur, - iu përgjigj një nxënës nga larg.

- E drejtë, - tha profesori dhe duke u përkulur përsëri poshtë tavolinës mori një kovë me rërë dhe ia hodhi kavanozit derisa e mbushi plotësisht deri në grykë. Përsëri iu kthye nxënësve dhe i pyeti:

- Po këtë herë a u mbush kavanozi?

Të gjithë nxënësit thirrën me një gojë:

- Jooooo!

- Bukur,- tha profesori dhe përsëri nga poshtë tavolinës nxori një kovë me ujë dhe e hodhi në kavanoz duke e mbushur deri në grykë.

Më pas duke u kthyer nga nxënësit i pyeti ato:

- Cili ishte qëllimi i kësaj prove?

Një nxënës i zgjuar menjëherë mori fjalën dhe tha:

- Sado e plotësuar të duket koha jonë, ka edhe më tepër që mund ta plotësojmë.

- Jo!, - tha profesori, - domethënia e kësaj prove është se nëse gurët e mëdhenj nuk i vendos në fillim, pasi të jenë vendosur gurët e vegjël, pastaj gurët e mëdhenj nuk mund t’i vësh dot.

Nxënësit panë njëri - tjetrin me çudi, ndërkaq profesori vazhdoi:

- Çfarë janë gurët e mëdhenj në jetën tonë? Fëmijët tuaj, njeriu i jetës (burri apo gruaja), të dashurit tuaj, shokët tuaj, arsimimi juaj, ëndrrat tuaja, shëndeti juaj, një vepër e juaja, të jesh i dobishëm për të tjerët, t’u mësosh diçka atyre! Gurët tuaj të mëdhenj ndoshta janë vetëm disa prej tyre, ndoshta një pjesë e tyre, ndoshta edhe të gjitha. Sonte përpara se të flini mendoni mirë se cilët janë gurët tuaj të mëdhenj, merrni një vendim të mirë. Ta dini se nëse gurët e mëdhenj nuk i vendosni në fillim në kavanoz, nuk keni mundësi t’i vini më vonë. Atëherë nuk do të jeni i dobishëm as për veten tuaj, as për vendin ku punoni dhe as për vendin tuaj dhe kjo tregon se në të vërtetë nuk do të mund të bëheni diçka.

Si përfundim ata të cilët do t’i zgjedhin dhe do t’i vendosin mirë gurët e mëdhenj, do ta përdorin mirë kohën që në vitet e rinisë. Në këtë mënyrë mirësia e jetës që na është dhënë neve amanet do të vlerësohet mirë. Në të kundërt jeta do të përfundojë me humbje dhe me pendime Ata që nuk dinë ta përdorin kohën, duhet të kuptojnë se jeta nuk ka një dorëshkrim.

Përkthyes: Evans Drishti

Fëmija Mëson Atë Që Jeton

Në qoftë se një fëmijë, është kritikuar,
Mëson të qortojë dhe të akuzojë.

Në qoftë se me një fëmijë, është tallur dhe nënvleftësuar,
Mëson të mërzhitet dhe të turpërohet.

Në qoftë se një fëmijë, rritet në një mjedis me mllef,
Mëson të grindet dhe të debatojë.

Në qoftë se një fëmijë, është edukuar duke e turpëruar atë vazhdimisht,
Mëson të fajësojë veten.

Në qoftë se një fëmijë, është rritur me tolerancë,
Mëson të jetë i durueshëm.

Në qoftë se një fëmijë, i është dhënë përkrahje dhe kurajo,
Mëson të ndiejë besim për vete.

Në qoftë se një fëmijë, është lavdëruar dhe pëlqyer,
Mëson të vlerësojë (të tjerët).

Në qoftë se një fëmijë, është rritur, duke iu treguar një respekt me meritë për të,
Mëson të jetë i drejtë.

Në qoftë se një fëmijë, është rritur në një mjedis të sigurtë,
Mëson të jetë me besim.

Në qoftë se një fëmijë, ka parë pranim dhe miratim,
Mëson të dojë dhe të respektojë veten.

Në qoftë se një fëmijë, është përkrahur dhe ka parë shoqëri nga fshija e tij,
Mëson të jetë i lumtur në botë.

Domethënë se, siç janë prindërit ashtu janë edhe fëmijët e tyre.

Përktheu Arjan Ymeraj